Manuali i montimit dhe përdorimit



SQ **Manuali origjinal i përdorimit**

LIEBHERR

Përmbajtja

1 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë..... 3
1.1 Përdorimi i parashikuar..... 3
1.2 Grupi i përdoruesve..... 3
1.3 Udhëzime paralajmërime - Rreziqet për përdoruesin..... 4
1.4 Defektet, dëmtimet dhe riparimet..... 4
1.5 Udhëzime për hedhjen..... 4
1.6 Konformiteti..... 5
1.7 Klasat e klimës..... 5
1.8 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH..... 5
1.9 Baza e të dhënave EPREL..... 5
1.10 Licencat me burim të hapur..... 5
1.11 Pjesët e këmbimit..... 5
1.12 Nivelet e paralajmërimit..... 5

2 Pajisja në një vështrim të shpejtë..... 5
2.1 Përmbajtja e dërgesës..... 5
2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve..... 6
2.3 SmartDevice..... 6

3 Instalimi dhe lidhja..... 6
3.1 Kushtet e instalimit..... 6
3.2 Përmasat e pajisjes..... 7
3.3 Dimensionet e dollapit..... 8
3.4 Peshat e kanateve të mobilies..... 9
3.5 Sistemi i furnizimit me ujë*..... 9
3.6 Transportimi i pajisjes..... 9
3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi..... 10
3.8 Shpjegimi i simboleve të përdorura..... 10
3.9 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës së ndarjes së ngrirjes me 4 yje*..... 11
3.10 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës..... 11
3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë*..... 13
3.12 Instalimi i pajisjes..... 14
3.13 Instalimi i disa pajisjeve..... 14
3.14 Hedhja e paketimit..... 15
3.15 Montimi në dollap..... 15
3.16 Kanatet e mobilieve..... 24
3.17 Lidhja e pajisjes në furnizimin me energji..... 25

4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe. 26
4.1 Navigimi dhe shpjegimi i simboleve..... 26
4.2 Menytë..... 26
4.3 Modaliteti i qetësisë..... 27

5 Vënia në punë..... 27
5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)..... 27
5.2 Vënia në funksionim e InfinitySpring*..... 27
5.3 Vënia në funksionim e HydroBreeze..... 28

6 Ruajtja..... 28
6.1 Udhëzime për ruajtjen..... 28
6.2 Pjesa e ftohjes..... 28
6.3 BioFresh..... 28
6.4 Ndarja e ngrirjes me 4 yje*..... 29
6.5 Kohët e ruajtjes..... 29

7 Kursimi i energjisë..... 30

8 Përdorimi..... 30
8.1 Elementët e komandimit dhe tregues..... 30
8.1.1 Treguesi i statusit..... 30
8.1.2 Simbolet treguese..... 30
8.2 Funksionet e pajisjes..... 30
8.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes..... 30
Fikja dhe ndezja e pajisjes..... 30
Temperatura..... 31
BioFresh B-Value 31
C-Value*..... 32
D-Value..... 32
SuperCool..... 32
PartyMode 32
HolidayMode..... 33
SabbathMode..... 33
EnergySaver 34
HydroBreeze..... 34
CleaningMode..... 35
Bllokimi i panelit..... 36
Kujtesa..... 36
Gjuha..... 36
Njësia e temperaturës..... 37
Niveli i dritës së ekranit..... 37
WLAN..... 37
Informacioni i pajisjes..... 38
Software..... 38
Alarmi i derës..... 38
Modaliteti i demonstrimit..... 39
Rikthimi në cilësimet nga fabrika..... 40
8.3 Mesazhet..... 40
8.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve..... 40
8.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve..... 40
8.3.3 Përmbledhje e kujtesave..... 41
8.3.4 Mënjanimi i kujtesave..... 41

9 Pajisjet..... 42
9.1 Ndarja e ngrirjes me 4 yje*..... 42
9.2 Raftet e derës..... 42
9.3 Raftet mbajtës..... 44
9.4 Rafti mbajtës me ndarje..... 45
9.5 VarioSafe *..... 46
9.6 InfinitySpring*..... 48
9.7 Rafti mbajtës praktik i shisheve..... 48
9.8 Sirtarët..... 49
9.9 Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable..... 50
9.10 HydroBreeze..... 50
9.11 Kutia e ruajtjes së gjalpit..... 51
9.12 Rafti për vezët..... 52
9.13 Mbajtësja e shisheve..... 52
9.14 FlexSystem..... 52
9.15 Forma me kapak e kubave të akullit*..... 53


10 Mirëmbajtja..... 53
10.1 Filtri me karbon aktiv i FreshAir..... 53
10.2 Depozita e ujit*..... 53
10.3 Filtri i ujit*..... 54
10.4 Zbërthimi i raftit të derës..... 54
10.5 Montimi i rafteve të derës..... 55
10.6 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje..... 55
10.7 Heqja / vendosja e raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve..... 55
10.8 Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable..... 56
10.9 Shkrirja e pajisjes..... 56
10.10 Shkrirja manuale e ndarjes së ngrirjes*..... 57
10.11 Pastrimi i pajisjes..... 57

11 Ndihma për klientin..... 58
11.1 Të dhënat teknike..... 58
11.2 Zhurmat gjatë punës..... 58
11.3 Defektet teknike..... 58
11.4 Shërbimi për klientin..... 60
11.5 Etiketa e parametrave..... 60

12 Nxjerrja jashtë pune..... 60

13 Hedhja..... 60
13.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin..... 60
13.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike..... 61

Prodhuesi punon në vazhdimësi për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha llojeve dhe modeleve. Për këtë arsye, lutemi në mirëkuptimin tuaj që ne duhet të rezervojmë të drejtën e ndryshimeve në formë, pajisje dhe teknologji.

Simboli	Shpjegimi
	**Lexoni manualin e instruksioneve** Për t'u njohur me të gjitha avantazhet e pajisjes suaj të re, ku lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet në këtë manual instruksionesh.
	**Informacionet plotësuese në internet** Manualin dixhital me informacionet plotësuese dhe në gjuhë të tjera e gjeni në internet nëpërmjet kodit QR në kopertinën e këtij manuali ose duke futur numrin e servisit në adresën **home.liebherr.com/fridge-manuals**. Numrin e servisit e gjeni në etiketën e parametrave:  *Fig.* Shembull ilustrues
	**Kontrolli i pajisjes** Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin.
	**Ndryshimet** Manuali është i vlefshëm për disa modele, kështu që mund të ketë ndryshime. Seksionet që kanë të bëjnë vetëm me pajisje të caktuara janë të shënuara me një yll (*).
	**Udhëzimet e veprimeve dhe rezultatet e veprimeve** Udhëzimet e veprimeve janë të shënuara me një ▶. Rezultatet e veprimeve janë të shënuara me një ▷.

Simboli	Shpjegimi
	**Videot** Videot për pajisjet ofrohen në kanalin në YouTube të kompanisë Liebherr-Hausgeräte.

Licencat me burim të hapur:

Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu: **home.liebherr.com/open-source-licences**

Ky informacion për përdoruesin vlen për pajisjet e mëposhtme:

IRB..i	41.. / 45.. / 51..
IRBbsbi	41.. / 45..
IRBbsci	51..

1 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

Ruajini me kujdes këto informacione për përdoruesin, për t'i pasur në dispozicion në çdo kohë.

Nëse ia kalojmë pajisjen dikujt tjetër, kalojini pronarit të radhës edhe këto informacione për përdoruesin.

Për ta përdorur pajisjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, lexoni me kujdes këto informacione për përdoruesin përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes. Ndiqni gjithmonë instruksionet që ato përmbajnë, udhëzimet e sigurisë dhe udhëzimet paralajmëruese. Ato janë të rëndësishme, në mënyrë që ta instaloni dhe ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

1.1 Përdorimi i parashikuar

- Kjo pajisje është parashikuar për përdorim në shtëpi dhe në ambiente të ngjashme, si për shembull:
  - Kuzhinat e personelit në dyqane, në zyra dhe ambiente të tjera pune
  - në bujqësi dhe nga vizitorë në hotele, motele dhe strehime të tjera
  - Struktura me fjetje dhe mëngjes
  - në shërbimin katering dhe përdorime të ngjashme në tregtinë me shumicë
- Përdorime të tjera:
  - Kjo pajisje nuk është e përshtatshme për ngrirjen e ushqimeve.*
  - Të gjitha llojet e tjera të përdorimit konsiderohen të palejuara.

1.2 Grupi i përdoruesve

- Kjo pajisje nuk duhet të përdoret nga personat (duke përfshirë edhe fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo persona me mungesë përvoje dhe njohurish, përveç rastit kur ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes nga një person që përgjigjet për sigurinë e tyre. Fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje për t'u siguruar që të mos luajnë me pajisjen.
- Fëmijët e moshës 3 deri 8 vjeç lejohen të mbushin dhe të zbrazin frigoriferin/ngrirësin.

1.3 Udhëzime paralajmërime - Rreziqet për përdoruesin

- PARALAJMËRIM: Mos i pengoni zgavrat e ajrimit në trupin e pajisjes ose në folenë e montimit.
- PARALAJMËRIM: Për të shpejtuar procesin e shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje tjetër mekanike ose ndonjë mënyrë tjetër përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- PARALAJMËRIM: Mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës.
- PARALAJMËRIM: Mos vendosni në punë asnjë pajisje elektrike brenda ndarjes së ftohjes/ngrirjes, të cilat nuk përputhen me mënyrën e ndërtimit të rekomanduar nga prodhuesi.
- PARALAJMËRIM: Kur montoni pajisjen, sigurohuni që kablli i rrjetit të mos ngecë ose mos dëmtohet.
- PARALAJMËRIM: Mos vendosni priza të lëvizshme të shumëfishta ose adaptorë në pjesën e pasme të pajisjes.

Pas montimit me sukses, duhet të jetë ende e mundur ta shkëputni pajisjen nga rrjeti.

- Prizë e arritshme (mbi, nën ose pranë pajisjes)
- Aktivizimi i siguresës në instalimin e godinës, në përputhje me rregullat e instalimit.



PARALAJMËRIM: Lëndë me rrezik djegieje/ zjarri.

Ky simbol ndodhet në kompresor, por mund të jetë i vizatuar edhe në vende të tjera në pajisje. Identifikon rrezikun nga lëndët me rrezik zjarri. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

- Sa më shumë gaz ftohës të ketë në pajisje, aq më e madhe duhet të jetë dhoma ku qëndron pajisja. Në dhomat shumë të vogla mund të krijohet përzierje e ndezshme gaz-ajër, në rast rrjedhjeje të gazit. Dhoma e instalimit duhet të ketë një vëllim minimumi 1 m^3 për çdo 8 g gaz ftohës. Specifikimet për gazin ftohës të pajisjes jepen në etiketën e parametrave, në hapësirën e brendshme të pajisjes.
- Pastroni rregullisht sipërfaqet që mund të kenë kontakt me ushqimet dhe me sistemet e arritshme të shkarkimit të ujit.
- Paketoni në enë/kuti të mbyllur e të pastër mishin ose peshkun e pagatuar. Në këtë mënyrë parandaloni që mishi ose peshku të prekin ushqimet e tjera ose që të pikojnë sipër tyre.
- Nëse frigoriferi/ngrirësi do të qëndrojë bosh për kohë të gjatë, fikeni pajisjen, shkrijeni, pastrojeni dhe lëreni derën hapur për të shmangur formimin e mykut.
- Shmangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me sipërfaqet e ftohta ose ushqimet për ftohje. Për mbrojtjen, përdorni p.sh., doreza.
- Pijet alkoolike ose paketimet e tjera që përmbajnë alkool vendosini në ruajtje të mbyllura në mënyrë hermetike. Alkooli që mund të kenë rrjedhur mund të ndizet nga pjesët elektrike.
- Hapeni derën vetëm për kohë të shkurtra. Në këtë mënyrë shmangni rritjen e temperaturës në brendësi të pajisjes.
- Mos i futni duart midis derës dhe pajisjes gjatë hapjes dhe mbylljes së derës. Gishtat mund të kapen aty.
- Mos vendosni objekte në pjesën e përparme të pllakës së poshtme të xhamit, për të garantuar një mbyllje pa probleme të derës së pajisjes. (shihni 6.2 Pjesa e ftohjes) (shihni 9.2 Raftet e derës)
- PARALAJMËRIM: Kjo pajisje duhet të fiksohet në përputhje me udhëzimin e përdorimit, për të përjashtuar rreziqe nga mungesa e stabilitetit.
- Respektoni udhëzimet për montimin, shtrëngimin, dimensionet e nevojshme dhe lidhjet. (shihni 3 Instalimi dhe lidhja)


Pajisjet me lidhje fikse të ujit:*

- PARALAJMËRIM: Lidheni vetëm në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.
- Respektoni vlerat e lidhjes për furnizimin me ujë. (shihni 3 Instalimi dhe lidhja)
- Lidheni pajisjen në furnizimin e ujit të pijshëm vetëm me një komplet të ri tubash. Mos i ripërdorni kompletet e tubave, por hidhini.
  Një komplet tubash gjendet brenda në pajisje.
- Shpëlani sistemin e ujit, nëse nuk është nxjerrë ujë për më shumë se 5 ditë.

1.4 Defektet, dëmtimet dhe riparimet

- Lidhja e rrjetit me spinë frigoriferi:
  Nëse dëmtohet kablli i lidhjes në rrjet të kësaj pajisjeje, duhet të zëvendësohet me një kabëll lidhës të veçantë, që mund të merret nga prodhuesi ose shërbimi i tij i klientit. Ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.
- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje lejohen të kryhet vetëm nga shërbimi i klientit ose nga staf tjetër teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Kur ka dëmtime ose defekte në pajisje, hiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën. Kur tërhiqet spina e rrjetit, kapeni gjithmonë nga spina. Mos e tërhiqni nga kablli.

1.5 Udhëzime për hedhjen



Koshi i plehrave me vizë sipër tregon që pajisja nuk mund të hidhet në mbeturinat e paklasifikuara komunale dhe duhet të dërgohet në një pikë grumbullimi të ndarë. Përmban lëndë të vlefshme dhe është e riciklueshme.



Simboli mund të gjendet mbi kompresor. Ai ka të bëjë me vajin në kompresor dhe jep udhëzim për rrezikun e mëposhtëm: **Mund të jetë fatal në rast gëlltitjeje ose futjeje në rrugët e frymëmarrjes.** Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Në gjendje pune normale nuk ekziston asnjë rrezik.



Kjo etiketë ngjitëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ajo tregon se te dera dhe/ose tek trupi ka panele izoluese me vakuum (VIP) ose panele me perlit. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

- Për këtë arsye, hedhja e pajisjeve të nxjerra jashtë përdorimit duhet kryer në mënyrë të rregullt dhe profesionale, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme lokale. Mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës gjatë transportit të hedhjes së pajisjes së nxjerrë jashtë përdorimit, në mënyrë që gazi ftohës (shihni specifikimet në etiketën e parametrave) dhe vaji të mos derdhen në mënyrë të pakontrolluar.
- Ju lutemi, kini parasysh që fshirja e të dhënave personale, nëse janë të pranishme, është detyrë e klientit.
- Për Gjermaninë: Në pikat lokale të riciklimit / mbledhjes së materialeve të ripërdorshme, pajisja mund të hidhet pa pagesë në koshat e klasës 1. Në rastin e blerjes së një frigoriferi ftohës / ngrirës dhe një sipërfaqeje dyqani > 400 m^2, pajisja e vjetër mund të kthehet edhe në këtë dyqan.
- BE: Ju lutemi, informohuni pranë autoriteteve lokale rreth mundësive të mënjanimit të pajisjeve të vjetra.

1.6 Konformiteti

Qarku i gazit ftohës është testuar për rrjedhje. Në gjendje të montuar, pajisja është në përputhje me dispozitat përkatëse të sigurisë dhe me rregulloret përkatëse.

Për tregun e BE-së:	Pajisja është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.
Për tregun në GB:	Pajisja është në përputhje me Radio Equipment Regulations 2017 SI 2017 No. 1206.

Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: www.Liebherr.com

Ndarja "BioFresh" plotëson kërkesat e ndarjes së mbajtjes ftohtë sipas standardit DIN EN 62552:2020.

1.7 Klasat e klimës

Pajisja është projektuar sipas klasave të klimës për përdorimin në temperatura mjedisi të kufizuara. Klasa përkatëse e klimës për pajisjen tuaj është e stampuar në etiketën e parametrave.

Shënim

▶ Për të garantuar një përdorim pa probleme të pajisjes, respektoni temperaturat e dhëna të ambientit.

Klasa e klimës	për temperaturat e ambientit nga
SN	10 °C deri në 32 °C
N	16 °C deri në 32 °C
ST	16 °C deri në 38 °C
T	16 °C deri në 43 °C
SN-ST	10 °C deri në 38 °C
SN-T	10 °C deri në 43 °C

1.8 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH

- Në lidhjen në vijim mund të kontrolloni nëse pajisja juaj përmban substanca SVHC, në kuptim të rregullores REACH:
  https://go.liebherr.com/z3eewm

1.9 Baza e të dhënave EPREL

- Nga data 1 mars 2021, informacionet për etiketimin e konsumit të energjisë dhe për kërkesat e dizajnit ekologjik do të disponohen në bazën evropiane të të dhënave të produkteve (EPREL). Në lidhjen e mëposhtme https://eprel.ec.europa.eu/ shkoni te baza e të dhënave të produkteve. Këtu kërkohet që të vendosni emërtimin e modelit. Emërtimin e modelit e gjeni në etiketën e parametrave të produktit.

1.10 Licencat me burim të hapur

- Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu:
  home.liebherr.com/open-source-licences

1.11 Pjesët e këmbimit

- Disponueshmëria e pjesëve të këmbimit për pjesët funksionale dhe pjesët me kapacitet ruajtës të pajimit është 15 vjet.

1.12 Nivelet e paralajmërimit

RREZIK	Identifikon një situatë të rrezikshme të drejtpërdrejtë, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
PARALAJMËRIM	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
VINI RE	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë lëndime të lehta ose mesatare fizike, nëse nuk mënjanohen.
KUJDES	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë dëme materiale, nëse nuk mënjanohet.
Shënim	Identifikon udhëzimet dhe këshillat e dobishme.

2 Pajisja në një vështrim të shpejtë

2.1 Përmbajtja e dërgesës

Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te shërbimi për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Dërgesa përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Pajisje inkaso
- Pajisjet (në varësi nga modeli)
- Materiali i montimit (në varësi nga modeli)
- „Quick Start Guide“
- „Installation Guide“*
- Broshura e shërbimit

2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve




Fig. 1 Shembull ilustrues

Diapazoni i temperaturave

(A) Pjesa e ftohjes **(B)** BioFresh

Pajisjet

(1) Elementët e komandimit
(2) Ndarja e ngrirjes me 4 yje*
(3) Ventilatori me filtrin me karbon aktiv të FreshAir
(4) Rafti mbajtës me ndarje
(5) Rafti mbajtës
(6) InfinitySpring*
(7) VarioSafe*
(8) Rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve
(9) HydroBreeze
(10) Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable
(11) Koshi Fruit & Vegetable
(12) Vrima e shkarkimit
(13) Koshi Meat & Dairy
(14) Etiketa e parametrave
(15) Raftet e derës
(16) VarioBox-et

2.3 SmartDevice

SmartDevice është zgjidhja e lidhjes në rrjet për frigoriferin tuaj ftohës.

Nëse pajisja juaj mbështet SmartDevice ose është përgatitur për të, ju mund ta lidhni pajisjen shpejt dhe thjeshtë në rrjetin tuaj WLAN. Me aplikacionin SmartDevice mund ta komandoni pajisjen tuaj nga një pajisje fundore celulare. Në aplikacionin SmartDevice keni në dispozicion funksione shtesë dhe mundësi rregullimi.

Pajisja që mbështet SmartDevice:	Pajisja juaj mbështet SmartDevice. Për ta lidhur pajisjen tuaj me rrjetin WLAN, duhet që të shkarkoni aplikacionin SmartDevice.
Informacione të tjera për SmartDevice:	**smartdevice.liebherr.com**
Shkarkoni aplikacionin SmartDevice:	

Pas instalimit dhe konfigurimit të aplikacionit SmartDevice mund ta lidhni pajisjen tuaj me ndihmën e aplikacionit SmartDevice dhe të funksionit të pajisjes WLAN (shihni WLAN) .

Shënim
Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

3 Instalimi dhe lidhja

3.1 Kushtet e instalimit

Kushtet e instalimit janë vendosur për të garantuar që mund ta përdorni pajisjen tuaj në mënyrë të sigurt, efikase dhe pa probleme.

- Respektoni udhëzimet e sigurisë.
- Bëni kujdes vendin e instalimit dhe pozicionin në dhomë.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga instalimi i pasaktë!
Kur një kordon elektrik ose spinë prek pjesën e pasme e pajisjes, ekziston mundësia që dridhjet e pajisjes të dëmtojnë kordonin elektrik ose spinën dhe në këtë mënyrë të shkaktohet lidhje e shkurtër.

▶ Bëni kujdes që kur të instaloni pajisjen të mos bllokoni asnjë kordon elektrik poshtë pajisjes.
▶ Instalojeni pajisjen në mënyrë të tillë që të mos prekë me asnjë spinë ose kordon elektrik.
▶ Mos lidhni pajisje të tjera në priza elektrike që ndodhen pas pjesës së pasme të pajisjes.
▶ **Mos** vendosni dhe mos përdorni priza me disa dalje ose priza bashkuese me shumë priza dhe pajisje të tjera elektronike (si për shembull transformatori i ndriçimit halogjen) në anën e pasme të pajisjeve.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga lagështia!
Kur pjesët përçuese të energjisë elektrike ose kordoni i lidhjes elektrike lagen, kjo mund të shkaktojë lidhje të shkurtër.

▶ Pajisja është projektuar për përdorim në ambiente të mbyllura. Mos e vini në punë pajisjen në ambient të jashtëm dhe në vende ku spërkatet nga uji.

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje nga gazi ftohës dhe vaji që del jashtë!
Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.
▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

3.1.1 Vendi i instalimit

- Instalojeni dhe përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
- Pajisja lejohet të vihet në punë vetëm në gjendje të montuar.
- Kur pajisja instalohet në një ambient me shumë lagështi, në anët e jashtme të pajisjes mund të formohet ujë nga kondensimi.
  Kujdesuni gjithmonë për ajrimin dhe ventilimin e mirë në vendin e instalimit.
- Sa më shumë gaz ftohës të ketë në pajisje, aq më e madhe duhet të jetë dhoma ku qëndron pajisja. Në dhomat shumë të vogla mund të krijohet përzierje e ndezshme gaz-ajër, në rast rrjedhjeje të gazit. Dhoma e instalimit duhet të ketë një vëllim minimumi 1 m^3 për çdo 8 g gaz ftohës. Specifikimet për gazin ftohës të pajisjes jepen në etiketën e parametrave, në hapësirën e brendshme të pajisjes.
- Dyshemeja në vendin e qëndrimit duhet të jetë e drejtë dhe e niveluar.

3.1.2 Pozicioni në dhomë

- Mos e montoni pajisjen as në një vend në rrezet direkte të diellit, as pranë sistemit të ngrohjes apo të ngjashme.
- Ju mund ta montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë.
- Kur e montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë, konsumi i energjisë mund të rritet paksa. Kjo varet nga kohëzgjatja e përdorimit dhe nga intensiteti i përdorimit të furrës.
- Montoni pajisjen vetëm në një mobilie që është e fortë.
- Nuk lejohet përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese.

3.2 Përmasat e pajisjes




Fig. 2

IR(B)..(i) 40..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1022

Lartësia e dollapit 1020 - Pajisjet me një derë

IR(B)..(i) 41.. / IRBbsbi 4170 / SIFN..i 41..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1213

Lartësia e dollapit 1220 - Pajisjet me një derë

IR(B)..(i) 45.. / IRBbsbi 4570 / SIFN..i 45..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1395

Lartësia e dollapit 1400 - Pajisjet me një derë

IRB..i 48..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1572

Lartësia e dollapit 1580 - Pajisjet me një derë

IR(B)(P)..(i) 51.. / IRD..i 51.. / IRBbsci 5170 / IRBbsci 5171 / IRBPbsci 5170 / IKB 51Vc50i / IKB 51Vc51i / IK 51Ve00 / IK 51Ve01 / IK 51Vd00 / SIFN..(i) 51.. / SIFNbsdi 51.. / IK(B).. 1780 / IK(B).. 1784 / SIGN 51Vd28	
A (mm)	559
B (mm)	546

IR(B)(P)..(i) 51.. / IRD..i 51.. / IRBbsci 5170 / IRBbsci 5171 / IRBPbsci 5170 / IKB 51Vc50i / IKB 51Vc51i / IK 51Ve00 / IK 51Ve01 / IK 51Vd00 / SIFN..(i) 51.. / SIFNbsdi 51.. / IK(B).. 1780 / IK(B).. 1784 / SIGN 51Vd28	
C (mm)	1770

Lartësia e dollapit 1780 - Pajisjet me një derë

3.3 Dimensionet e dollapit




Fig. 3 ***(K):*** *maks. 2100 mm*

Në pajisjet me lidhje fikse të ujit, mbani parasysh informacionet e mëposhtme:

- Sistemi i furnizimit me ujë (shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë*)
- Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë (shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë*)

IR(B)..(i) 40..	
F (mm)	1024 deri në 1040
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IR(B)..(i) 41.. / IRBbsbi 4170 / SIFN..i 41..	
F (mm)	1216 deri në 1236
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IR(B)..(i) 45.. / IRBbsbi 4570 / SIFN..i 45..	
F (mm)	1397 deri në 1413

IR(B)..(i) 45.. / IRBbsbi 4570 / SIFN..i 45..	
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IRB..i 48..	
F (mm)	1574 deri në 1590
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IC(B)(N)..(i) 51.. / ICBNbsci 5173 / IKG 51Ve03 / IKGN 51Vc03 / ICNbsci 5173 / IKGN 51Ve03 / IKGBN 51Vd23i / IR(B)(P)..(i) 51.. / IRD..i 51.. / IRBbsci 5170 / IRBbsci 5171 / IRBPbsci 5170 / IKB 51Vc50i / IKB 51Vc51i / IK 51Vd00 / IK 51Ve00 / IK 51Ve01 / IK(B).. 1780 / IK(B).. 1784 / IKGNc 1783 / SICN..i 51.. / SIFN..(i) 51.. / SIFNbsdi 51.. / SIGN 51Vd28 / IC(B)Ndx 5173	
F (mm)	1772 deri në 1788
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

Konsumi i deklaruar i energjisë është përcaktuar me një mobilie kuzhine me thellësi 560 mm. Pajisja është plotësisht funksionale edhe në një dollap kuzhine me thellësi 550 mm, por ka një konsum energjie paksa më të lartë.

- ▶ Kontrolloni trashësinë e faqes së mobilies ngjitur: Ajo duhet të jetë minimumi 16 mm .
- ▶ Montoni pajisjen vetëm në një mobilie kuzhine që është e qëndrueshme dhe e fortë. Siguroni mobilien kundër përmbysjes.
- ▶ Niveloni mobilien e kuzhinës me një nivelues me lëng dhe vizore skuadër dhe rregulloni lartësinë duke futur diçka poshtë saj, nëse nevojitet.
- ▶ Sigurohuni që dyshemeja dhe faqet anësore të mobilies janë në kënd të drejtë me njëra-tjetrën.

3.3.1 Kërkesat e ajrimit

KUJDES
Vrimat e ajrimit të mbuluara!
Dëmtime. Pajisja mund të mbinxehet, gjë e cila shkurton jetëgjatësinë e pjesëve të ndryshme të pajisjes dhe mund të çojë në kufizime të funksionimit.

- ▶ Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin.
- ▶ Mbani gjithmonë të lira vrimat ose rrjetën e ajrimit në trupin e pajisjes dhe në mobilien e kuzhinës (pajisja inkaso).
- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.

Respektoni patjetër seksionin tërthor të ajrimit:

- Thellësia e hapësirës së ventilimit në faqen e pasme të mobilies duhet të jetë minimumi 38 mm.

- Për seksionet tërthore të ajrimit dhe ventilimit në bazamentin e mobilies dhe modifikimin e mobilies lart, nevojitet minimumi 200 cm^2.
- Parimi i përgjithshëm është: Sa më i madh seksioni tërthor i ajrimit, aq më shumë energji kursen pajisja në punën e saj.

Për funksionimin e pajisjes nevojitet një hapësirë e mjaftueshme për ajrimin dhe ventilimin. Rrjetat e ajrimit të parashikuara nga fabrika garantojnë një seksion tërthor ajrimi efektiv në pajisje prej 200 cm^2. Nëse i zëvendësoni rrjetat e ajrimit me një kapak mbulues, duhet që ky i fundit të ketë të paktën një seksion tërthor ajrimi të barabartë ose më të madh sesa rrjeta e ajrimit e prodhuesit.

3.4 Peshat e kanateve të mobilies

KUJDES
Rrezik dëmtimi për shkak të derës së rëndë të mobilies! Nëse dera e mobilies është shumë e rëndë, nuk përjashtohet mundësia e dëmtimeve të menteshave dhe e problemeve në funksionim si rezultat i këtyre dëmtimeve.

▶ Përpara montimit të derës së mobilies sigurohuni që nuk kapërcehet pesha e lejuar e derës së mobilies.

Lartësia e dollapit (mm)	Pesha maksimale e derës së mobilies (kg)
720	16
880	16
1020	13
1220	19
1400	21
1580	22
1780	26

Frigoriferët ftohës dhe ngrirës me një derë

3.5 Sistemi i furnizimit me ujë*

Nëse pajisja juaj është e pajisur me një lidhje fikse të ujit, brenda në pajisje do të gjeni edhe tubin përkatës.

Shënim
Ju mund të blini si aksesor edhe një tub me gjatësi tjetër.

Përmbledhje e dimensioneve të sistemit të furnizimit me ujë:	(shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë*)
Kërkesat për presionin e ujit:	(shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë*)
Realizimi i sistemit të furnizimit me ujë:	(shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë*)

3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë




Fig. 4
(a) Gjatësia maksimale në dispozicion e tubit
(b) Gjatësia maksimale në dispozicion e tubit
(c) Distanca e elektrovalvulës nga toka
(M) Elektrovalvula

a	b	c
~ 1200 mm	~ 1200 mm	~ 55 mm

3.5.2 Presioni i ujit

Linja e sistemit të furnizimit me ujë dhe elektrovalvula e pajisjes janë të përshtatshme për një presion uji deri në 1 MPa (10 bar).

Për të garantuar një funksionim pa probleme të pajisjes (sasia e qarkullimit, madhësia e kubave të akullit, niveli i zhurmës), respektoni presionin e ujit më poshtë:

Presioni i ujit:	
bar	MPa
1,5 deri në 6,2	0,15 deri në 0,62

Presioni i ujit kur përdoret filtri i ujit:*	
bar*	MPa*
2,8 deri në 6,2	0,28 deri në 0,62

Nëse presioni është më i lartë se 6,2 bar:
▶ Instaloni një reduktor presioni.
▶ Realizoni sistemin e furnizimit me ujë. (shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë*)

3.6 Transportimi i pajisjes

3.6.1 Transportimi i pajisjes për vënien e parë në punë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ Pajisja është e paketuar.
❑ Pajisja qëndron vertikalisht.

▶ Transportojeni pajisjen me dy persona.
▶ Shpaketoni pajisjen. (shihni 3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi)

3.6.2 Transportimi i pajisjes pas vënies së parë në punë

Ndiqni udhëzimet e mëposhtme, nëse doni ta transportoni sërish pajisjen pas vënies së parë në punë ose nëse doni ta zhvendosni.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ Pajisja është boshatisur.
❑ Pajisja qëndron vertikalisht.
❑ Pajisja me derë (dyer): Dera është e sigurt kundër hapjes së padëshiruar.
❑ Pajisja me kosh me tërheqje: Koshi me tërheqje është i siguruar kundër hapjes së padëshiruar.
❑ Pajisja është e çmontuar.

▶ Transportojeni pajisjen me dy persona.

3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga lëvizja e pajisjes!
Kur e lëvizni pajisjen në dysheme pa mbrojtje, pajisja mund të dëmtojë dyshemenë.
▶ Mbulojeni dyshemenë mjaftueshëm përpara se të hiqni paketimin e pajisjes.

▶ Kontrolloni pajisjen dhe paketimin: Nëse dyshoni për dëmtime transporti, kontaktoni furnizuesin para lidhjes së pajisjes.

KUJDES
Dëme materiale nga objektet me majtë ose të mprehta!
Nëse përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues, mund të dëmtoni pajisjen.
▶ Mos përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues.

▶ Hiqni materialet paketuese.

3.8 Shpjegimi i simboleve të përdorura

	Në këtë hap të veprimit ekziston rrezik lëndimi! Ndiqni këto udhëzime të sigurisë!
	Instruksionet janë të vlefshme për disa modele. Kryeni këtë hap vetëm kur ato kanë lidhje me pajisjen tuaj.
	Për montimin ndiqni përshkrimin e hollësishëm në pjesën e tekstit të instruksioneve.
	Seksioni është i vlefshëm ose për pajisjet me një derë, ose për pajisjet me dy dyer.
	Zgjidhni midis alternativave: Pajisjen me hapje nga e djathta ose pajisjen me hapje nga e majta.
	Hap montimi i nevojshëm te IceMaker dhe / ose InfinitySpring.
	Vidat vetëm duhen liruar ose duhen tërhequr pak.
	Shtrëngoni fort vidat.
	Kontrolloni nëse hapi vijues i punës është i nevojshëm për modelin tuaj.
	Kontrolloni montimin e duhur / qëndrimin e duhur të pjesëve të përdorura.
	Bëni matje duke i krahasuar me dimensionet e dhëna dhe bëni korrigjime kur nevojitet.
	Vegla e punës për montimin: Metër shirit
	Vegla e punës për montimin: Kaçavidë elektrike dhe instalimi Për arritjen më të lehtë të vidave, rekomandohet përdorimi i një maje më të gjatë.
	Vegla e punës për montimin: Nivelues me lëng
	Vegla e punës për montimin: Çelës pirun me SW 7 dhe SW 10
	Për këtë hap të punës nevojiten dy persona.
	Hapi i punës kryhet në vendin e shënuar të pajisjes.
	Vegla ndihmëse për montimin: Spango
	Vegla ndihmëse për montimin: Përmasa këndore
	Vegla ndihmëse për montimin: Kaçavidë
	Vegla ndihmëse për montimin: Gërshërët
	Vegla ndihmëse për montimin: Laps shënimi, që fshihet

	Ambalazhi: Hiqni komponentët
	Hidhni sipas rregullave pjesët që nuk nevojiten më.

3.9 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës së ndarjes së ngrirjes me 4 yje*

Ju mund ta ndryshoni krahun e hapjes së derës së ndarjes së ngrirjes me 4 yje me një dorezë të thjeshtë. Kur është e mundur që dera e pajisjes të hapet më shumë se 115° (1), ndarjen e ngrirjes mund ta hapni edhe pa e ndërruar krahun e hapjes së derës. Nëse këndi i hapjes së derës së pajisjes është më i vogël (2), atëherë ndërrimi i krahut të hapjes së derës është i domosdoshëm.

Rrëshqitësja për ndërrimin e krahut të hapjes së derës ndodhet poshtë në faqen e pasme të derës së ndarjes së ngrirjes me 4 yje.




Fig. 5




Fig. 6

- ▶ Mbyllni derën e ndarjes së ngrirjes me 4 yje (1).
- ▶ Kapni nga poshtë derën e ndarjes së ngrirjes me 4 yje.
- ▶ Shtyni rrëshqitësen (2) majtas ose djathtas.

3.10 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës

Veglat e punës



Fig. 7

KUJDES
Pjesë që përçojnë energji elektrike!
Dëmtim i pjesëve elektrike.

- ▶ Hiqni spinën elektrike nga priza përpara se të kryhet ndërrimi i krahut të hapjes së derës.




Fig. 8

- ▶ Heqja e amortizatorit të mbylljes: Shkëputni amortizatorin e mbylljes nga koka sferike (1), lironi vidat e mbajtëses (2). Çmontoni kokat sferike me kaçavidë (3).

Shënim
Kur amortizatori i mbylljes ndodhet pikërisht sipër dyshemesë, ju mund ta hiqni kokën sferike vetëm kur dera është e çmontuar.




Fig. 9

- ▶ Hiqni kapakët mbulues.

Shënim
Kur të hiqni kapakët mbulues bëni kujdes që të mos gërvishtet sipërfaqja.




Fig. 10

▶ Lironi vidat në **të gjitha** menteshat, mos i hiqni fare.




*Fig. 11 **

▶ Heqja e derës: Shtyjeni derën nga përpara dhe më pas nga jashtë, nxirreni nga varja dhe vëreni mënjanë.




Fig. 12

▶ Lironi të gjitha menteshat dhe vërini mënjanë bashkë me vidat.




Fig. 13

▶ Lironi profilin lart dhe poshtë nga dera dhe ndërrojini krahët. Profilit i duhet ndërruar krahu në mënyrë që të mbërthehen menteshat.




Fig. 14

▶ Shkëmbeni vidat për mbërthimin e menteshave. Pas ndërrimit të krahut mos i mbërtheni vidat fort, sepse më vonë duhen varur menteshat.




Fig. 15

▶ Shkëmbeni profilin e mbërthimit në anën tjetër.

* Në varësi nga modeli dhe pajisja




Fig. 16

▶ Ktheni të gjitha mentesha në anën e kundërt duke i rrotulluar me 180° dhe mbërthejini fort me vidat.




*Fig. 17 **

▶ Montimi sërish i derës: Varni derën me menteshat dhe shtrëngoni vidat.




Fig. 18

▶ Montimi sërish i amortizatorit të mbylljes: Vidhosni kokat sferike (1), shtrëngoni mbajtëset (2) dhe futni amortizatorin e mbylljes në kokën sferike.

▶ Kontrolloni të gjitha vidat dhe shtrëngojini përsëri nëse nevojitet.




Fig. 19

▶ Montoni sërish kapakun mbulues poshtë dhe në mes. Pjesën e mbetur të kapakëve mbulues montojini përsëri vetëm pas instalimit në mobilie.

3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë*

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Dimensionet për lidhjen në furnizimin me ujë njihen dhe janë respektuar. (shihni 3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë)
- ❑ Është respektuar presioni i ujit. (shihni 3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë)
- ❑ Furnizimi me ujë i pajisjes kryhet përmes linjës së ujit të freskët që ruan presionin e punës dhe është i lidhur në furnizimin me ujë të pijshëm.
- ❑ Të gjitha pajisjet dhe aksesorët që përdoren për furnizimin me ujë janë në përputhje me rregullat në fuqi të shtetit përkatës.
- ❑ Faqja e pasme e pajisjes është e arritshme, në mënyrë që të lidhni pajisjen në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.
- ❑ Është përdorur tubi i ofruar. Tubat e vjetër janë hedhur.
- ❑ Në rakordin e lidhjes së tubit ndodhet filtri rrjetë me guarnicionin.
- ❑ Midis linjës së tubit dhe linjës së ujit të shtëpisë ndodhet një saraçineskë uji, që të ndërpritni furnizimi me ujë, nëse nevojitet.
- ❑ Saraçineska e ujit ndodhet jashtë zonës së faqes së pasme të pajisjes dhe është lehtësisht e arritshme. Në këtë mënyrë, ju mund ta shtyni pajisjen brenda në dollapin e mobilies sa më thellë dhe në rast nevoje mund ta mbyllni shpejt saraçineskën e ujit.

PARALAJMËRIM

Rrezik i goditjes elektrike nga uji!

▶ Përpara lidhjes në tubin e ujit: Shkëputni pajisjen nga priza elektrike.

▶ Përpara lidhjes në linjën e hyrjes së ujit: Mbyllni furnizimin me ujë.

▶ Sigurohuni që ta lidhni pajisjen në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm vetëm me staf teknik të kualifikuar.

PARALAJMËRIM

Rrezik helmimi nga uji i papastër!

▶ Lidheni vetëm në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.

3.11.1 Lidhja e tubit




Fig. 20




Fig. 20

(1) Dadoja
(2) Skaji i kthyer i tubit
(3) Mbajtësja
(4) Skaji i drejtë i tubit
(5) Saraçineska e ujit
(6) Elektrovalvula: Elektrovalvula është poshtë në faqen e pasme të pajisjes. Ajo ka një filetë lidhjeje R3/4.

KUJDES
Rrezik dëmtimi për shkak të montimit të gabuar!
▶ Mos dëmtoni ose mos përthyeni tubin gjatë montimit.
▶ Mos dëmtoni ose mos përthyeni tubin gjatë instalimit në dollapin e mobilies.

Lidhja e tubit në pajisje:
▶ Poziciononi skajin e kthyer të tubit *Fig. 20 (2)* horizontalisht në mbajtëse *Fig. 20 (3)* dhe mbajeni fort.
▶ Mbërtheni me dorë dadon *Fig. 20 (1)* në filetë, derisa të arrihet një qëndrim i sigurt dhe i fiksuar.
▷ Tubi është lidhur në pajisje.

Lidhja e tubit në saraçineskën e ujit:
▶ Lidhni skajin e drejtë të tubit *Fig. 20 (4)* në saraçineskën e ujit *Fig. 20 (5)*.
▷ Tubi është lidhur në saraçineskën e ujit.

3.11.2 Kontrolli i sistemit të furnizimit me ujë

Përpara se ta instaloni pajisjen plotësisht brenda dollapit të mobilies, Liebherr rekomandon që të kryeni një kontroll të hermeticitetit të sistemit të ujit.
▶ Vendosni depozitën e ujit të InfinitySpring. *
▶ Vendosni filtrin e ujit të InfinitySpring. *
▶ Hapni ngadalë saraçineskën e ujit.
▶ Kontrolloni nëse tubat, furnizimi me ujë dhe pikat e lidhjes kanë rrjedhje.
▷ Hermeticiteti i sistemit të furnizimit me ujë është kontrolluar.
▷ Sistemi i ujit është hermetik: Ju mund ta instaloni pajisjen plotësisht brenda dollapit të mobilies.

Shënim
InfinitySpring: Përpara përdorimit të parë duhet që të vendosni në funksionim InfinitySpring. Për këtë, duhet që sistemi i ujit të jetë pastruar dhe të jetë nxjerrë ajri prej tij. (shihni Quick Start Guide ose manualin e përdorimit)*

3.12 Instalimi i pajisjes

VINI RE
Rrezik lëndimi nga dera e rëndë!
▶ Transportoni pajisjen për në vendin e instalimit me dy persona.

PARALAJMËRIM
Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga paqëndrueshmëria e pajisjes!
Pajisja mund të përmbyset.
▶ Fiksoni pajisjen në përputhje me instruksionet.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri dhe dëmtimi!
▶ Mos vendosni mbi pajisje aparatura që çlirojnë nxehtësi, p.sh. mikrovalë, tost etj.!

Montoni pajisjen brenda në mobilien e kuzhinës mundësisht me një teknik montimi.

Mos e instaloni pajisjen vetëm pa ndihmë.

3.12.1 Pas instalimit

▶ Hiqni të gjitha pjesët siguruese të transportit.





Fig. 21

▶ Hiqni siguruesen e transportit në dyert e pajisjes.



*

▶ Pastroni pajisjen (shihni instruksionet e përdorimit, Pastrimi i pajisjes).

3.13 Instalimi i disa pajisjeve

Pajisjet janë projektuar për lloje të ndryshme instalimi. Nëse dëshironi që të instaloni disa pajisje pranë ose sipër njëra-tjetrës, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Instaloni pranë ose sipër njëra-tjetrës vetëm pajisje që janë të projektuara për këtë qëllim.
❑ Ndiqni shënimet dhe tabelën e mëposhtme.

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga uji i kondensimit!
▶ Mos e instaloni pajisjen direkt ngjitur me një frigorifer tjetër ftohës/ngrirës.

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga uji i kondensimit!
▶ Mos e instaloni pajisjen direkt mbi një pajisje tjetër ftohëse/ngrirëse.

Modeli	Lloji i instalimit
Të gjitha modelet	Më vete
Modelet, emërtimi i të cilave fillon me **S...**.	Side-by-Side (SBS)

Modeli	Lloji i instalimit
Modelet me lartësi maksimale dollapi deri në 880 mm dhe me kapak me ngrohje mund të instalohen „sipër njëra-tjetrës“. Pajisja e sipërme: deri në lartësi dollapi maksimale 140 mm	Mbi njëra-tjetrën

Modelet dhe lloji i tyre i instalimit




Fig. 22

Montoni secilën pajisje në një dollap mobilieje të veçantë.

3.14 Hedhja e paketimit

PARALAJMËRIM

Rrezik mbytjeje nga materiali i paketimit dhe fletët mbështjellëse!

▶ Mos lejoni fëmijët të luajnë me materialet e paketimit.

Paketimi është i prodhuar nga materiale të ripërdorshme:

- Karton i valëzuar/karton
- Pjesë nga polistiroli i shkumëzuar
- Fletë mbështjellëse dhe qeska prej polietileni
- Shirita prej polipropileni
- Kornizë druri e mbërthyer me gozhda, me shtresa prej polietileni*

▶ Dërgoni materialin e paketimit në një pikë të autorizuar grumbullimi.

3.15 Montimi në dollap

Montimi i pajisjes në dollap bëhet sipas këtyre hapave kryesorë:

- Përgatitni veglat e punës.
- Kontrolloni pjesët e montimit në paketim.
- Përgatitni dollapin.
- Përgatitni sistemin e furnizimit me ujë.
- Përgatitni lidhjen e rrjetit.
- Përgatitni pajisjen.
- Niveloni pajisjen.
- Fiksoni pajisjen.
- Vendosni shinën niveluese.
- Montoni faqen ballore të mobilies.
- Niveloni faqen ballore të mobilies.
- Kontrolloni montimin.
- Vendosni kapakun mbulues.

3.15.1 Përgatitja e veglave të punës




Fig. 23

3.15.2 Kontrollimi i pjesëve të montimit në paketim




Fig. 24




*Fig. 25 **




Fig. 26




*Fig. 27 **




*Fig. 28 **




Fig. 29




*Fig. 30 **




Fig. 31




*Fig. 32 **




Fig. 33




*Fig. 34 **




*Fig. 35 **

*** Në varësi nga modeli dhe pajisja**

3.15.3 Përgatitja e dollapit




Fig. 36

▶ Ndani ndihmësen e montimit në pjesën me vrima të vogla.




Fig. 37

KUJDES
Thellësi e gabuar montimi e pajisjes.

▶ Kur montoni pajisjen: Përdorni ndihmësen e montimit.

▶ Vidhosni ndihmësen e montimit djathtas dhe majtas në bazamentin e dollapit.
▷ Kllapat e montimit janë e vendosur në nivel me faqen anësore të mobilies.

3.15.4 Përgatitja e sistemit të furnizimit me ujë




*Fig. 38 **

▶ Instalojeni sistemin e furnizimit me ujë sipas udhëzimeve në udhëzuesin e përdorimit.*

3.15.5 Përgatitja e lidhjes së rrjetit




Fig. 39

▶ Merrni kordonin e lidhjes elektrike nga qesja e aksesorëve.
▶ Futni fishën e frigoriferit të kordonit të lidhjes elektrike plotësisht në prizën në pajisje, në pjesën e pasme të pajisjes.
▷ Foleja e kabllit të rrymës është fiksuar mirë në spinën e pajisjes.




Fig. 40

▶ Shtrini kabllin e lidhjes në rrjet drejt një prize lehtësisht të arritshme, me ndihmën e kordonit.
▷ Kablli i lidhjes në rrjet mund të futet në prizë pas montimit të pajisjes.

3.15.6 Përgatitja e pajisjes




Fig. 41

▶ Futni panelin balancues në pjesën e sipërme të pajisjes.
▷ Paneli mund të zhvendoset nga të dyja anët.




Fig. 42

Kur kanatet e kuzhinës kanë doreza mobiliesh:

▶ Montoni një çift të profilit këndor mbërthyes anësor në lartësinë e dorezave të ardhshme të derës së mobilies.




Fig. 43

Montoni çiftin tjetër të profilit të mbërthimit në dyert e mëdha.

▶ Montoni profilin fiksues poshtë traversës fiksuese.




Fig. 44

▶ Pas montimit palosni kapakët mbulues mbi profilin e mbërthimit.

PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga lidhja e shkurtër!

▶ Kur shtyni pajisjen brenda në dollap: Mos përthyeni, mos kapni ose mos dëmtoni kordonin e lidhjes elektrike.

▶ Mos e vini në punë pajisjen me kordon elektrik të dëmtuar.




Fig. 45

▶ Futni pajisjen në 2/3 e saj brenda në dollapin e mobilies.




Fig. 46




Fig. 47

▶ Kontrolloni nëse faqja anësore e mobilies ka trashësi 16 mm ose 19 mm.




Fig. 48




Fig. 49




*Fig. 50 **

▶ Faqja e mobilies 16 mm: Futeni pjesën distancuese në gjitha menteshat.

-ose-

▶ Faqja e mobilies 19 mm: mos e përdorni pjesën distancuese.




Fig. 51

▶ Hapni derën.
▶ Zbërtheni kapakun mbulues lart majtas.
▶ Hiqni kapakun mbulues.




Fig. 52

▶ Shtrëngoni paksa profilin e mbërthimit.
▷ Profili mund të zhvendoset.
▶ Mbyllni derën.




Fig. 53

▶ Futeni pajisjen plotësisht brenda në dollapin e mobilies.

3.15.7 Nivelimi i pajisjes




Fig. 54

▶ Poziciononi këmbët me rregullim në vrimat e ndihmëses së montimit.
▶ Hapni derën.




Fig. 55

▶ Lironi ndaluesen e ndihmëses së montimit duke e lëvizur.
▶ Nëse nevojitet, shkëputeni me pincë.




Fig. 56

▶ Kontrolloni nëse pajisja qëndron rrafsh në dollapin e mobilies.
▷ Profili i mbërthimit lart majtas qëndron i fiksuar në faqen anësore të dollapit të mobilies.




Fig. 57

Niveloni pjerrësinë e pajisjes nëpërmjet këmbëve me rregullim.
▶ Zbërtheni këmbën me rregullim:
▷ Pajisja anon mbrapa.
▶ Mbërtheni këmbën me rregullim:
▷ Pajisja anon përpara.




Fig. 58

▶ Shtypeni profilin e mbërthimit në faqen anësore të dollapit të mobilies.
▶ Fiksoni vidat.




Fig. 59

- ▶ Shkëputni ndaluesen nga profili.
- ▶ Hidhni ndaluesen.
- ▶ Mbyllni derën.
- ▶ Niveloni pajisjen nëpërmjet këmbëve me rregullim. *Fig. 54 ()*




Fig. 60

- ▷ Faqja anësore e mobilies me trashësi 16 mm: pjesët distancuese qëndrojnë në faqen anësore të dollapit në anën e menteshës. *()*




Fig. 61

- ▷ Muret anësore të mobilies me trashësi 19 mm: buza e përparme e menteshës është niveluar në raport me anën e përparme të faqes anësore të mobilies. *Fig. 61 ()*

3.15.8 Fiksimi i pajisjes




*Fig. 62 **

- ▶ Hapni derën.
- ▶ Mbërtheni me vida pajisjen në anën e menteshave.

3.15.9 Vendosja e shinave niveluese

Në lartësi dollapi nga 1400 mm, ju duhet që të montoni shina nivelimi poshtë pajisjes. Shinat e nivelimit **zvogëlojnë nivelin e zhurmës**. Në lartësitë e dollapit nga 1400 mm, në qesen e aksesorëve ofrohen dy shina nivelimi dhe një dorezë montimi.




Fig. 63

- ▶ Futni dorezën e montimit *Fig. 63 (1)* në shinën e nivelimit *Fig. 63 (2)*.




Fig. 64




Fig. 65

- ▶ Futni shinën e nivelimit brenda në udhëzuesin në bazamentin e pajisjes dhe shtyjeni deri në fund.
- ▶ Hiqni dorezën e montimit dhe futeni në shinën e dytë të nivelimit.
- ▶ Futni shinën e dytë të nivelimit brenda në udhëzuesin në bazamentin e pajisjes dhe shtyjeni deri në fund.
- ▶ Hiqni dorezën e montimit.
- ▷ Pajisja është niveluar.

3.15.10 Montimi i faqes ballore të mobilies




Fig. 66

▶ Mbyllni derën.
▶ Kontrolloni distancën midis buzës së sipërme të derës së pajisjes dhe mbajtëses së traversës fiksuese.
▷ Distanca midis buzës së sipërme të derës së pajisjes dhe traversës fiksuese është 8 mm.




Fig. 67

▶ Ngrini lart ndihmëset e montimit.




Fig. 68

▷ Buza e poshtme ndaluese e ndihmëses së montimit është në lartësinë e buzës së sipërmes të derës për montim.




Fig. 69

▶ Lironi dadot.
▶ Hiqni traversën fiksuese.




Fig. 70

▶ Varni traversën fiksuese në anën e brendshme të derës së mobilies.
▷ Traversa fiksuese është niveluar në mes.




Fig. 71

▶ Mbërtheni traversën fiksuese me 6 vida.




Fig. 72

▶ Montoni traversën fiksuese me të paktën 4 vida në dyert kasetë.
▶ Montojini vidat në dyert me kasetë mundësisht sa më jashtë.




Fig. 73

▶ Nxirrni jashtë ndihmëset e montimit.
▶ Shtyni duke rrotulluar ndihmëset e afërta të montimit në vrimën e futjes së traversës fiksuese.




Fig. 74

▶ Futni lart kapakun mbulues në anën e dorezës së derës në traversën fiksuese.*
▶ Mbërtheni kapakun mbulues në traversën e mbërthimit.




Fig. 75

▶ Vendosni derën e mobilies.*
▶ Vidhosni dadot lirshëm tek bulonat.

3.15.11 Nivelimi i faqes ballore të mobilies




Fig. 76

Niveloni derën e mobilies në drejtimin X dhe Y nëpërmjet vidave:*

▶ Lironi dadot.
▶ Niveli i derës së mobilies në drejtimin X.
▶ Rrotulloni vidat lart ose poshtë.
▶ Niveli i derës së mobilies në drejtimin Y.




Fig. 77

▶ Shtrëngoni dadot.
▶ Kontrolloni lartësinë e rregullimit.
▷ Lartësia e rregullimit është midis 3 mmdhe 13 mm.
▷ Dera e mobilies është niveluar në drejtimin X dhe Y.*




Fig. 78

▶ Kontrolloni distancën e derës nga dyert përreth të mobilies.
▷ Distanca midis dyerve të mobilies dhe derës së pajisjes është e njëjtë rreth e qark.*




Fig. 79

▶ Hapni kapakët mbulues.




Fig. 80

▶ Niveloni buzët e përparme të profilit të mbërthimit paralelisht me buzën e derës së mobilies.
▶ Fiksoni profilin.




Fig. 81

▶ Hapni nga lart kapakët mbulues.




Fig. 82

Niveloni derën e mobilies me vrimat gjatësore në drejtimin Z:*




Fig. 83

▶ Lironi vidat në traversën fiksuese.




Fig. 84

▶ Shpalosni kapakët mbulues në profilet e mbërthimit.




Fig. 85

▶ Lironi vidat në të gjitha profilet e mbërthimit.




Fig. 86

▶ Shtyni derën në drejtimin Z.
▶ Shtrëngoni vidat.




Fig. 87

▶ Hapni nga lart kapakët mbulues.
▶ Mbyllni derën.
▷ Dera e mobilies është niveluar në drejtimin Z.*

3.15.12 Kontrollimi i montimit

▶ Kontrolloni pikat e mëposhtme për t'u siguruar që pajisja është instaluar saktë. Përndryshe mund të ndodhë formim akulli, formim i ujit nga kondensimi dhe probleme në funksionim.




Fig. 88

▷ Dera mbyllet saktë.
▷ Dera e mobilies nuk mbështetet në dollapin e mobilies.
▷ Distanca midis dollapit të mobilies dhe trupit të mobilies është kontrolluar.
▷ Të gjitha vidat janë të kontrolluara.

3.15.13 Vendosja e kapakëve mbulues

▶ Hapni derën.




Fig. 89

▶ Vendoseni kapakun mbulues lart majtas.




Fig. 90

▶ Vendosni kapakun e sipërm mbulues.*




*Fig. 91 **

▶ Vendoseni kapakun mbulues në menteshën e poshtme.*




Fig. 92

▶ Shtyni panelin balancues në anën e dorezës.
▷ Paneli balancues qëndron në faqen anësore të mobilies.




Fig. 93

Montoni profilin magnetik:

▶ Në rast nevoje: Pritni shiritin izolues në gjatësinë e nevojshme me një gërshërë të mprehtë.




Fig. 94

▶ Vendosni shiritin izolues poshtë kapakut të majtë të sipërm mbulues dhe ngjisheni.

3.16 Kanatet e mobilieve

3.16.1 Dimensionet

Në varësi nga varianti i pajisjes, mund t'ju nevojitet një derë mobilieje ose dy të tilla. Dimensionet e derës(dyerve) përkatëse të mobilies varet nga madhësia totale e dollapit dhe nga trashësia e dollapit të mobilies.

Shënim
Mbani parasysh dimensionet përkatëse të pajisjes dhe të dollapit, si dhe skicat e instalimit.

Udhëzimet e përgjithshme:

- Ndiqni këshillat tona specifike për pajisjen, lidhur me madhësinë dhe peshën për montimin me derë fikse. (shihni 3.4 Peshat e kanateve të mobilies)
- Trashësia e dollapit të mobilies duhet të jetë minimumi 16 mm dhe maksimumi 19 mm.

Dyert e tjera të mobilies lart, poshtë ose anash:

- Madhësia e hapësirës vertikale midis dyerve të mobilies duhet të jetë 4 mm.
- Madhësia e hapësirës horizontale midis dyerve të mobilies duhet të jetë 4 mm. Verifikoni këtu karakteristikat kundër përplasjes. (shihni 3.16.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje)

Pesha dhe menteshat:

- Ngarkesa e menteshës është shumë e madhe në kanatet e rënda të mobilieve. Kështu që mentesha dëmtohet lehtë. Për këtë shihni specifikimet maksimale të peshës për pajisjen tuaj në kapitullin Peshat e kanateve të mobilies (shihni 3.4 Peshat e kanateve të mobilies) .
- Nëse kanati i mobilies tejkalon peshën maksimale të lejuar, montimi i një pajisjeje mund të zgjidhet me ndihmën e teknikës së derës me rrëshqitje, sepse pesha shpërndahet në disa mentesha të fshehura të mobilies.
- Nëse përdorni kanate të gjata mobilieje që zgjaten shumë përtej pajisjes, atëherë ne këshillojmë një menteshë dere shtesë (p.sh. Kamat), që ka patjetër të njëjtën pikë rrotullimi si mentesha e derës fikse e përdorur në pajisjen tuaj. Nga përdorimi i një menteshe tjetër (Kamat), pesha shpërndahet nëpër disa pika. Në kanatet e larta të mobilieve rekomandohet përdorimi i një aksesori balancues të frezuar, për të vepruar kundër një deformimi të mundshëm (konveks/konkav).

3.16.2 Montimi i kanatit(eve) të mobilies

Gjatë instalimit mbani parasysh:

- Kanati i mobilies duhet të montohet simetrik me derën e frigoriferit.
- Kanati ngjitur i mobilies duhet të jetë saktësisht në të njëjtin nivel.
- Kanati ngjitur i mobilies ka të njëjtin rreze këndi si kanati i pajisjes.
- Kanati i mobilies është i drejtë dhe pa tendosje.
- Kanati i mobilies ka një rregullim minimal thellësie prej rreth 2 mm me dollapin.

▶ Instaloni pajisjen në dollap.
▶ Mbërtheni kanatin e mobilies në derën e pajisjes.
▶ Rregulloni gjerësinë e fugës.
▶ Verifikoni kanatin e mobilies për përplasje. (shihni 3.16.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje)

3.16.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje

3.16.3 Gjerësia e fugës me faqen e mobilies ngjitur




Fig. 95 Gjerësia e fugës me faqen e mobilies ngjitur

(F) Trashësia e ballinës
(X) Gjerësia minimale e fugës
(R) Rrezja këndore e kanatit të mobilies

Trashësia e ballinës F [mm]	Rrezja këndore e kanatit të mobilies R [mm]	Gjerësia minimale e fugës X (vertikalisht) [mm]
16 deri në 20	0 deri në 3	3
22	0	4
	1	4
	2	3
	3	3
24	0	8
	1	7
	2	6
	3	6
26	Nuk rekomandohet.	

3.16.3 Gjerësia e fugës me derën e mobilies ngjitur




Fig. 96 Gjerësia e fugës me derën e mobilies ngjitur

(F) Trashësia e ballinës
(X) Gjerësia minimale e fugës
(R) Rrezja këndore e kanatit të mobilies

Trashësia e ballinës F [mm]	Rrezja këndore e kanatit të mobilies R [mm]	Gjerësia minimale e fugës X (vertikalisht) [mm]
16 deri në 20	0 deri në 3	2
22	0	4
	1	3
	2	3
	3	2
24	0	6
	1	5
	2	5
	3	4
26	0	8
	1	7
	2	7
	3	6

3.17 Lidhja e pajisjes në furnizimin me energji

PARALAJMËRIM
Rrezik i goditjes elektrike dhe rrezik lëndimi nga pajisja e dëmtuar ose kordoni i dëmtuar i lidhjes elektrike!
Rrezik për jetën dhe lëndime me prerje. Nëse pajisja ose kordoni i lidhjes elektrike dëmtohen gjatë transportit, atëherë mund të ekspozoheni ndaj një goditjeje elektrike fatale. Gjithashtu, ekziston rreziku që të priteni në pjesët e dëmtuara të trupit të pajisjes.
▶ Pas transportimit, kontrolloni pajisjen dhe kordonin e lidhjes elektrike për dëmtime.
▶ Në asnjë mënyrë mos e vendoni pajisjen në punë, nëse pajisja apo kordoni i lidhjes elektrike është i dëmtuar.
▶ Kontakti me shërbimin për klientin.


Ju e lidhni pajisjen në rrjetin elektrik me ndihmën e kordonit të lidhjes elektrike të dërguar më vete. Kordoni i lidhjes elektrike ka në njërin skaj një fishë për pajisjen ftohëse dhe në skajin tjetër ka një spinë elektrike.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Pajisja dhe kordoni i lidhjes elektrike nuk janë dëmtuar.
- Pajisja është montuar në përputhje me rregullat. (shihni 3.15 Montimi në dollap)
- Kërkesat për lidhjen elektrike janë respektuar.
- Dimensionet për lidhjen në përputhje me rregullat njihen dhe janë respektuar.
- Tensioni dhe frekuenca e rrjetit elektrik përputhen me specifikimet në etiketën e parametrave.
- Priza elektrike është e tokëzuar dhe e siguruar nga ana elektrike në përputhje me rregullat.
- Rryma e veprimit e siguresës është midis 10 A dhe 16 A.
- Priza elektrike është lehtësisht e arritshme dhe nuk ndodhet prapa pajisjes. (shihni 3.3 Dimensionet e dollapit)

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga përdorimi i papërshtatshëm!
Dëmtim i pjesëve elektrike të pajisjes.
▶ Përdorni vetëm kordonin e lidhjes elektrike të ofruar me pajisjen.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga lidhja e pasaktë!
Djegie.
Dëmtime në pajisje.
▶ Mos përdorni kabllo zgjatuese.
▶ Mos përdorni bashkues me shumë priza.



KUJDES
Rrezik dëmtimi nga lidhja e pasaktë!
Dëmtime në pajisje.
▶ Mos e lidhni pajisjen në inverter të pavarur nga rrjeti, si për shembull në impiantet me energji diellore dhe gjeneratorët me benzinë.

▶ Lidhni spinën e kordonit të lidhjes elektrike në linjën e furnizimit me energji elektrike. Sigurohuni që spina të futet mirë në prizë.




▷ Në ekran shfaqet logoja Liebherr.
▷ Ekrani kalon në simbolin Standby.
▷ Kur brenda 60 sekondave nuk kryhet asnjë veprim: Simboli Standby zbehet ose zhduket.
▷ Pajisja është e lidhur. Për vënien në punë herën e parë shihni kapitullin në vijim ose manualin e përdorimit.

4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe

Ju e përdorni pajisjen me anë të ekranit Touch & Swipe. Me ekranin Touch & Swipe (në vijim referuar si ekrani) ju zgjidhni funksionet e pajisjes duke prekur mbi ekran ose duke rrëshqitur me gisht në ekran. Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menyja e një niveli më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.

4.1 Navigimi dhe shpjegimi i simboleve


Në figura përdoren simbole të ndryshme për navigimin në ekran. Këto simbole përshkruhen në tabelën në vijim.

Simboli	Përshkrimi
	**Prekja e shkurtër e ekranit:** Aktivizoni/çaktivizoni funksionin. Konfirmoni përzgjedhjen. Hapni nënmenynë.
	**Prekja e gjatë e ekranit me kohën e specifikuar (p.sh. 3 sekonda):** Aktivizoni/çaktivizoni funksionin ose vlerën.
	**Rrëshqitja e gishtit djathtas ose majtas:** Navigoni nëpër meny.
	**Prekja shkurt e simbolit të kthimit prapa:** Ktheheni pas me një nivel të menysë.
	**Mbajtja prekur e simbolit të kthimit prapa për 3 sekonda:** Ktheheni pas tek treguesi i statusit.
	**Shigjeta me orën:** Nevojiten më shumë se 10 sekonda derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	**Shigjeta me specifikimin e kohës:** Do të kalojë koha e treguar derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	**Hapja e simbolit "Menyja Cilësimet":** Navigoni për në menynë e cilësimeve dhe hapni menynë e cilësimeve. Nëse nevojitet: Në menynë e cilësimeve navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 4.2.1 Hapja e menysë Cilësimet)
	**Hapja e simbolit "Menyja e zgjeruar":** Navigoni për në menynë e zgjeruar dhe hapni menynë e zgjeruar. Nëse nevojitet: Në menynë e zgjeruar navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 4.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar)
Asnjë veprim brenda 10 sekondave	Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menyja e një niveli më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.
Mbyllni dhe hapni derën sërish.	Nëse e mbyllni derën dhe e hapni përsëri menjëherë, treguesi kthehet direkt tek treguesi i statusit.

Shënim: Figurat e ekranit paraqiten me termat në gjuhën angleze.

4.2 Menytë

Funksionet e pajisjes janë të ndara në meny të ndryshme:

Menyja	Përshkrimi
Menyja kryesore	Kur ndizni pajisjen, atëherë ndodheni automatikisht në menynë kryesore. Nga këtu, ju navigoni për në funksionet më të rëndësishme të pajisjes, në menynë e cilësimeve dhe në menynë e zgjeruar.
 Menyja Cilësimet	Menyja Cilësimet përmban funksione të tjera të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj.
Menyja e zgjeruar	Menyja e zgjeruar përmban funksionet e veçanta të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj. Hyrja në menynë e zgjeruar është e mbrojtur përmes kodit me numra **1 5 1**.

4.2.1 Hapja e menysë Cilësimet




Fig. 97 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Hapet menyja Cilësimet.
▶ Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

4.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar



Fig. 98




*Fig. 99 Shembull ilustrues, hyrja me kodin me numra **151***

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Hapet menyja e zgjeruar.
▶ Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

4.3 Modaliteti i qetësisë

Nëse nuk e prekni ekranin për 1 minutë, atëherë ekrani kalon në modalitetin e qetësisë. Në modalitetin e qetësisë, niveli i dritës së treguesit është i errësuar.

4.3.1 Përfundimi i modalitetit të qetësisë

▶ Prekni shkurt ekranin me gisht.
▷ Modaliteti i qetësisë përfundon.

5 Vënia në punë

5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pajisja është montuar dhe lidhur në përputhje me instruksionet e montimit.
❑ Të gjithë shiritat ngjitës, fletët ngjitëse dhe mbrojtëse, si dhe sigurueset e transportit brenda dhe jashtë pajisjes janë hequr.
❑ Të gjitha fletëpalosjet e reklamave janë hequr nga sirtarët.
❑ Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe është e njohur. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Ndezja e pajisjes përmes ekranit Touch & Swipe:

▶ Kur ekrani është në modalitetin e qetësisë: Prekni shkurt ekranin.
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 100 Shembull ilustrues

▷ Shfaqet treguesi i statusit.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur nga fabrika.
▷ Pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ (treguesi i statusit shfaqet me DEMO): Nëse pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ, atëherë ju mund ta çaktivizoni modalitetin demonstrativ brenda 5 minutave. (shihni Modaliteti i demonstrimit)

Informacione të tjera:

- Vini në funksionim InfinitySpring. (shihni 5.2 Vënia në funksionim e InfinitySpring*) *
- Vini në funksionim HydroBreeze. (shihni 5.3 Vënia në funksionim e HydroBreeze)
- Vini në funksionim SmartDevice. (shihni 2.3 SmartDevice) dhe (shihni WLAN)

Shënim
Prodhuesi këshillon:

▶ Futja e ushqimeve: Pritni rreth 6 orë derisa të arrihet temperatura e vendosur.
▶ Futni **ushqimet për ngrirje** në -18 °C ose më shumë.*
▶ Ndiqni udhëzimet për ruajtjen. (shihni 6.1 Udhëzime për ruajtjen)

Shënim
Sie erhalten Zubehör im Liebherr-Hausgeräte-Shop unter go.liebherr.com/47wtc4.

5.2 Vënia në funksionim e InfinitySpring*

Nëse pajisja juaj është e pajisur me InfinitySpring, duhet që **përpara përdorimit të parë** të nxirrni ajrin nga sistemi i ujit për InfinitySpring dhe ta pastroni InfinitySpring.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Lidhja e sistemit të furnizimit me ujë është realizuar. Shihni Installation Guide ose manualin e montimit.
❑ Depozita e ujit është vendosur. Shihni Installation Guide ose manualin e montimit.
❑ Filtri i ujit është vendosur. Shihni Installation Guide ose manualin e montimit.*
❑ Pajisja është montuar plotësisht brenda dhe është lidhur plotësisht.

5.2.1 Nxjerrja e ajrit nga sistemi i furnizimit me ujë

▶ Hapni derën e pajisjes.
▶ Ngjishni gotën e ujit në pjesën e poshtme të dispenserit të InfinitySpring.
▷ Pjesa e sipërme zgjatet jashtë dhe ajri del jashtë ose uji rrjedh brenda në gotë.

▶ Vazhdoni me procesin derisa uji të rrjedhë njëtrajtësisht në gotë.
▷ Ajri është nxjerrë jashtë sistemit të ujit.

5.2.2 Pastrimi i InfinitySpring

(shihni 10.11.4 Pastrimi i InfinitySpring *)

5.3 Vënia në funksionim e HydroBreeze

Nëse pajisja juaj është e pajisur me sHydroBreeze, duhet që **përpara përdorimit të parë** ta pastroni HydroBreeze.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pajisja është montuar plotësisht brenda dhe është lidhur plotësisht.

▶ Pastroni HydroBreeze. (shihni 10.11.5 Pastrimi i HydroBreeze)
▶ Mbushni depozitën e ujit. (shihni 9.10.1 Mbushja e depozitës së ujit)
▶ Aktivizoni HydroBreeze. (shihni HydroBreeze)

6 Ruajtja

6.1 Udhëzime për ruajtjen

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike!
Përdorimi i pajisjeve elektrike në zonën e ushqimeve mund të shkaktojë rënie zjarri.
▶ Mos përdorni pajisje elektrike në zonën e ushqimeve të pajisjes, nëse kjo nuk rekomandohet nga prodhuesi.

Shënim
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit.

Ndiqni specifikimet e mëposhtme për ruajtjen:

- Mbani të lira kanalet e ajrit në ventilator.
- Në ndarjen e ngrirjes: Paketoni mirë ushqimet.*
- Paketoni në enë/kuti të mbyllura ose mbuloni ushqimet që marrin ose lëshojnë lehtë aromat ose shijet.
- Ruani lëngjet në enë të mbyllura.
- Vendosni ushqimet me distancë nga njëra-tjetra, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.
- Vendosni ushqimet në ruajtje në përputhje me specifikimet në paketim.
- Mbani gjithmonë parasysh datën e dhënë për afatin e përdorimit, e cila ndodhet në paketim.

Shënim
Mosndjekja e këtyre këshillave mund të rezultojë në prishjen e ushqimeve.

6.2 Pjesa e ftohjes

Nëpërmjet qarkullimit të ajrit në pajisje krijohen zona me temperatura të ndryshme. Zonat me temperatura të ndryshme i shihni te pasqyra e pajisjes dhe pjesëve. (shihni 2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve)

6.2.1 Sistemimi i ushqimeve

VINI RE
Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga vendosja e gabuar e ushqimeve ose objekteve!
Kur vendosni ushqime ose objekte qelqi mbi pllakën më të poshtme prej xhami, dera mund të mos mbyllet mirë. Si pasojë, rafti i derës mund të thyhet, ushqimet ose objektet mund të bien dhe mund të shkaktojnë lëndime.
▶ Mbajeni të lirë pjesën e përparme të pllakës më të poshtme prej xhami.




Fig. 101 Shembull ilustrues
(1) Zona e përparme

▶ Pjesa e sipërme dhe te dera: Vendosni në ruajtje gjalpin, djathin, konservat dhe tubetat.
▶ Zona me temperaturën më të ftohtë: Vendosni në ruajtje ushqimet që prishen lehtë, si ushqimet e gatshme.

6.3 BioFresh

BioFresh zgjat kohën e ruajtjes për disa ushqime të freskëta, në krahasim me ftohjen e zakonshme.

Shënim
Nëse temperaturat ulen nën 0 °C, ushqimet mund të ngrijnë.
▶ Perimet e ndjeshme ndaj të ftohtit, si trangujt, patëllxhanët, kunguj dhe frutat tropikale të ndjeshme ndaj të ftohtit vendosini në ruajtje në pjesën e ftohjes.

6.3.1 Fruit & Vegetable-Safe

Këtu krijohet një klimë ruajtjeje afër 0 °C. Kapaku i ndarjes kujdeset për lagështinë e vazhdueshme të pranishme të ajrit. Kjo klimë ruajtjeje është e përshtatshme për ruajtjen e ushqimeve jo të paketuara dhe që kanë vetë lagështi të lartë (p.sh. sallatë, perime, fruta).

Lagështia e ajrit në ndarje varet nga përmbajtja e lagështisë së produktit që vendoset në ftohje dhe nga shpeshtësia e hapjes. Ju mund ta rregulloni lagështinë e ajrit.

Sistemimi i ushqimeve

▶ Vendosni në ruajtje frutat dhe perimet jo të paketuara. Nëse lagështia e ajrit është tepër e lartë:
▶ Rregulloni lagështinë e ajrit.

6.3.2 Meat & Dairy-Safe

Këtu krijohet një klimë ruajtjeje afër 0 °C. Kjo klimë ruajtjeje është e përshtatshme për ushqime delikate (p.sh. produkte bulmeti, mish, peshk, sallam).

Sistemimi i ushqimeve

▶ Vendosni në ruajtje ushqimet e thata ose të paketuara.

6.4 Ndarja e ngrirjes me 4 yje*

Në -18 °C këtu krijohet një klimë ruajtjeje e akullt e thatë. Klima e akullt e ruajtjes është e përshtatshme për ruajtjen për disa muaj të ushqimeve të ngrira dhe të artikujve në ngrirje, për prodhimin e kubave të akullit ose për ngrirjen e ushqimeve të freskëta.

Temperatura e ajrit në ndarjen e ngrirjes, e matur me termometër ose me aparatura matëse të tjera mund të luhatet. Luhatjet e temperaturës janë më të mëdha kur ndarja e ngrirjes është gjysmë plot ose bosh dhe është e mundur që të arrihen temperatura më të ngrohta se -18 °C.

6.4.1 Ngrirja e ushqimeve

Ju mund të ngrini maksimumi aq ushqime të freskëta brenda 24 orëve sa tregohet në etiketën e parametrave (shihni 11.5 Etiketa e parametrave) në pjesën "Kapaciteti i ngrirjes ... kg/24h".

Me qëllim që ushqimi të ftohet shpejt deri në brendësi, respektoni sasitë e mëposhtme për çdo paketim:

- Fruta dhe perime deri në 1 kg
- Mish deri në 2,5 kg

Sistemimi i ushqimeve

VINI RE
Rrezik lëndimi nga thyerja e qelqit!
Shishet dhe kanaçet me pije mund të plasin nga ngrirja. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për pijet që përmbajnë gaz karbonik.
▶ Mos i ngrini shishet dhe kanaçet me pije!

▶ Për performancë maksimale në ngrirje: Hiqni pllakën e xhamit përpara vendosjes në ngrirje.*
▶ Vendosni ushqimet e paketuara në ndarjen e ngrirjes.

Shkrirja e ushqimeve

PARALAJMËRIM
Rrezik i helmimit nga ushqimi!
▶ Mos i ngrini më përsëri ushqimet e shkrira.
▶ Gatuani ushqimet e shkrira sa më shpejt të jetë e mundur.

Ju mund t'i shkrini ushqimet në mënyra të ndryshme:

- në pjesën e ftohjes
- në mikrovalë
- në furrë/sobë me ajër të nxehtë
- në temperaturë ambienti

▶ Nxirrni nga frigoriferi vetëm aq ushqim sa ju nevojitet.

6.5 Kohët e ruajtjes

Kohët e treguara të ruajtjes janë vlera orientuese.

Për ushqimet me specifikim të afatit të përdorimit vlen gjithmonë data e përcaktuar në paketim.

6.5.1 Ndarja e ftohjes

Vlen data e dhënë mbi paketim për afatin e përdorimit.

6.5.2 BioFresh

Vlerat orientuese për kohën e ruajtjes te Meat & Dairy-Safe		
Gjalpë	në 1 °C	deri në 90 ditë
Djathë i fortë	në 1 °C	deri në 110 ditë
Qumësht	në 1 °C	deri në 12 ditë
Sallame, të prerë në feta	në 1 °C	deri në 8 ditë
Shpendë	në 1 °C	deri në 6 ditë
Mish derri	në 1 °C	deri në 6 ditë
Mish gjedhi	në 1 °C	deri në 6 ditë
Mish i egër gjahu	në 1 °C	deri në 6 ditë

Shënim
▶ Mbani parasysh se ushqimet e pasura me proteina prishen më shpejt. D.m.th. që molusqet dhe krustacet prishen më shpejt sesa peshku, dhe peshku prishet më shpejt sesa mishi.

Vlerat orientuese për kohën e ruajtjes te Fruit & Vegetable-Safe		
Perime, sallata		
Karçof	në 1 °C	deri në 14 ditë
Selino	në 1 °C	deri në 28 ditë
Lulelakër	në 1 °C	deri në 21 ditë
Brokoli	në 1 °C	deri në 13 ditë
Çikore	në 1 °C	deri në 27 ditë
Marule	në 1 °C	deri në 19 ditë
Bizele	në 1 °C	deri në 14 ditë
Kale jeshile	në 1 °C	deri në 14 ditë
Karota	në 1 °C	deri në 80 ditë
Hudhër	në 1 °C	deri në 160 ditë
Lakër rrepë	në 1 °C	deri në 14 ditë
Sallatë e rrumbullt	në 1 °C	deri në 13 ditë
Lakra	në 1 °C	deri në 13 ditë
Presh	në 1 °C	deri në 29 ditë
Kërpudha	në 1 °C	deri në 7 ditë
Rrepa	në 1 °C	deri në 10 ditë
Lakër Brukseli	në 1 °C	deri në 20 ditë
Shpargull	në 1 °C	deri në 18 ditë
Spinaq	në 1 °C	deri në 13 ditë
Lakër kaçurrele	në 1 °C	deri në 20 ditë
Fruta		
Kajsi	në 1 °C	deri në 13 ditë
Mollë	në 1 °C	deri në 80 ditë
Dardha	në 1 °C	deri në 55 ditë
Boronica	në 1 °C	deri në 3 ditë
Hurma arabie	në 1 °C	deri në 180 ditë
Luleshtrydhe	në 1 °C	deri në 7 ditë
Fiq	në 1 °C	deri në 7 ditë
Kulumbri	në 1 °C	deri në 9 ditë
Mjedra	në 1 °C	deri në 3 ditë

Vlerat orientuese për kohën e ruajtjes te Fruit & Vegetable-Safe		
Rrush serezi	në 1 °C	deri në 7 ditë
Qershi, të ëmbla	në 1 °C	deri në 14 ditë
Kivi	në 1 °C	deri në 80 ditë
Pjeshkë	në 1 °C	deri në 13 ditë
Kumbulla	në 1 °C	deri në 20 ditë
Boronicë e kuqe	në 1 °C	deri në 60 ditë
Rubarbe	në 1 °C	deri në 13 ditë
Rrush frëngu	në 1 °C	deri në 13 ditë
Rrush	në 1 °C	deri në 29 ditë

6.5.3 Ndarja e ngrirjes*

Vlerat orientuese për ruajtjen e ushqimeve të ndryshme		
Akullore	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Sallame, proshuta	në -18 °C	2 deri në 3 muaj
Bukë, produkte brumi për pjekje	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Mish i egër, mish derri	në -18 °C	6 deri në 9 muaj
Peshk, me yndyrë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Peshk, pa yndyrë	në -18 °C	6 deri në 8 muaj
Djathë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Shpendë, mish gjedhi	në -18 °C	6 deri në 12 muaj
Perime, fruta	në -18 °C	6 deri në 12 muaj

7 Kursimi i energjisë

- Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin. Mos i mbuloni vrimat ose grilat e ajrimit.
- Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.
- Mos e montoni pajisjen as në një vend në rrezet direkte të diellit, as pranë sistemit të ngrohjes apo të ngjashme.
- Kur e montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë, konsumi i energjisë mund të rritet paksa. Kjo varet nga kohëzgjatja e përdorimit dhe nga intensiteti i përdorimit të furrës.
- Konsumi i energjisë varet nga kushtet e instalimit, për shembull nga temperatura e ambientit . Kur temperatura e ambientit është më e ngrohtë, atëherë konsumi i energjisë mund të rritet.
- Hapeni pajisjen mundësisht sa më pak kohë.
- Sa më e ulët të vendoset temperatura, aq më i lartë do të jetë konsumi i energjisë.
- Sistemimi i ushqimeve të ndara: home.liebherr.com/food.
- Të gjitha ushqimet vendosini në ruajtje të paketuara mirë dhe të mbuluara. Kështu shmanget formimi akullit/borës.
- Nxirrini ushqimet nga frigoriferi në kohën e nevojshme, në mënyrë që ato të mos ngrohen shumë.
- Futja e ushqimeve të ngrohta: në fillim lërini të ftohen në temperaturën e dhomës.
- Shkrini produktet e ngrira në ndarjen e ftohjes.*
- Kur në pajisje ka një shtresë të trashë akulli: Shkrini pajisjen.*
- Në rastin e pushimeve të gjata, përdorni HolidayMode (shihni HolidayMode) .

8 Përdorimi

8.1 Elementët e komandimit dhe tregues

8.1.1 Treguesi i statusit



Fig. 102 Treguesi i statusit tregon temperaturën aktuale.

(1) Treguesi i temperaturës ndarja e ftohjes

(2) Treguesi i temperaturës BioFresh

Treguesi i statusit tregon temperaturën aktuale dhe është treguesi fillestar i rregullimeve. Që aty vijohet me navigimin në funksionet dhe cilësimet e tjera të pajisjes.

8.1.2 Simbolet treguese

Simbolet treguese janë informacion rreth gjendjes aktuale të pajisjes.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	Standby Pajisja ose zona e temperaturës është e fikur.
 	**Numër që pulson** Pajisja është duke punuar. Temperatura pulson derisa të arrihet vlera e vendosur.
 	**Simbol që pulson** Pajisja është duke punuar. Rregullimi po pranohet.

8.2 Funksionet e pajisjes

8.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes

Funksionet e pajisjes janë konfiguruar në mënyrë të tillë nga fabrika që pajisja juaj të jetë plotësisht funksionale.

Përpara se të ndryshoni, të aktivizoni ose të çaktivizoni funksionet e pajisjes, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Ju keni lexuar dhe keni kuptuar përshkrimet për mënyrën e funksionimit të ekranit. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)
- ❑ Ju jeni familjarizuar me elementët e komandimit dhe elementët tregues të pajisjes suaj.

Fikja dhe ndezja e pajisjes

Me këtë funksion ju fikni dhe ndizni të gjithë pajisjen.

Fikja e pajisjes

Kur fikni pajisjen, atëherë të gjitha rregullimet e kryera më parë do të ruhen.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Janë ndjekur të gjitha udhëzimet e veprimeve (shihni 12 Nxjerrja jashtë pune) .



Fig. 103




Fig. 104

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Pajisja fiket.
▷ Në ekran shfaqet simboli Standby.
▷ Ekrani bëhet i zi.

Ndezja e pajisjes

Kur ekrani ndodhet në modalitetin e qetësisë:

▶ Prekni shkurt ekranin.




Fig. 105 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
Kur pajisja ndizet në modalitetin e demonstrimit:
▶ Çaktivizoni modalitetin e demonstrimit. (shihni Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit)
▷ Pajisja do të ndizet.
▷ Rregullimet e kryera më parë do të rivendosen.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur.

5 °C Temperatura

Me këtë funksion ju vendosni temperaturën.

Temperatura varet nga faktorët e mëposhtëm:

- shpeshtësia e hapjes së derës
- kohëzgjatja e hapjes së derës
- temperatura e dhomës në vendin e instalimit
- lloji, temperatura dhe sasia e ushqimit

Zona e temperaturës	Temperatura e vendosur nga fabrika	Cilësimi i rekomanduar
5 °C Pjesa e ftohjes	5 °C	4 °C
0 °C BioFresh	0 °C	B-Value (shihni BioFresh B-Value)

Vendosja e temperaturës në pjesën e ftohjes




Fig. 106 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Temperatura vendoset.

Vendosja e temperaturës në BioFresh

Temperaturën mund ta vendosni me anë të **BioFresh B-Value**. (shihni BioFresh B-Value)

B5 BioFresh B-Value

Me këtë funksion ju vendosni BioFresh B-Value. Me BioFresh B-Value ju mund ta vendosni BioFresh në një nivel paksa më të ngrohtë ose më të freskët, kur kjo nevojitet për shkak të temperaturës më të lartë ose më të ulët të ambientit. Në momentin e dërgimit nga fabrika, BioFresh B-Value është e caktuar në vlerën B5. Nëse e ndryshoni B-Value, atëherë mbani parasysh tabelën e mëposhtme:

Vlera	Përshkrimi
B1	Temperatura më e ulët
B1-B4	Temperatura mund të bjerë nën 0 °C, kështu që ushqimet mund të ngrijnë paksa.*
B5	Temperatura e paracaktuar
B9	Temperatura më e lartë

Vendosja e BioFresh B-Value



Fig. 107




Fig. 109 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga B5 në B6.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ BioFresh B-Value do të vendoset.
▷ Treguesi i statusit tregon temperaturën e synuar.

C5 C-Value*

Me këtë funksion ju vendosni C-Value. Me anë të C-Value, temperatura në ndarjen e ngrirjes me katër yje **** mund të vendoset paksa më e ngrohtë ose më e freskët. Në momentin e dërgimit nga fabrika, C-Value është e caktuar në vlerën C5.

Vlera	Përshkrimi
C1 deri në C4	Ndarja e ngrirjes me katër yje **** do të jetë më e ftohtë.
C5	Vlera e paracaktuar
C6 deri në C9	Ndarja e ngrirjes me katër yje **** do të jetë më e ngrohtë.

Vendosja e C-Value



Fig. 110




Fig. 112 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga C5 në C6.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ C-Value do të vendoset.

D1 D-Value

D-Value për pajisjen tuaj është caktuar nga fabrika dhe nuk lejohet të ndryshohet.

SuperCool

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SuperCool. Kur aktivizoni funksionin SuperCool, atëherë pajisja e përforcon kapacitetin e ftohjes. Si rezultat arrini temperatura freskimi më të ulëta. Ju mund ta aktivizoni funksionin SuperCool kur dëshironi të ftohni shpejt sasi të mëdha ushqimi.

Kur aktivizoni funksionin SuperCool, atëherë në ndarjen e ngrirjes me katër yje **** arrini gjithashtu temperatura më të thella. Ju mund ta aktivizoni funksionin SuperCool kur dëshironi të ngrini ushqime në ndarjen e ngrirjes me katër yje *****.

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Aktivizimi i SuperCool

Momenti për aktivizimin e funksionit:

- Kur dëshironi të ruani ushqime të freskëta në pjesën e ftohjes: Aktivizoni funksionin kur futni ushqimet.
- Kur dëshironi të ruani ushqime të freskëta në ndarjen e ngrirjes me katër yje ****: Aktivizoni funksionin 3 orë përpara se të futni ushqimet.*



Fig. 113




Fig. 114

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
-ose-
▶ Aktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ SuperCool aktivizohet.
▷ Treguesi i temperaturës bëhet blu.

Çaktivizimi i SuperCool

SuperCool çaktivizohet automatikisht pas 18 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni funksionin SuperCool edhe manualisht në çdo kohë:



Fig. 115




Fig. 116

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
-ose-
▶ Çaktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ SuperCool do të çaktivizohet.
▷ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë.

PartyMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni PartyMode. PartyMode aktivizon funksione të ndryshme që janë të nevojshme për një festë.

*** Në varësi nga modeli dhe pajisja**

PartyMode aktivizon funksionet e mëposhtme:

- SuperCool (shihni SuperCool)

Të gjitha funksionet e renditura ju mund t'i rregulloni gjithashtu në mënyrë individuale dhe të pavarur. Nëse e aktivizoni modalitetin PartyMode, atëherë të gjitha ndryshimet do të anulohen.

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Aktivizimi i PartyMode



Fig. 117




Fig. 118

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ PartyMode funksionet përkatëse janë aktivizuar.
▷ Treguesi i temperaturës bëhet blu.
▷ Temperatura aktuale pulson derisa të arrihet temperatura e synuar.

Çaktivizimi i PartyMode

Modaliteti PartyMode çaktivizohet automatikisht pas 24 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin PartyMode edhe manualisht në çdo kohë:



Fig. 119




Fig. 120

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ PartyMode është çaktivizuar.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë: Temperatura aktuale pulson derisa të arrihet temperatura e synuar.

HolidayMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni HolidayMode. Kur aktivizoni funksionin HolidayMode, atëherë pjesa e ftohjes vendoset në temperaturën 15 °C. Në këtë mënyrë ju kurseni energji në rast të një mungese të gjatë dhe shmangni krijimin e erërave të këqija dhe formimin e mykut.

Gjendja e pajisjes me HolidayMode aktiv
Pjesa e ftohjes ftohet në 15 °C.
BioFresh ftoh në 15 °C.
Në ndarjen e ngrirjes me katër yje **** ruhet temperatura e vendosur.*
PartyMode çaktivizohet.
SuperCool çaktivizohet.

Aktivizimi i HolidayMode

▶ Zbrazni plotësisht pjesën e ftohjes.
▶ Zbrazni plotësisht BioFresh.




Fig. 121




Fig. 122

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ HolidayMode është aktivizuar.
▷ Treguesi i temperaturës bëhet blu dhe tregon simbolin HolidayMode.

Çaktivizimi i HolidayMode



Fig. 123




Fig. 124

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ HolidayMode çaktivizohet.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë.

SabbathMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SabbathMode. Kur e aktivizoni këtë funksion, disa funksione elektronike do të çaktivizohen. Në këtë mënyrë, pajisja juaj përmbush kërkesat fetare për festat hebraike, si për shembull në Shabat dhe plotëson certifikimin STAR-K Kosher.

Gjendja e pajisjes me SabbathMode aktiv
Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.
Të gjitha funksionet në ekran përveç **funksionit Çaktivizimi i SabbathMode** janë të bllokuara.
Të gjitha funksionet mbeten aktive.
Ekrani qëndron i ndriçuar kur mbyllni derën.
Ndriçimi i brendshëm është i çaktivizuar.

Gjendja e pajisjes me SabbathMode aktiv
Kujtesat nuk ekzekutohen. Intervali kohor i vendosur ndalohet.
Kujtesat dhe paralajmërimet nuk shfaqen.
Nuk ka asnjë alarm të derës.
Nuk ka asnjë alarm të temperaturës.
InfinitySpring është jashtë funksioni.*
Cikli i shkrirjes punon vetëm sipas kohës së paracaktuar, pa marrë parasysh përdorimin e pajisjes.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike, pajisja rikthehet në SabbathMode.

Gjendja e pajisjes

Shënim
Kjo pajisje mban certifikimin e institutit "Institute for Science and Halacha". (www.machonhalacha.co.il)

Një listë të pajisjeve të certifikuara nga STAR-K e gjeni në www.star-k.org/appliances.

Aktivizimi i SabbathMode

PARALAJMËRIM
Rrezik helmimi nga ushqimi i prishur!
Nëse keni aktivizuar SabbathMode dhe ndodh një ndërprerje e energjisë elektrike, në treguesin e statusit nuk shfaqet asnjë mesazh për ndërprerjen e energjisë elektrike. Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja vazhdon sërish punën në SabbathMode. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike ushqimet mund të prishen dhe konsumimi i tyre mund të shkaktojë helmim nga ushqimi.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike:
▶ Mos konsumi ushqimet që kanë qenë të ngrira dhe janë shkrirë.



Fig. 125




Fig. 126
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ SabbathMode është aktivizuar.
▷ Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.

Çaktivizimi i SabbathMode

Modaliteti SabbathMode çaktivizohet automatikisht pas 80 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin SabbathMode edhe manualisht në çdo kohë:




Fig. 127
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ SabbathMode është çaktivizuar.

EnergySaver

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë. Kur aktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë, konsumi i energjisë ulet dhe temperatura në pajisje rritet. Ushqimet qëndrojnë të freskëta, por kohëzgjatja e ruajtjes së tyre shkurtohet.

Zona e temperaturës	Cilësimi i rekomanduar (shihni Vendosja e temperaturës në pjesën e ftohjes)	Temperatura me EnergySaver aktiv
5 °C Pjesa e ftohjes	4 °C	7 °C

Temperaturat

Aktivizimi i EnergySaver



Fig. 128




Fig. 129
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë aktivizohet.

Çaktivizimi i EnergySaver



Fig. 130




Fig. 131
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë çaktivizohet.

HydroBreeze

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni HydroBreeze. Nëse e aktivizoni funksionin, atëherë HydroBreeze krijon në BioFresh-Safe një mjegull të imët të freskët. Si rezultat, zgjatet afati i ruajtjes së sallatës, të perimeve dhe të frutave të papaketuara, që kanë lagështi të vetën të lartë.

Nëse e aktivizoni funksionin, atëherë HydroBreeze aktivizohet për 4 sekonda në çdo 90 minuta kur dera është e mbyllur. Kur hapni derën, atëherë HydroBreeze aktivizohet në varësi të rregullimit:

Vlera	Përshkrimi
1	HydroBreeze është aktiv për 4 sekonda me derën e hapur.
2	HydroBreeze është aktiv për 6 sekonda me derën e hapur.
3	HydroBreeze është aktiv për 8 sekonda me derën e hapur.
Çaktivizuar (cilësimi i paracaktuar)	HydroBreeze është çaktivizuar.

Kohëzgjatja e HydroBreeze me derën e hapur

Aktivizimi i HydroBreeze

Shënim
Nëse e aktivizoni HydroBreeze por nuk vendosni asnjë ushqim për ruajtje në sirtar, në fundin e sirtarit krijohet ujë i kondensuar.
▶ Aktivizoni HydroBreeze vetëm kur vendosni në sirtar ushqime për ruajtje.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ HydroBreeze është pastruar. (shihni 10.11.5 Pastrimi i HydroBreeze)
❑ Depozita e ujit është e mbushur. (shihni 9.10.1 Mbushja e depozitës së ujit)

Ju aktivizoni HydroBreeze, duke zgjedhur një vlerë për kohëzgjatjen e HydroBreeze:




Fig. 132




Fig. 133 Shembull ilustrues: Aktivizimi i HydroBreeze me vlerën 3.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ HydroBreeze është aktivizuar.

Çaktivizimi i HydroBreeze



Fig. 134




Fig. 135

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ HydroBreeze është çaktivizuar.

CleaningMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni CleaningMode. Modaliteti CleaningMode mundëson pastrimin komod të pajisjes.

Ky cilësim lidhet me pjesën e ftohjes.

Përdorimi:
- Pastroni pjesën e ftohjes. (shihni 10.11 Pastrimi i pajisjes)
- Pastroni InfinitySpring. (shihni 10.11.4 Pastrimi i InfinitySpring *) *

Gjendja e pajisjes me CleaningMode aktiv
Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje CleaningMode.
Pjesa e ftohjes është e çaktivizuar.
Ndriçimi i brendshëm është i aktivizuar.
Kujtesat dhe paralajmërimet nuk shfaqen. Nuk tingëllon asnjë sinjal akustik.
InfinitySpring është jashtë funksioni.*

Gjendja e pajisjes

Aktivizimi i CleaningMode



Fig. 136




Fig. 137

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ CleaningMode është aktivizuar.
▷ Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje CleaningMode.

Çaktivizimi i CleaningMode

Modaliteti CleaningMode çaktivizohet automatikisht pas 60 minutash. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin CleaningMode edhe manualisht në çdo kohë:




Fig. 138

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

▷ CleaningMode është çaktivizuar.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë.

Bllokimi i panelit

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni bllokimin e panelit. Bllokimi i panelit parandalon përdorimin pa dashje të pajisjes, p.sh. nga fëmijët.

Përdorimi:

- Shmangni ndryshimin pa qëllim të funksioneve.
- Shmangni fikjen pa qëllim të pajisjes.
- Shmangni rregullimin pa qëllim të temperaturës.

Aktivizimi i bllokimit të panelit

Nëse aktivizoni bllokimin e panelit, atëherë ju mund të navigoni më tutje nëpër meny, por nuk mund të zgjidhni apo të ndryshoni funksionet e tjera.



Fig. 139




Fig. 140

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Bllokimi i panelit do të aktivizohet.

Çaktivizimi i bllokimit të panelit



Fig. 141




Fig. 142

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Bllokimi i panelit do të çaktivizohet.

Kujtesa

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni kujtesat e ndryshme. Në gjendjen e dërgimit, ky funksion është i aktivizuar.

Kur funksioni është i aktivizuar, atëherë shfaqen kujtesat e mëposhtme:

- Zëvendësimi i filtrit të ujit (shihni Zëvendësimi i filtrit të ujit*) *
- Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir (shihni Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir)

Aktivizimi i kujtesës




Fig. 143




Fig. 144

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Kujtesa aktivizohet.

Çaktivizimi i kujtesës



Fig. 145




Fig. 146

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Kujtesa çaktivizohet.

Gjuha

Me këtë funksion ju vendosni gjuhën e afishimit.

Ju mund të vendosni gjuhët e mëposhtme:

- Gjermanisht
- Anglisht
- Frëngjisht
- Spanjisht
- Italisht
- Holandisht
- Çekisht
- Polonisht
- Portugalisht
- Bullgarisht
- Rusisht
- Kinezisht

Vendosja e gjuhës



Fig. 147




Fig. 148 Shembull ilustrues sipas gjuhës dhe temperaturës

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Gjuha do të vendoset.

▷ Ekrani kthehet pas tek treguesi i statusit.

Njësia e temperaturës

Me këtë funksion ju vendosni njësinë e temperaturës. Ju mund të vendosni gradë Celsius ose gradë Fahrenheit si njësi të temperaturës.

Vendosja e njësisë së temperaturës



Fig. 149




Fig. 151 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga gradë Celsius në gradë Fahrenheit.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Njësia e temperaturës do të vendoset.

Niveli i dritës së ekranit

Me këtë funksion ju rregulloni në mënyrë graduale nivelin e dritës së ekranit.

Ju mund të vendosni nivelet e mëposhtme të dritës:

- 40 %
- 60 %
- 80 %
- 100% (Cilësimi i paracaktuar)

Vendosja e nivelit të dritës



Fig. 152




Fig. 153 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga 80% në 60%.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Niveli i dritës do të vendoset.

WLAN

Me këtë funksion ju lidhni pajisjen tuaj me rrjetin WLAN. Atë mund ta komandoni më pas përmes aplikacionit SmartDevice nga një pajisje fundore celulare. Me këtë funksion ju mund të ndani përsëri ose të rivendosni lidhjen në rrjetin WLAN.

Informacione të tjera për SmartDevice:
(shihni 2.3 SmartDevice)

Shënim
Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Aplikacioni SmartDevice është instaluar (shihni apps.home.liebherr.com).
❑ Regjistrimi në aplikacionin SmartDevice ka përfunduar.



Fig. 154




Fig. 155

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Lidhja është vendosur.

Shkëputja e lidhjes me WLAN



Fig. 156




Fig. 157

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Lidhja është shkëputur.

Rivendosja e lidhjes me WLAN



Fig. 158




Fig. 159

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Lidhja me WLAN dhe rregullimet e tjera të WLAN rikthehen në cilësimet nga fabrika.

Shfaqja e informacioneve për lidhjen me WLAN



Fig. 160




Fig. 161

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

Informacioni i pajisjes

Me këtë funksion ju shikoni emrin e modelit, indeksin, numrin e serisë dhe numrin e shërbimit të pajisjes suaj. Informacionet e pajisjes ju nevojiten kur kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Me këtë funksion hapni gjithashtu menynë e zgjeruar. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Shikimi i informacioneve të pajisjes




Fig. 162




Fig. 163

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Ekrani tregon informacionet e pajisjes.

Software

Me këtë funksion ju shikoni versionin e softuerit të pajisjes suaj.

Shikimi i versionit të softuerit



Fig. 164




Fig. 165

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Ekrani tregon versionin e softuerit.

Alarmi i derës

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni alarmin e derës. Alarmi i derës bie kur dera mbahet hapur shumë gjatë. Në gjendjen e dërgimit, alarmi i derës është i aktivizuar. Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës.

Ju mund të vendosni vlerat e mëposhtme:

- 1 minutë
- 2 minuta
- 3 minuta
- Fikur

Vendosja e alarmit të derës



Fig. 166




Fig. 167 Shembull ilustrues: Ndërrimi i alarmit të derës nga 1 minutë në 3 minuta.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

▷ Alarmi i derës vendoset.

Çaktivizimi i alarmit të derës



Fig. 169




Fig. 170

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Alarmi i derës çaktivizohet.

Modaliteti i demonstrimit

Modaliteti i demonstrimit është një funksion i veçantë për shitësit, që të mund të prezantojnë funksionet e pajisjes. Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit, atëherë të gjitha funksionet teknike të ftohjes çaktivizohen.

Nëse kur ndizni pajisjen shfaqet një "Demo" tek treguesi i statusit, kjo tregon se modaliteti i demonstrimit është aktivizuar më parë.

Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit dhe pastaj e çaktivizoni përsëri, pajisja rikthehet në cilësimet e fabrikës. (shihni Rikthimi në cilësimet nga fabrika)

Aktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 171




Fig. 172

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i demonstrimit aktivizohet.
▷ Pajisja është fikur.
▶ Ndizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
▷ Tek treguesi i statusit shfaqet "DEMO".

Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 173




Fig. 174

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i demonstrimit çaktivizohet.
▷ Pajisja është fikur.
▶ Ndizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
▷ Pajisja rikthehet në cilësimet nga fabrika.

Rikthimi në cilësimet nga fabrika

Me këtë funksion ju i ktheni në cilësimet nga fabrika të gjitha rregullimet. Të gjitha rregullimet që keni kryer deri në atë moment, do të rikthehen në cilësimin e tyre fillestar.

Ekzekutimi i rikthimit në gjendjen fillestare



Fig. 175




Fig. 176

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Pajisja rikthehet në gjendjen fillestare.
▷ Pajisja fiket.
▶ Rindizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))


8.3 Mesazhet

Ka dy kategori të mesazheve:

Kategoria	Kuptimi
Paralajmërim	Paralajmërimet shfaqen në rastin e alarmit të derës ose në rast problemesh në funksionim. Paralajmërimet e thjeshta mund t'i mënjanoni edhe vetë. Për problemet e rënda në funksionim duhet të kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
Kujtesë	Kujtesat kujtojnë për proceset e përgjithshme. Ju mund t'i ekzekutoni këto procese dhe kështu të mënjanoni mesazhin.

8.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve

Sjellja e pajisjes në rastin e paralajmërimeve:
- Paralajmërimi shfaqet në ekran në ngjyrë të kuqe.
- Tingulli i alarmit bie me një volum në rritje.
- Në disa paralajmërime pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Mesazhi	Shkaku	Mënjanimi i mesazhit
 **Alarmi i derës**	Mesazhi shfaqet kur dera mbahet hapur shumë gjatë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Alarmi i derës)
 **Gabim**	Mesazhi shfaqet kur ndodh një gabim në pajisje. Një pjesë e pajisjes shfaq një defekt.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim)
 **Gabim i WLAN**	Mesazhi shfaqet kur pajisja nuk ka mundur të lidhet me rrjetin WLAN. (shihni Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë) Mesazhi shfaqet vetëm gjatë konfigurimit të parë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim i WLAN)

8.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve

Alarmi i derës




Fig. 177 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Mbyllni derën.

▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit.

Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës. (shihni Vendosja e alarmit të derës)

Gabim




Fig. 178 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Do të shfaqet kodi i gabimit.
▶ Mbani shënim kodin e gabimit.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit.
▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Gabim i WLAN

▶ Kontrolloni lidhjen me rrjetin WLAN.
▶ Lidhni pajisjen nga e para me rrjetin WLAN. (shihni WLAN)

8.3.3 Përmbledhje e kujtesave

Sjellja e pajisjes në rastin e kujtesave:

- Kujtesa shfaqet në ekran në ngjyrë të verdhë.
- Bie tingulli i alarmit.
- Në disa kujtesa pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Ju mund të çaktivizoni kujtesat e mëposhtme (shihni Çaktivizimi i kujtesës) :

- Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir

Mesazhi	Shkaku	Mënjanimi i mesazhit
 * **Zëvendësimi i filtrit të ujit***	Mesazhi shfaqet kur ju duhet të zëvendësoni filtrin e ujit.*	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Zëvendësimi i filtrit të ujit*) *
 **Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir**	Mesazhi shfaqet kur duhet të zëvendësoni filtrin me karbon aktiv të FreshAir.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir)

8.3.4 Mënjanimi i kujtesave

Zëvendësimi i filtrit të ujit*

Liebherr këshillon: Ndërroni filtrin e ujit çdo 6 muaj.

Shënim
Sie erhalten den Wasserfilter im Liebherr-Hausgeräte-Shop unter go.liebherr.com/47wtc4.




Fig. 179 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani tregon informacionet për kujtesën.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▶ Zëvendësoni filtrin e ujit. (shihni 10.3 Filtri i ujit*)
▷ Filtri i ujit garanton cilësi optimale të ujit.
▷ Kujtesa shfaqet përsëri pas 6 muajsh.

Nëse nuk dëshironi që ta merrni më këtë kujtesë, atëherë mund ta çaktivizoni kujtesën. (shihni Çaktivizimi i kujtesës)

Zëvendësimi i filtrit me karbon aktiv të FreshAir

Liebherr këshillon: Zëvendësoni filtrin me karbon aktiv të FreshAir çdo 6 muaj.

Shënim
Sie erhalten den FreshAir-Aktivkohlefilter im Liebherr-Hausgeräte-Shop unter go.liebherr.com/47wtc4.




Fig. 180 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani tregon informacionet për kujtesën.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▶ Zëvendësoni filtrin me karbon aktiv. (shihni 10.1 Filtri me karbon aktiv i FreshAir)
▷ Filtri me karbon aktiv cilësi optimale të ajrit në frigorifer.
▷ Kujtesa shfaqet përsëri pas 6 muajsh.

Nëse nuk dëshironi që ta merrni më këtë kujtesë, atëherë mund ta çaktivizoni kujtesën. (shihni Çaktivizimi i kujtesës)

9 Pajisjet

9.1 Ndarja e ngrirjes me 4 yje*

9.1.1 Hapja / mbyllja e ndarjes së ngrirjes




Fig. 181

Hapja e ndarjes së ngrirjes:
▶ Kapni nga poshtë në zonën e dorezës.
▶ Shtyni pllakën e dorezës dhe në të njëjtën kohë tërhiqni derën nga përpara.

Mbyllja e ndarjes së ngrirjes:
▶ Mbyllni derën dhe në të njëjtën kohë shtyjeni nga përpara.
▷ Dera mbyllet në vend.

9.2 Raftet e derës

Raftet e derës janë të përshtatshme për ruajtjen e pijeve dhe të ushqimeve. Ju mund t'i zhvendosni raftet e derës për përdorim individual dhe t'i hiqni ato për t'i pastruar. Por Liebherr këshillon që raftet e derës të përdoren në pozicionin e vendosur në derë të dërguar nga fabrika.




Fig. 182 Shembull ilustrues Raftet e derës
(1) Rafti mbajtës




Fig. 183 Shembull ilustrues Rafti i derës me VarioBox
(1) Rafti mbajtës
(2) Pjesa mbajtëse për VarioBox
(3) VarioBox-et
(4) Pjesa anësore




Fig. 184 Shembull ilustrues Rafti i derës me mbajtëse për shishe
(1) Rafti mbajtës
(2) Mbajtësja e shisheve

Tabela më poshtë tregon shembuj sesi mund të ruani gjërat në secilin raft të derës.

Raftet e derës	Ushqimi
Rafti i derës (shihni Fig. 182)	Gjalpë, djathë, konserva, tubeta
Rafti i derës me mbajtëse për shishe (shihni Fig. 184)	Shishet Me mbajtësen e shisheve që lëviz ju siguroni shishet në raftin e derës.
Rafti i derës me VarioBox (shihni Fig. 183)	Ushqimet e vogla

9.2.1 Heqja e kutive VarioBox

Ju mund të përdorni vetëm një ose që të dyja kutitë VarioBox. Kur në raftin e derës poshtë raftit të derës me VarioBox-e dëshironi të mbani shishe të larta, atëherë ju mund të hiqni një ose të dyja kutitë VarioBox.




Fig. 185

▶ Tërhiqni jashtë kutitë VarioBox deri në fund.
▶ Ngrini lart kutitë VarioBox në pjesën përpara.
▶ Hiqni nga përpara kutitë VarioBox.

9.2.2 Heqja e rafteve të derës

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Kutitë VarioBox janë hequr. (shihni 9.2.1 Heqja e kutive VarioBox)




Fig. 186 Shembull ilustrues

▶ Shtyni raftin e derës nga poshtë për lart.
▶ Tërhiqni për nga përpara raftin e derës.

9.2.3 Vendosja e rafteve të derës

Shënim
Formim i kondensimit në ndarjen e ngrirjes me 4 yje për shkak të pozicionit të gabuar të raftit të derës me kuti VarioBox!*
Nëse pajisja juaj është e pajisur me një ndarje ngrirjeje me 4 yje, atëherë, raftet e derës me kuti VarioBox mund të çrregullojnë shpërndarjen e ajrit në pjesën e ftohjes dhe si rezultat të krijohet kondensim në ndarjen e ngrirjes me 4 yje. Për një shpërndarje optimale të ajrit në pjesën e ftohjes Liebherr rekomandon:

▶ Vendosni raftin e derës me kuti VarioBox në një lartësi nën ndarjen e ngrirjes me 4 yje.

VINI RE
Rrezik lëndimi dhe dëmtimi nga vendosja e gabuar e ushqimeve ose objekteve!
Kur vendosni ushqime ose objekte qelqi mbi pllakën më të poshtme prej xhami, dera mund të mos mbyllet mirë. Si pasojë, rafti i derës mund të thyhet, ushqimet ose objektet mund të bien dhe mund të shkaktojnë lëndime.

▶ Mbajeni të lirë pjesën e përparme të pllakës më të poshtme prej xhami.




Fig. 187 Shembull ilustrues
(1) Zona e përparme

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Kutitë VarioBox janë hequr. (shihni 9.2.1 Heqja e kutive VarioBox)




Fig. 188 Shembull ilustrues

▶ Shtyni brenda raftin e derës.
▶ Shtypni për poshtë raftin e derës.

9.2.4 Vendosja e kutive VarioBox




Fig. 189

▶ Vendosni kutitë VarioBox pjerrtas në brinjët e raftit të derës.
▶ Ulni poshtë kutitë VarioBox.
▶ Shtyni brenda kutitë VarioBox.

9.2.5 Ndryshimi i kutive VarioBox

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Kutitë VarioBox janë hequr. (shihni 9.2.1 Heqja e kutive VarioBox)
❑ Rafti i derës është hequr. (shihni 9.2.2 Heqja e rafteve të derës)




Fig. 190

▶ Largoni nga prapa pjesën mbajtëse *Fig. 190 (1)* në pozicionin *Fig. 190 (A)*.
▶ Vendosni pjesën mbajtëse *Fig. 190 (1)* në pozicionin *Fig. 190 (B)*.
▶ Vendosni raftin e derës. (shihni 9.2.3 Vendosja e rafteve të derës)




Fig. 191

▶ Vendosni kutitë VarioBoxnë rendin e kundërt. (shihni Fig. 191)

9.3 Raftet mbajtës

Ka rafte të ndryshme mbajtës sipas llojit të pajisjes:

- raft mbajtës njëcopësh
- raft mbajtës i ndashëm
- Rafti i ndryshueshëm mbajtës i shisheve (shihni 9.7 Rafti mbajtës praktik i shisheve)




Fig. 192 Shembull ilustrues i raftit mbajtës
(1) Rafti mbajtës **(2)** Ndaluese sigurie




Fig. 193 Shembull ilustrues i raftit të ndashëm mbajtës
(1) Rafti mbajtës **(2)** Ndaluese sigurie

9.3.1 Përdorimi i rafteve mbajtës

Ju mund t'i zhvendosni raftet mbajtës në lartësi, ose t'i nxirrni plotësisht apo për t'i pastruar.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Raftet mbajtës janë bosh.

Heqja e raftit mbajtës

Raftet mbajtës janë të siguruar me ndaluese sigurie kundër tërheqjes së paqëllimshme të tyre.




Fig. 194

▶ Ngrini raftet mbajtës.
▶ Nxirrni nga përpara raftin mbajtës.

-ose-




Fig. 195

▶ Heqja e thjeshtë: Vendoseni pjerrtas raftin mbajtës dhe nxirreni nga përpara.

▷ Raftet mbajtës janë hequr.
▷ Ju mund t'i vendosni raftet mbajtës në një lartësi tjetër.

Vendosja e rafteve mbajtës




Fig. 196

Kur ndalueset e sigurisë janë me drejtim poshtë:

▶ Shtyjeni brenda raftin mbajtës deri në fund.
▶ Uleni poshtë raftin mbajtës.

-ose-




Fig. 197

▶ Futeni pjerrtas raftin mbajtës dhe uleni poshtë.

▷ Ndalueset e sigurisë ndodhen prapa raftit mbajtës të përparmë.

9.3.2 Përdorimi i rafteve të ndashëm mbajtës

Ju mund t'i shtyni së bashku raftet e ndashëm mbajtës në pozicionin e dhënë nga fabrika, t'i zhvendosni në lartësi ose t'i hiqni për t'i pastruar.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Raftet mbajtës janë bosh.

Shtyrja bashkë e rafteve të ndashëm mbajtës




Fig. 198

▶ Shtyjeni poshtë raftin mbajtës sipas figurës.
▷ Rafti i ndashëm mbajtës janë shtyrë bashkë.
▷ Ka hapësirë për ushqime më të larta në raftin mbajtës të vendosur poshtë.

Përdorimi i dy rafteve të ndashëm mbajtës

▶ Kapni me një dorë raftin mbajtës poshtë dhe tërhiqeni përpara.
▷ Profilin dekorativ qëndron përpara.
▷ Ndalueset e sigurisë janë të drejtuara për poshtë.

Zhvendosja e rafteve të ndashëm mbajtës në lartësi




Fig. 199

▶ Ngrini nga përpara raftin e përparmë mbajtës.
▶ Nxirrni nga përpara raftin e përparmë mbajtës.




Fig. 200

▶ Ndiqni hapat e procesit edhe për raftin e pasmë mbajtës.

KUJDES
Pajisjet me ndarje ngrirjeje:*
▶ Mos i vendosni shinat e vendosjes dhe raftet mbajtës me ndarje përpara ventilatorit.




Fig. 201

▶ Nxirrni jashtë shinat e vendosjes.
▶ Vendosini raftet mbajtës në lartësinë e dëshiruar.




Fig. 202

▶ Shtyjeni raftin mbajtës brenda deri në fund, me ndaluesen e lartë të sigurisë.
▶ Uleni poshtë raftin mbajtës.
▷ Ndalueset e sigurisë ndodhen prapa raftit mbajtës të pasmë.




Fig. 203

▶ Ndiqni hapat e procesit edhe për raftin e përparmë mbajtës.

Heqja e rafteve të ndashëm mbajtës

Raftet e ndashëm mbajtës hiqini siç i zhvendosni raftet mbajtës. (shihni Zhvendosja e rafteve të ndashëm mbajtës në lartësi)

9.4 Rafti mbajtës me ndarje

9.4.1 Përdorimi i raftit mbajtës me ndarje

Raftet mbajtës janë të siguruar me ndalesa zgjatjeje kundër tërheqjes së paqëllimshme të tyre.




Fig. 204

▶ Shtyjeni nga poshtë raftin mbajtës siç tregohet në figurë.




Fig. 205

Zhvendosja në lartësi:

▶ Tërhiqni një nga një pllakat e xhamit nga përpara *Fig. 205 (1)*.
▶ Nxirrni shinat e vendosjes nga foleja e kapjes dhe futini në lartësinë që dëshironi.
▶ Futni pllakat e xhamit një nga një njëra pas tjetrës.
▷ Ndalesa e sheshtë e tërheqjes përpara, direkt poshtë shinës së vendosjes.
▷ Ndalesa e lartë e tërheqjes prapa.

Përdorimi i të dy rafteve mbajtës:

▶ Kapni me një dorë pllakën e xhamit poshtë dhe tërhiqeni nga përpara.
▷ Pllaka e xhamit *Fig. 205 (1)* me kornizën ndodhet përpara.
▷ Ndaluesit *Fig. 205 (3)* janë të drejtuar për poshtë.
Pajisjet me dhomë ngrirjeje:*
▶ Mos i vendosni shinat e vendosjes dhe raftet mbajtës me ndarje përpara ventilatorit.*

9.5 VarioSafe *

VarioSafe ofron në pjesën e ftohjes vend, p.sh. për ushqime, paketime, tubeta dhe kavanoza të vegjël.




Fig. 206

(1) Sirtari VarioSafe

(2) Faqet anësore me brinjë për sirtarin VarioSafe

(3) Foletë në faqen anësore majtas dhe djathtas

9.5.1 Vendosja e VarioSafe




Fig. 207

▶ Futni pjerrtas VarioSafe në pjesën e ftohjes *Fig. 207 (1)*, derisa foletë anësore *Fig. 207 (2)* të VarioSafe të jenë në lartësinë e brinjëve të kutisë në pjesën e ftohjes.




Fig. 208

▶ Vendosni drejt VarioSafe. *Fig. 208 (1)*
▶ Ngrini lart VarioSafe në pjesën përpara. *Fig. 208 (2)*




Fig. 209

▶ Ngrini lart VarioSafe për nga përpara.
▶ Shtyni VarioSafe për nga prapa.
▶ Ulni poshtë VarioSafe.
▷ VarioSafe mbërthehet përpara duke lëshuar zhurmën e kapjes.
▷ VarioSafe është vendosur në vend.

9.5.2 Zhvendosja e VarioSafe

Ju mund ta zhvendosni VarioSafe si një të tërë në pjesën e ftohjes.




Fig. 210

▶ Ngrini lart VarioSafe në pjesën përpara.




Fig. 211

▶ Tërhiqni VarioSafe për nga përpara, derisa foletë anësore të VarioSafe të jenë në lartësinë e brinjëve të kutisë në pjesën e ftohjes. *Fig. 211 (1)*

▶ Lëvizni VarioSafe për lart ose për poshtë në pjesën e ftohjes, derisa të arrihet lartësia që dëshironi. *Fig. 211 (2)*




Fig. 212

▶ Ngrini lart VarioSafe në pjesën përpara.

▶ Shtyni VarioSafe për nga prapa.

▷ VarioSafe mbërthehet përpara duke lëshuar zhurmën e kapjes.

▷ VarioSafe zhvendoset në lartësi.

9.5.3 Zhvendosja e sirtarit VarioSafe

Ju mund ta vendosni sirtarin VarioSafe në dy lartësi të ndryshme. Kur në sirtarin VarioSafe dëshironi të ruani ushqime të larta, atëherë futeni sirtarin VarioSafe në brinjën e poshtme. Kur në sirtarin VarioSafe dëshironi të ruani ushqime të ulëta, atëherë futeni sirtarin VarioSafe në brinjën e sipërme.




Fig. 213

▶ Tërhiqni jashtë sirtarin VarioSafe deri në fund.

▶ Ngrini lart sirtarin VarioSafe në pjesën përpara.

▶ Hiqni sirtarin VarioSafe nga përpara.




Fig. 214

▶ Ngrini lart sirtarin VarioSafe në pjesën përpara.

▶ Vendosni sirtarin VarioSafe prapa ndaluesve në brinjën që dëshironi *Fig. 214 (1)* ose *Fig. 214 (2)*.

▷ Sirtari VarioSafe zhvendoset në lartësi.

9.5.4 Heqja e VarioSafe

Ju mund ta hiqni sirtarin VarioSafe si një të tërë.




Fig. 215

▶ Ngrini lart VarioSafe në pjesën përpara.




Fig. 216

▶ Tërhiqni VarioSafe për nga përpara *Fig. 216 (1)*, derisa foletë anësore të VarioSafe të jenë në lartësinë e brinjëve të kutisë në pjesën e ftohjes. *Fig. 216 (2)*




Fig. 217

▶ Vendosni VarioSafe pjerrtas në pjesën e ftohjes. *Fig. 217 (1)*

▶ Hiqni VarioSafe për nga përpara. *Fig. 217 (2)*

▷ VarioSafe do të hiqet.

9.5.5 Zbërthimi i VarioSafe

Ju mund ta zbërtheni sirtarin VarioSafe në pjesët e tij të veçanta, kur dëshironi që ta pastroni sirtarin VarioSafe ose kur doni të montoni ose të çmontoni pjesë të veçanta.




Fig. 218

▶ Hiqni VarioSafe si një të tërë. (shihni 9.5.4 Heqja e VarioSafe)

▶ Zbërtheni VarioSafe siç tregohet në figurë.

9.6 InfinitySpring*

Shpërndarësi i integruar i ujit është i përshtatshëm për marrjen komode të ujit të pijshëm. Temperatura e ujit varet nga temperatura në ndarjen e ftohjes.




Fig. 219

▶ Ngjishni gotën e ujit në butonin e poshtëm të shpërndarësit.

▷ Njësia e nxjerrjes së ujit zgjatet jashtë: Uji rrjedh në gotë.

▶ Shmangia e spërkatjes së ujit: Hiqeni gotën e ujit me ngadalë.

Nxjerrja e shumë uji nga rubineti:

▶ Kur nuk del më ujë, hiqni enën e ujit dhe shtypni sërish në butonin e poshtëm të shpërndarësit.

9.7 Rafti mbajtës praktik i shisheve

Në fundin e ndarjes së ftohjes, ju mund të përdorni pllakën e xhamit ose raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve. Në gjendjen e dërgimit, pllaka e xhamit është e vendosur.




Fig. 220 Shembull ilustrues

(1) Rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve

9.7.1 Përdorimi i raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve




Fig. 221

▶ Ngrini lart përpara pllakën e xhamit *Fig. 221 (1)* te foleja dhe tërhiqeni jashtë.

▶ Ruani të sigurt pllakën e xhamit *Fig. 221 (1)* jashtë pajisjes.
▶ Vendoseni pllakën e xhamit *(2)* nën raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve.




Fig. 222 Shembull ilustrues

▶ Shtrini shishet me fundin të drejtuar në faqen e pasme të frigoriferit. (shihni Fig. 222)

Shënim
Nëse shishet janë më të gjata sesa rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve:
▶ Vendosni raftin e poshtëm të derës në një pozicion më të lartë.

9.7.2 Përdorimi i pllakës së xhamit

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Shishet janë hequr.
❑ Rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve është pastruar. (shihni 10.7 Heqja / vendosja e raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve)
(shihni 10.11.3 Pastrimi i pjesëve)




Fig. 223

▶ Vendosni pllakën e xhamit *Fig. 223 (1)* pjerrtas, dhe të anuar për poshtë në pjesën prapa.
▶ Ulni poshtë pllakën e xhamit *Fig. 223 (1)* përpara.

9.8 Sirtarët

Ju mund t'i hiqni sirtarët për t'i pastruar ata.

Heqja dhe vendosja e sirtarëve ndryshon sipas sistemit të tërheqjes. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Shënim
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit brenda në faqen e pasme.

9.8.1 Sirtari mbi shina teleskop

Sirtari lëviz me shinat që zgjaten jashtë (shinat teleskop). Ekzistojnë shina teleskop me tërheqje të plotë jashtë dhe shina teleskop me tërheqje të pjesshme jashtë. Sirtarët me tërheqje të plotë jashtë mund të nxirren plotësisht jashtë nga pajisja. Sirtarët me tërheqje të pjesshme jashtë nuk mund të nxirren plotësisht jashtë nga pajisja. Lloji i sistemit që gjendet në pajisjen tuaj varet nga lloji i pajisjes.

Kaseta me hapje të plotë*

Kasetën me hapje të plotë mund ta dalloni nga një kapëse që gjenden në çdo anë prapa majtas dhe djathtas në shinë.

Heqja e sirtarit




Fig. 224

▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
▶ Ngrini lart kapësen e majtë dhe në të njëjtën kohë tërhiqni nga përpara sirtarin e majta. *Fig. 224 (1)*
▶ Ngrini lart kapësen e djathtë dhe në të njëjtën kohë tërhiqni nga përpara sirtarin nga e djathta. *Fig. 224 (2)*
▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 224 (3)*
▶ Shtyni shinat brenda.

Vendosja e sirtarit




Fig. 225

▶ Shtyni shinat brenda.
▶ Vendosni sirtarin mbi shina.
▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.
▷ Dëgjohet zhurma e kapjes së sirtarit në pjesën prapa.

Ndarja e ftohjes me dalje të pjesshme jashtë*

Heqja e sirtarit




Fig. 226

▶ Tërhiqni jashtë sirtarin deri në gjysmë. *Fig. 226 (1)*
▶ Shtypni për poshtë sirtarin në pjesën përpara. *Fig. 226 (2)*
▶ Shtyni brenda shinën e majtë rreth 2 cm. *Fig. 226 (3)*
▶ Shtyni brenda shinën e djathtë rreth 2 cm. *Fig. 226 (4)*
▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 226 (5)*




Fig. 227

Kur pas heqjes së sirtarit, shinat nuk janë futur ende plotësisht brenda:

▶ Shtyni shinat plotësisht brenda.

Vendosja e sirtarit




Fig. 228

▶ Shtyni shinat brenda.
▶ Vendosni sirtarin mbi shina.
▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

9.9 Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable

Kapaku i ndarjes kujdeset për lagështinë e vazhdueshme të pranishme të ajrit.

Kapaku i ndarjes ndodhet direkt mbi sirtar dhe mund të mbulohet nga raftet mbajtëse ose nga sirtarë të tjerë shtesë.




Fig. 229 Shembull ilustrues Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable

(1) Koshi Fruit & Vegetable
(2) Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable
(3) Rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve

9.9.1 Ulja e lagështisë së ajrit në sirtar




Fig. 230

▶ Tërhiqni jashtë sirtarin *Fig. 230 (1)*.
▶ Kapni dorezën e futur *Fig. 230 (2)* në kapakun e ndarjes dhe në të njëjtën kohë tërhiqni përpara kapakun e ndarjes.
▷ Kur sirtari është i mbyllur, midis kapakut të ndarjes dhe sirtarit ka një hapësirë të vogël.
▷ Përdorimi i HydroBreeze nuk është i mundur. (shihni 9.10 HydroBreeze)

9.9.2 Rritja e lagështisë së ajrit në sirtar




Fig. 231

▶ Tërhiqni jashtë sirtarin *Fig. 231 (1)*.
▶ Kapni dorezën e futur *Fig. 231 (2)* në kapakun e ndarjes dhe në të njëjtën kohë shtyni për prapa kapakun e ndarjes.
▷ Kur sirtari është i mbyllur, kapaku i ndarjes mbyllet në mënyrë hermetike me sirtarin.
▷ Përdorimi i HydroBreeze është i mundur. (shihni 9.10 HydroBreeze)

9.9.3 Përdorimi i koshit Fruit & Vegetable si kosh Meat & Dairy

Ju mund ta përdorni koshin Fruit & Vegetable si kosh Meat & Dairy. Për këtë qëllim, duhet që të ulni lagështinë në sirtar. (shihni 9.9.1 Ulja e lagështisë së ajrit në sirtar)

9.9.4 Përdorimi i koshit Fruit & Vegetable me HydroBreeze

Ju mund ta përdorni koshin Fruit & Vegetable me HydroBreeze. Për këtë qëllim, duhet që të rritni lagështinë në sirtar. (shihni 9.9.2 Rritja e lagështisë së ajrit në sirtar)

9.10 HydroBreeze

HydroBreeze lagështon produktet në ftohje dhe kujdeset për lagështinë brenda në ndarje.

HydroBreeze dhe depozita përkatëse e ujit ndodhen në raftin mbajtës praktik të shisheve.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Depozita e ujit është pastruar. (shihni 10.11.3 Pastrimi i pjesëve)
- Depozita e ujit është futur në vend në mënyrën e duhur.
- Lagështia në sirtar është vendosur në cilësimin lagështi e lartë e ajrit. (shihni 9.9.2 Rritja e lagështisë së ajrit në sirtar)
- HydroBreeze është aktivizuar. (shihni HydroBreeze)

9.10.1 Mbushja e depozitës së ujit

PARALAJMËRIM
Uji i papastër!
Helmime.
▶ Mbusheni vetëm me ujë të pijshëm.
▶ HydroBreeze është i çaktivizuar: Zbrazni depozitën e ujit.
▶ HydroBreeze nuk do të përdoret për kohë të gjatë: Zbrazni depozitën e ujit.

KUJDES
Lëngjet që përmbajnë sheqer!
Dëmtim i HydroBreeze.
▶ Mbusheni vetëm me ujë të pijshëm.

Shënim
Nga përdorimi i ujit të filtruar dhe të dekarbonizuar, arrihet cilësia më e mirë e ujit të pijshëm për funksionimin pa probleme të HydroBreeze.
Kjo cilësi uji mund të arrihet me një filtër uji për tavolinë që blihet në një dyqan të specializuar për këto pajisje.
▶ Mbusheni enën e ujit me ujë të pijshëm të filtruar dhe të dekarbonizuar.

Depozita e ujit është e integruar te rafti mbajtës praktik i shisheve (shihni 2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve) .




Fig. 232
▶ Shtypni në cepin e pasmë majtas të pllakës së xhamit përpara.
▷ Pllaka e xhamit ngrihet lart përpara.
▶ Ngrini lart pllakën e xhamit dhe kthejeni për prapa deri në fund *Fig. 232 (1)*.
▷ Pllaka e xhamit qëndron vertikalisht.
▶ Shtyni rrëshqitësen *Fig. 232 (2)* nga e majta.
▷ Depozita e ujit kërcen lart nga gropa e futur.
▶ Hiqni depozitën e ujit *Fig. 232 (3)*.
▶ Pastroni depozitën e ujit (shihni 10.11.3 Pastrimi i pjesëve) .
Vrima me kënd të drejtë:
▶ Mbusheni me ujë të pijshëm deri te shenja.
▶ Futni depozitën e ujit në gropën përkatëse duke futur fillimisht fundin e saj.
▶ Ulni poshtë me ngadalë pjesën e përparme dhe ngjisheni depozitën.
▷ Depozita e ujit mbërthehet në vend.

9.10.2 Zbërthimi i depozitës së ujit

Ju mund ta zbërtheni depozitën e ujit të HydroBreeze për ta pastruar.




Fig. 233
▶ Ngjishni enën e ujit *Fig. 233 (2)* dhe ngrini e tërhiqni lart me kujdes kapakun *Fig. 233 (1)* nga gjuhëzat e kapjes *Fig. 233 (3)*.
▷ Kapaku do të lirohet.




Fig. 234
▶ Lëvizni lehtë kapakun *Fig. 233 (1)* përpara dhe mbrapa dhe hiqeni nga lart.
▷ Depozita e ujit do të zbërthehet.

9.11 Kutia e ruajtjes së gjalpit

9.11.1 Hapja / mbyllja e kutisë së gjalpit




Fig. 235

9.11.2 Zbërthimi i kutisë së gjalpit

Kutia e gjalpit mund të zbërthehet për ta pastruar.




Fig. 236

▶ Zbërtheni kutinë e gjalpit.

9.12 Rafti për vezët

Rafti për vezët është me tërheqje dhe mund të kthehet.
Të dyja pjesët e raftit për vezët mund të përdoren për të identifikuar ndryshimet midis vezëve, si p.sh. data e blerjes.

9.12.1 Përdorimi i raftit për vezët




Fig. 237

▶ Ana e sipërme: Ruani vezët e pulës.
▶ Ana e poshtme: Ruani vezët e shkurtës.

9.13 Mbajtësja e shisheve

9.13.1 Përdorimi i mbajtëses së shisheve




Fig. 238

▶ Shtyni mbajtësen e shisheve te shishet.
▷ Shishet nuk përmbysen.

9.14 FlexSystem

9.14.1 Përdorimi i FlexSystem

Sistemi FlexSystem mbështet ruajtjen e rregullt dhe fleksibël dhe ndarjen e ushqimeve. Ai lejon një nënndarje të qartë, për shembull me fruta, perime apo sipas datës së skadimit.




Fig. 239

▶ Zhvendosni tasin e brendshëm.

9.14.2 Heqja e FlexSystem




Fig. 240

▶ Ngrini lart FlexSystem në pjesën prapa.
▶ Hiqeni nga lart.

9.14.3 Vendosja e FlexSystem




Fig. 241

▶ Në fillim futeni FlexSystem në pjesën përpara.
▶ Ulni poshtë pjesën e pasme.

9.14.4 Zbërthimi i FlexSystem

FlexSystem mund të zbërthehet për ta pastruar.




Fig. 242

▶ Zbërtheni FlexSystem.

9.15 Forma me kapak e kubave të akullit*

9.15.1 Përdorimi i formës së kubave të akullit




Fig. 243

Kur uji është i ngrirë:

- ▶ Mbajeni formën e kubave të akullit nën ujë të ngrohtë për pak kohë.
- ▶ Hiqni kapakun.
- ▶ Rrotulloni lehtë në drejtim të kundërt cepat e formës së kubave të akullit.
- ▶ Kubat e akullit lirohen.

9.15.2 Zbërthimi i formës së kubave të akullit

Forma e kubave të akullit mund të zbërthehet për ta pastruar.




Fig. 244

- ▶ Zbërtheni formën e kubave të akullit.

10 Mirëmbajtja

10.1 Filtri me karbon aktiv i FreshAir

Filtri me karbon aktiv i FreshAir ndodhet në ndarjen mbi ventilatorin.

Ai siguron cilësi optimale të ajrit.

- ❑ Ndërroni filtrin me karbon aktiv çdo 6 muaj.
  Kur opsioni Kujtesa është i aktivizuar, në ekran shfaqet një mesazh për ndërrimin e filtrit.
- ❑ Filtri me karbon aktiv mund të hidhet në mbeturinat normale të shtëpisë.

Shënim
Sie erhalten den FreshAir-Aktivkohlefilter im Liebherr-Hausgeräte-Shop unter go.liebherr.com/47wtc4.

10.1.1 Heqja e filtrit me karbon aktiv të FreshAir




Fig. 245

- ▶ Tërhiqni kutinë nga përpara *Fig. 245 (1)*.
- ▶ Hiqni filtrin me karbon aktiv *Fig. 245 (2)*.

10.1.2 Vendosja e filtrit me karbon aktiv tëFreshAir




Fig. 246

- ▶ Vendosni filtrin me karbon aktiv siç tregohet në figurë *Fig. 246 (1)*.
- ▷ Filtri me karbon aktiv mbërthehet në vend.
  Kur filtri me karbon aktiv tregon për poshtë:
- ▶ Futni kutinë në vend *Fig. 246 (2)*.
- ▷ Tani filtri me karbon aktiv është gati për përdorim.

10.2 Depozita e ujit*

Depozita e ujit e InfinitySpring ndodhet prapa sirtarit më të poshtëm.*

10.2.1 Heqja e depozitës së ujit

- ▶ Mbyllni rubinetin e ujit.
- ▶ Nxirrni ujë nga rubineti InfinitySpring për 30 sekonda dhe mblidheni ujin e mbetur me një gotë.*
- ▶ Hiqni sirtarin.
- ▶ Rrotulloni depozitën e ujit deri në fund nga e majta dhe tërhiqeni jashtë.
- ▷ Uji që pikon jashtë mblidhet në tasin e mbledhjes së ujit.
- ▶ Zbrazni ujin në tasin e mbledhjes së ujit.*
- ▶ Pastroni tasin e mbledhjes së ujit me një leckë ose në larëse enësh.*

10.2.2 Vendosja e depozitës së ujit




Fig. 247

▶ Hiqni sirtarin.
▶ Futni depozitën e ujit dhe rrotullojeni djathtas deri në fund me rreth 90°.
▶ Kontrolloni nëse depozita e ujit është hermetike dhe që nuk rrjedh ujë.
▶ Vendosni në vend sirtarin.
▶ Hapni rubinetin e ujit.
▶ Nxirrni ajrin nga sistemi i furnizimit me ujë. (shihni 5.2.1 Nxjerrja e ajrit nga sistemi i furnizimit me ujë) *

Në vend të filtrit të ujit mund të përdoret një depozitë uji shtesë.*

Shënim
Kjo depozitë uji ofrohet dhe shitet si pjesë këmbimi.

10.2.3 Heqja / vendosja e tasit të mbledhjes së ujit*

Tasi i mbledhjes së ujit mund të hiqet për ta pastruar.




Fig. 248

▶ Tërhiqni nga përpara tasin e mbledhjes së ujit.

10.3 Filtri i ujit*

Filtri i ujit ndodhet prapa sirtarit më të poshtëm.

Ai filtron papastërtitë që ndodhen në ujë dhe zvogëlon shijen e klorit.

❑ Ndërroni filtrin e ujit në performancën e parashikuar maksimumi çdo 6 muaj ose në rastin kur konstatohet një zvogëlim i dukshëm i shpejtësisë së qarkullimit të ujit.
❑ Filtri i ujit përmban karbon aktiv dhe mund të hidhet me mbeturinat normale të shtëpisë.

Shënim
Sie erhalten den Wasserfilter im Liebherr-Hausgeräte-Shop unter go.liebherr.com/47wtc4.

10.3.1 Heqja e filtrit të ujit

▶ Hiqni sirtarin.
▶ Rrotulloni filtrin e ujit deri në fund nga e majta dhe tërhiqeni jashtë.
▷ Uji që pikon jashtë mblidhet në tasin e mbledhjes së ujit.
▶ Pastroni tasin e mbledhjes së ujit me një leckë ose në larëse enësh.*

10.3.2 Vendosja e filtrit të ujit




Fig. 249

▶ Hiqni sirtarin.
▶ Futni filtrin e ujit dhe rrotullojeni djathtas deri në fund me rreth 90°.
▶ Kontrolloni nëse filtri është hermetik dhe që nuk rrjedh ujë.
▶ Vendosni në vend sirtarin.

Shënim
Filtrat e rinj të ujit mund të përmbajnë substanca në pezulli.*
▶ Pas ndërrimit të filtrit: nxirrni 3 l ujë në rubinetin e InfinitySpring dhe derdheni.

▷ Pas kësaj filtri i ujit është gati për përdorim.

10.4 Zbërthimi i raftit të derës

Ju mund ta zbërtheni raftin e derës, kur dëshironi ta pastroni atë ose kur doni të montoni ose të çmontoni pjesë të veçanta.

10.4.1 Zbërthimi i raftit të derës

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Rafti i derës është hequr. (shihni 9.2.2 Heqja e rafteve të derës)




Fig. 250 Rafti i derës me raft mbajtës

▶ Hiqni raftin mbajtës *Fig. 250 (1)*.

10.4.2 Zbërthimi i raftit të derës me VarioBox

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Rafti i derës është hequr. (shihni 9.2.2 Heqja e rafteve të derës)




Fig. 251

- ▶ Hiqni kutitë VarioBox. (shihni 9.2.1 Heqja e kutive VarioBox)
- ▶ Hiqni pjesën mbajtëse *Fig. 251 (1)*.
- ▶ Hiqni pjesët anësore *Fig. 251 (2)*.
- ▶ Hiqni raftin mbajtës *Fig. 251 (3)*.

10.4.3 Zbërthimi i raftit të derës me mbajtëse për shishe




Fig. 252 Rafti i derës me mbajtëse për shishe dhe raft mbajtës

- ▶ Shtyni mbajtësen e shisheve *Fig. 252 (1)* anash deri te foleja.
- ▶ Hiqni mbajtësen e shisheve *Fig. 252 (1)*.
- ▶ Hiqni raftin mbajtës *Fig. 252 (2)*.

10.5 Montimi i rafteve të derës

10.5.1 Montimi i rafteve të derës




Fig. 253 Rafti i derës me raft mbajtës

- ▶ Futni raftin mbajtës *Fig. 253 (1)* në foletë anësore.

10.5.2 Montimi i raftit të derës me VarioBox




Fig. 254

- ▶ Futni raftin mbajtës *Fig. 254 (1)* në foletë anësore.
- ▶ Vendosni pjesët anësore *Fig. 254 (2)*.
- ▶ Vendosni pjesën mbajtëse *Fig. 254 (3)*.
- ▶ Vendosni kutitë VarioBox. (shihni 9.2.4 Vendosja e kutive VarioBox)

10.5.3 Montimi i raftit të derës me mbajtëse për shishe




Fig. 255 Rafti i derës me raft mbajtës

- ▶ Futni raftin mbajtës *Fig. 255 (1)* në foletë anësore.
- ▶ Vendosni mbajtësen e shisheve *Fig. 255 (2)* te foleja.
- ▶ Shtyni anash mbajtësen e shisheve *Fig. 255 (2)* në pozicionin që dëshironi.

10.6 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje

10.6.1 Shënime për zbërthimin

Ju mund t'i zbërtheni disa sisteme me tërheqje për t'i pastruar. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Sistemet më tërheqje në vijim janë të çmontueshëm ose jo të çmontueshëm:

Sistemi me tërheqje	i çmontueshëm / jo i çmontueshëm
Kaseta me hapje të plotë*	jo i çmontueshëm*
Pjesa e ftohjes me dalje të pjesshme jashtë*	jo i çmontueshëm*

10.7 Heqja / vendosja e raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve

Ju mund ta hiqni raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve për ta pastruar.

10.7.1 Heqja e raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Shishet janë hequr.
- ❑ Pllaka e xhamit është hequr. (shihni 9.7.1 Përdorimi i raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve)




Fig. 256

- ▶ Raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve ngrijeni pak lart përpara dhe tërhiqeni jashtë.
- ▷ Kapaku i kutisë është i dukshëm.

Shënim
Liebherr këshillon:

Mos vendosni asnjë objekt mbi kapakun e kutisë që ndodhet poshtë.

10.7.2 Vendosja e raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve




Fig. 257

- ▶ Shtyjeni raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve deri në fund dhe pastaj ngjisheni për poshtë.
- ▷ Kapësët në pjesën e pasme të raftit mbajtës të ndryshueshëm të shisheve lidhen automatikisht.
- ▷ Drita LED ndizet.
- ▶ Vendosni pllakën e xhamit. (shihni 9.7.2 Përdorimi i pllakës së xhamit)

-ose-

- ▶ Përdorni raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve vetëm për shishe.

10.8 Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable

Ju mund ta hiqni kapakun e ndarjes për ta pastruar.

10.8.1 Heqja e kapakut të ndarjes

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Pllaka e xhamit direkt mbi raftin mbajtës të ndryshueshëm të shisheve është hequr.
- ❑ Rafti mbajtës i ndryshueshëm i shisheve është hequr.
- ❑ Sirtari direkt nën kapakun e ndarjes është hequr. (shihni 9.8 Sirtarët)




Fig. 258

- ▶ Shtyni për prapa kapakun e ndarjes.
- ▶ Ngrini nga përpara kapakun e ndarjes.
- ▶ Nxirrni jashtë pjerrtas përpara kapakun e ndarjes duke e ngritur lart.

10.8.2 Vendosja e kapakut të ndarjes




Fig. 259

Kur shkrimi THIS SIDE UP ndodhet lart:

- ▶ Vendosni pjesët mbajtëse të pasme në vrimat përkatëse të pasme.
- ▶ Shtyni për prapa kapakun e ndarjes.
- ▶ Ulni poshtë përpara kapakun e ndarjes dhe futni në vrimat përkatëse pjesët mbajtëse të përparme.
- ▶ Çojeni kapakun e ndarjes në pozicionin që dëshironi.

10.9 Shkrirja e pajisjes

PARALAJMËRIM
Shkrirja e papërshtatshme e pajisjes!
Lëndime dhe dëmtime.

- ▶ Për të shpejtuar procesin e shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje tjetër mekanike ose ndonjë mënyrë tjetër përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- ▶ Mos përdorni asnjë pajisje ngrohëse elektrike ose pajisje pastrimi me avull, flakë të zbuluara ose spërkatës për shkrirje.
- ▶ Mos e hiqni akullin me objekte të mprehta.

Shkrirja kryhet automatikisht. Uji i shkrirjes rrjedh jashtë nëpërmjet vrimës së shkarkimit dhe avullon.

- ▶ Pastroni rregullisht vrimën e shkarkimit (shihni 10.11 Pastrimi i pajisjes) .


10.10 Shkrirja manuale e ndarjes së ngrirjes*

Pas funksionimit për kohë të gjatë formohet një shtresë bore ose akulli.

Formimin e shtresës së borës ose të akullit e shpejtojnë faktorët e mëposhtëm:

- Pajisja hapet shpesh.
- Futja e ushqimit të ngrohtë.

▶ Fikni pajisjen.
▶ Hiqni spinën elektrike nga priza elektrike ose fikni siguresën.
▶ Ushqimin e ngrirë mbulojeni me letër gazete ose kapak dhe vëreni në ruajtje në një vend të freskët.



▶ Vendosni një tenxhere me ujë të nxehtë, jo duke vluar, mbi pllakën e mesit.
▷ Shkrirja do të shpejtohet.
▶ Lëreni hapur derën e pajisjes dhe të ndarjes gjatë procesit të shkrirjes.
▶ Hiqni me dorë copat e akullit të shkëputura.
▶ Thithni disa herë, sipas nevojës, ujin e shkrirjes me një sfungjer ose me një pecetë.
▶ Pastroni pajisjen. (shihni 10.11 Pastrimi i pajisjes)

10.11 Pastrimi i pajisjes

10.11.1 Parapërgatitja

PARALAJMËRIM
Rrezik nga goditja elektrike!
▶ Hiqni spinën e frigoriferit ose ndërpritni furnizimin me energji elektrike.

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje!
▶ Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.

▶ Zbrazni pajisjen.
▶ Hiqni spinën elektrike.
-ose-
▶ Aktivizoni CleaningMode. (shihni CleaningMode)

10.11.2 Pastrimi i hapësirës së brendshme

KUJDES
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.
▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

▶ Sipërfaqet plastike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Sipërfaqet metalike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Vrima e shkarkimit: hiqni papastërtitë e grumbulluara me një mjet ndihmës të hollë, p.sh. me kunj për veshët.

10.11.3 Pastrimi i pjesëve

KUJDES
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.
▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

Pastrimi me një pecetë të butë e të pastër, ujë të vakët dhe pak detergjent:

- Rafti mbajtës
- Rafti mbajtës me ndarje
- VarioSafe*
- Kapaku i ndarjes së koshit Fruit & Vegetable
- Sirtari
- Rafti mbajtës praktik i shisheve
- FlexSystem

Pastrimi me pecetë të lagësht:

- Shinat teleskop
  Mbani parasysh: Grasoja në shinat e rrëshqitjes shërben për lubrifikimin dhe nuk duhet fshirë!

Pastrimi në larëse enësh deri në 60 °C:

- Raftet e derës
- VarioBox
- Mbajtësja e shisheve
- Rafti mbajtës me ndarje me pjesë mbajtëse
- Depozita e ujit e HydroBreeze dhe kapaku i depozitës së ujit
- Tasi i mbledhjes së ujit*
- Rafti për vezët
- Kutia e ruajtjes së gjalpit
- Forma e kubave të akullit*

▶ Zbërthimi i pjesëve: shihni kapitullin përkatës.
▶ Pastroni pjesët.

10.11.4 Pastrimi i InfinitySpring *

Njësia e nxjerrjes së ujit e InfinitySpring dhe vendi përreth mund të pastrohen pa e shkëputur pajisjen nga rrjeti elektrik.

Pastrimi duhet kryer në rastet më poshtë:

❑ Vënia në punë herën e parë
❑ Mospërdorimi për më shumë se 5 ditë.

▶ Shtypni butonin e poshtëm të shpërndarësit.
▷ Njësia e nxjerrjes së ujit zgjatet jashtë.
▶ Pastroni vendin e daljes së ujit dhe vendin përreth me një pecetë të butë e të pastër, ujë të vakët dhe pak detergjent.
▶ Lëshoni butonin e poshtëm.
▶ Nxirrni 2 l ujë në rubinetin e InfinitySpring dhe derdheni.

10.11.5 Pastrimi i HydroBreeze

Pastrimi duhet kryer në rastet më poshtë:

❑ Vënia në punë herën e parë
❑ HydroBreeze është çaktivizuar prej më shumë se 48 orësh.
❑ Mbushja e re e depozitës së ujit.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ HydroBreeze është i çaktivizuar (shihni HydroBreeze) .
❑ Depozita e ujit është hequr dhe është larë në larëse enësh.

▶ Fshini gropën e vendosjes me një pecetë të lagësht.
▶ Vendosni në vend depozitën e ujit.

▶ Aktivizoni HydroBreeze.

10.11.6 Pas pastrimit

▶ Thani pajisjen dhe pjesët përshtatëse duke i fërkuar.
▶ Lidhni pajisjen dhe ndizeni.
Kur temperatura të jetë mjaftueshëm e ftohtë:
▶ Futni ushqimet.
▶ Përsëritni pastrimin rregullisht.

11 Ndihma për klientin

11.1 Të dhënat teknike

Diapazoni i temperaturave	
Ftohja	3 °C deri në 9 °C
BioFresh	0 °C deri në 3 °C

Sasia maksimale e ngrirjes / 24 orë	
Ndarja e ngrirjes*	Shihni etiketën e parametrave te „Kapaciteti i ngrirjes .../ 24 h“ *

Ndriçimi	
Klasa e efiçencës së energjisë[1]	Burimi i dritës
Ky produkt përmban një ose më shumë burime drite të klasës së efiçencës së energjisë "G".	LED

[1] *Pajisja mund të ketë burime drite me klasa të ndryshme të efiçencës së energjisë. Këtu jepet klasa e efiçencës më të ulët të energjisë.*

Për pajisjet me lidhje Wi-Fi:

Të dhënat e frekuencave	
Brezi i frekuencave	2,4 GHz
Fuqia maksimale e rrezatuar	< 100 mW
Qëllimi i përdorimi i pajisjes me radiovalë	Lidhja në rrjetin lokal Wi-Fi për komunikimin e të dhënave

11.2 Zhurmat gjatë punës

Pajisja shkakton nivele të ndryshme zhurme gjatë funksionimit të saj.

- Në **performancë të ulët ftohjeje** pajisja punon duke kursyer energji, por punon më gjatë. Niveli i zhurmës është më **i ulët**.
- Në **kapacitet të lartë freskimi** ushqimet ftohen më shpejt. Niveli i zhurmës është më **i lartë**.

  Shembuj:
  - funksionet e aktivizuara (shihni 8.2 Funksionet e pajisjes)
  - ventilatori që punon
  - ushqimi i vendosur i freskët
  - temperatura e lartë e ambientit
  - dera e mbajtur hapur gjatë

Zhurma	Shkaku i mundshëm	Lloji i zhurmës
Zhurmë qarkullimi dhe gurgullime	Agjenti ftohës qarkullon në qarkun e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Fërshëllimë dhe shfryrje	Agjenti ftohës injektohet në qarkun e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Gumëzhimë	Pajisja është duke ftohur. Niveli i zhurmës varet performanca e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Zhurma gëlltitjeje	Dera me amortizator mbylljeje hapet dhe mbyllet.	Zhurmë pune normale
Zukatje dhe fështfërimë	Ventilatori është duke punuar.	Zhurmë funksionimi normale
Klikim	Komponentët ndizen dhe fiken.	Zhurmë veprimi normale
Kërcitje ose zukamë	Valvulat ose ventilet janë aktive.	Zhurmë veprimi normale

Zhurma	Shkaku i mundshëm	Lloji i zhurmës	Mënjanimi
Dridhje	Instalimi i papërshtatshëm	Zhurmë gabimi	Kontrolloni instalimin. Niveloni pajisjen.
Kërcitje	Pajisjet, Objektet në brendësi të pajisjes	Zhurmë gabimi	Fiksoni pjesët e pajisjeve. Lini distancë midis objekteve brenda.

11.3 Defektet teknike

Pajisja juaj është projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e funksionimit dhe jetëgjatësia e madhe. Por megjithatë kur gjatë përdorimit shfaqet një problem, verifikoni nëse problemi është shkaktuar si rezultat i një gabimi në përdorim. Në këtë rast, duhet të merrni në konsideratë kostot e riparimit, edhe gjatë periudhës së garancisë.

Problemet që jepen në vijim mund t'i eliminoni vetë.

11.3.1 Funksioni i pajisjes

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	▶ Ndizni pajisjen.
	→ Spina nuk është futur saktë në prizën elektrike.	▶ Kontrolloni spinën.

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
	→ Siguresa në prizën elektrike nuk është në rregull.	▶ Kontrolloni siguresën.
	→ Shkëputje e energjisë elektrike	▶ Mbani të mbyllur pajisjen. ▶ Mbrojtja e ushqimeve: Shtroni pllakat ftohëse lart mbi ushqime ose përdorni një pajisje tjetër ngrirëse, nëse shkëputja e energjisë elektrike zgjat shumë.* ▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e shkrira.*
	→ Fisha e frigoriferit nuk është futur mirë në pajisje.	▶ Kontrolloni fishën e frigoriferit.
Temperatura nuk është mjaftueshëm e ftohtë.	→ Dera e pajisjes nuk është e mbyllur siç duhet.	▶ Mbyllni derën e pajisjes.
	→ Qarkullimi i ajrit dhe ajrimi nuk është i mjaftueshëm.	▶ Mbani të lirë dhe pastroni rrjetën e ajrimit.
	→ Temperatura e ambientit është shumë e lartë.	▶ Zgjidhja e problemit: (shihni 1.7 Klasat e klimës)
	→ Pajisja është hapur shumë shpesh ose për kohë të gjatë.	▶ Pritni për të parë nëse temperatura e kërkuar do të rivendoset vetvetiu. Nëse jo, kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
	→ Temperatura është vendosur gabim.	▶ Vendosni temperaturë më të ftohtë dhe kontrollojeni pas 24 orësh.
	→ Pajisja ndodhet shumë pranë një burimi nxehtësie (sobë, kalorifer etj.).	▶ Ndryshoni vendin e pajisjes ose të burimit të nxehtësisë.
	→ Pajisja nuk është instaluar saktë brenda në dollap.	▶ Kontrolloni nëse pajisja është instaluar në rregull dhe që dera mbyllet si duhet.
Guarnicioni i derës është me defekt ose duhet ndërruar për arsye të tjera.	→ Guarnicioni i derës është i ndërrueshëm. Ai mund të ndërrohet pa vegla pune shtesë.	▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
Pajisja ka zënë akull ose formohet ujë nga kondensimi.	→ Guarnicioni i derës mund të ketë dalë nga kanali.	▶ Kontrolloni futjen e duhur të guarnicionit të derës në kanal.

11.3.2 Pajisjet

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
InfinitySpring nuk funksionon.*	→ Brenda sistemit të ujit ka ajër.	▶ Ajrosni sistemin e ujit. (shihni 5.2 Vënia në funksionim e InfinitySpring*)
	→ Linja e furnizimit me ujë nuk është hapur.	▶ Hapni furnizimin me ujë.
Qarkullimi i ujit në InfinitySpring nuk është i njëtrajtshëm.*	→ Fleta e rregullatorit është bërë pis.	▶ Ndërroni fletën e rregullatorit. Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
HydroBreeze nuk i lagështon artikujt në freskim.	→ HydroBreeze nuk është i aktivizuar.	▶ Aktivizoni HydroBreeze.
	→ Depozita e ujit nuk ka mjaftueshëm ujë.	▶ Mbushni depozitën e ujit.
	→ Përpara përqendruesit ka papastërti.	▶ Pastroni HydroBreeze.
	→ Depozita e ujit nuk është futur si duhet në thellimin e parashikuar.	▶ Futni depozitën e ujit në mënyrën e duhur.

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
	→ Kapaku i ndarjes s koshit Fruit & Vegetable është vendosur në cilësimin „lagështi e ulët e ajrit“.	▶ Kapaku i ndarjes s koshit Fruit & Vegetable është vendosur në cilësimin „lagështi e lartë e ajrit“.
Ndriçimi i brendshëm nuk ndizet.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	▶ Ndizni pajisjen.
	→ Dera është mbajtur hapur më gjatë se 15 minuta.	▶ Ndriçimi i brendshëm fiket automatikisht pas 15 minutash kur dera e pajisjes është e hapur.
	→ Ndriçimi LED ka defekt ose kapaku i tij është dëmtuar.	▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
Ndarja e ngrirjes nuk mbyllet.*	→ Foleja e kapjes është e mbyllur kur dera është hapur.	▶ Aktivizoni përsëri dorezën.

11.4 Shërbimi për klientin

Fillimisht provoni nëse mund ta eliminoni vetë defektin (shihni 11 Ndihma për klientin) . Nëse nuk ia dilni dot, kontaktoni me shërbimin për klientin.

Adresën e gjeni në broshurën bashkëlidhur „Shërbimi i Liebherr“ ose në faqen e internetit home.liebherr.com/service.

PARALAJMËRIM

Riparim jo profesional!
Lëndime.

- ▶ Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje dhe në kordonin e lidhjes elektrike, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike (shihni 10 Mirëmbajtja) , duhen kryer vetëm nga kujdesi për klientin.
- ▶ Ndërroni kordonin e dëmtuar të lidhjes elektrike vetëm te prodhuesi ose nga shërbimi i tij për klientin ose te një person me kualifikim të ngjashëm.
- ▶ Në pajisjet me spinë frigoriferi, ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.

11.4.1 Kontakti me shërbimin për klientin

Sigurohuni që keni gati informacionet e mëposhtme të pajisjes:

- ❑ Emërtimi i pajisjes (modeli dhe indeksi)
- ❑ Nr. i shërbimit (Shërbimi)
- ❑ Numri i serisë (S-Nr.)

- ▶ Hapni informacionet e pajisjes nëpërmjet ekranit. (shihni Informacioni i pajisjes)

-ose-

- ▶ Merrni informacionet e pajisjes nga etiketa e parametrave. (shihni 11.5 Etiketa e parametrave)

- ▶ Mbani shënim informacionet e pajisjes.
- ▶ Njoftoni shërbimin për klientin: Komunikojini defektin dhe informacionet e pajisjes.
- ▷ Kjo bën të mundur një shërbim të shpejtë dhe të fokusuar.
- ▶ Ndiqni instruksionet e tjera të shërbimit për klientin.

11.5 Etiketa e parametrave

Etiketa e parametrave ndodhet prapa sirtarëve në anën e brendshme të pajisjes.




Fig. 260

(1) Emërtimi i pajisjes
(2) Nr. i shërbimit
(3) Numri i serisë

- ▶ Lexoni informacionet e etiketës së parametrave.

12 Nxjerrja jashtë pune

- ▶ Zbrazni pajisjen.
- ▶ Çaktivizoni HydroBreeze. (shihni Çaktivizimi i HydroBreeze)
- ▶ Fikni pajisjen. (shihni Fikja dhe ndezja e pajisjes)
- ▶ Hiqni spinën elektrike nga priza elektrike.
- ▶ Nëse nevojitet, hiqni fishën e frigoriferit: Nxirrni fishën e frigoriferit nga priza në pajisje dhe njëkohësisht lëvizeni majtas dhe djathtas.
- ▶ Pastroni pajisjen. (shihni 10.11 Pastrimi i pajisjes)
- ▶ Lëreni derën hapur që të mos krijohen erëra të këqija.

13 Hedhja

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Kuptimi i simboleve në pajisje është i njohur.
- ❑ Udhëzimet për mënjanimin janë të njohura. (shihni 1.5 Udhëzime për hedhjen)

13.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin

- ▶ Nxirreni pajisjen jashtë pune. (shihni 12 Nxjerrja jashtë pune)

13.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje nga gazi ftohës dhe vaji që del jashtë!
Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.
- ▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

- ▶ Ndiqni udhëzimet për transportin e pajisjes. (shihni 3.6 Transportimi i pajisjes)
- ▶ Transportoni pajisjen pa e dëmtuar atë.
- ▶ Hidheni pajisjen sipas udhëzimeve.

Scan QR Code and find digital operating and installation instructions.



home.liebherr.com

20260727 7088660-00

Liebherr-Hausgeräte GmbH
Memminger Straße 77-79
88416 Ochsenhausen
Deutschland

Manuali i montimit dhe përdorimit



SQ **Manuali origjinal i përdorimit**

LIEBHERR

Përmbajtja

1 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë..... 3
1.1 Përdorimi i parashikuar..... 3
1.2 Përdorimi i gabuar i parashikueshëm..... 3
1.3 Grupi i përdoruesve..... 3
1.4 Udhëzime paralajmërime - Rreziqet për përdoruesin..... 3
1.5 Defektet, dëmtimet dhe riparimet..... 4
1.6 Udhëzime për hedhjen..... 4
1.7 Konformiteti..... 4
1.8 Klasat e klimës..... 5
1.9 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH..... 5
1.10 Baza e të dhënave EPREL..... 5
1.11 Licencat me burim të hapur..... 5
1.12 Pjesët e këmbimit..... 5
1.13 Nivelet e paralajmërimit..... 5

2 Pajisja në një vështrim të shpejtë..... 5
2.1 Përmbajtja e dërgesës..... 5
2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve..... 5
2.3 SmartDevice..... 6

3 Instalimi dhe lidhja..... 6
3.1 Kushtet e instalimit..... 6
3.2 Përmasat e pajisjes..... 7
3.3 Dimensionet e dollapit..... 7
3.4 Peshat e kanateve të mobilies..... 8
3.5 Sistemi i furnizimit me ujë..... 8
3.6 Transportimi i pajisjes..... 9
3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi..... 9
3.8 Heqja e sigurueses të transportit..... 9
3.9 Shpjegimi i simboleve të përdorura..... 9
3.10 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës..... 10
3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë..... 12
3.12 Instalimi i disa pajisjeve..... 13
3.13 Montimi në dollap..... 13
3.14 Kanatet e mobilieve..... 22
3.15 Pas montimit..... 23
3.16 Lidhja e pajisjes në furnizimin me energji..... 24
3.17 Hedhja e paketimit..... 24

4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe. 24
4.1 Navigimi dhe shpjegimi i simboleve..... 24
4.2 Menytë..... 25
4.3 Modaliteti i qetësisë..... 25

5 Vënia në punë..... 26
5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)..... 26
5.2 Vënia në funksionim e IceMaker..... 26

6 Ruajtja..... 26
6.1 Udhëzime për ruajtjen..... 26
6.2 Dhoma e ngrirjes..... 26
6.3 Kohët e ruajtjes..... 27

7 Kursimi i energjisë..... 27

8 Përdorimi..... 28
8.1 Elementët e komandimit dhe tregues..... 28
8.1.1 Treguesi i statusit..... 28
8.1.2 Simbolet treguese..... 28
8.2 Funksionet e pajisjes..... 28
8.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes..... 28
Fikja dhe ndezja e pajisjes..... 28
Temperatura..... 28
SuperFrost..... 29
PartyMode..... 29
SabbathMode..... 30
EnergySaver..... 30
IceMaker / MaxIce..... 31
Furnizimi me ujë i IceMaker..... 32
TubeClean..... 32
Bllokimi i panelit..... 33
Kujtesa..... 33
Gjuha..... 33
Njësia e temperaturës..... 34
Niveli i dritës së ekranit..... 34
WLAN..... 34
Informacioni i pajisjes..... 35
Software..... 35
Nisja e ciklit të shkrirjes..... 36
Alarmi i derës..... 36
Modaliteti i demonstrimit..... 36
Rikthimi në cilësimet nga fabrika..... 37
8.3 Mesazhet..... 38
8.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve..... 38
8.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve..... 38
8.3.3 Përmbledhje e kujtesave..... 39
8.3.4 Mënjanimi i kujtesave..... 39

9 Pajisjet..... 39
9.1 Sirtarët..... 39
9.2 Rafti me tërheqje me IceTower..... 41
9.3 Pllakat e xhamit..... 42
9.4 IceMaker..... 43
9.5 VarioSpace..... 44
9.6 Pllaka ftohëse..... 44
9.7 Ndarësi fleksibël i sirtarit të akullit..... 44


10 Mirëmbajtja..... 45
10.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje..... 45
10.2 Shkrirja e pajisjes..... 47
10.3 Pastrimi i pajisjes..... 47

11 Ndihma për klientin..... 48
11.1 Të dhënat teknike..... 48
11.2 Zhurmat gjatë punës..... 49
11.3 Defektet teknike..... 49
11.4 Shërbimi për klientin..... 50
11.5 Etiketa e parametrave..... 51

12 Nxjerrja jashtë pune..... 51

13 Hedhja..... 51
13.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin..... 51
13.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike..... 51

Prodhuesi punon në vazhdimësi për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha llojeve dhe modeleve. Për këtë arsye, lutemi në mirëkuptimin tuaj që ne duhet të rezervojmë të drejtën e ndryshimeve në formë, pajisje dhe teknologji.

Simboli	Shpjegimi
	**Lexoni manualin e instruksioneve** Për t'u njohur me të gjitha avantazhet e pajisjes suaj të re, ku lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet në këtë manual instruksionesh.
	**Informacionet plotësuese në internet** Manualin dixhital me informacionet plotësuese dhe në gjuhë të tjera e gjeni në internet nëpërmjet kodit QR në kopertinën e këtij manuali ose duke futur numrin e servisit në adresën **home.liebherr.com/fridge-manuals**. Numrin e servisit e gjeni në etiketën e parametrave:  *Fig.* Shembull ilustrues
	**Kontrolli i pajisjes** Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te kujdesi për klientin.
	**Ndryshimet** Manuali është i vlefshëm për disa modele, kështu që mund të ketë ndryshime. Seksionet që kanë të bëjnë vetëm me pajisje të caktuara janë të shënuara me një yll (*).
	**Udhëzimet e veprimeve dhe rezultatet e veprimeve** Udhëzimet e veprimeve janë të shënuara me një ▶. Rezultatet e veprimeve janë të shënuara me një ▷.
	**Videot** Videot për pajisjet ofrohen në kanalin në YouTube të kompanisë Liebherr-Hausgeräte.

Licencat me burim të hapur:

Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu: **home.liebherr.com/open-source-licences**

Ky informacion për përdoruesin vlen për pajisjet e mëposhtme:

SIFN..	51..
SIFNbsdi	51..

Shënim
Nëse pajisja juaj ka një N në emërtimin e pajisjes, atëherë bëhet fjalë për një pajisje NoFrost.

1 Udhëzimet e përgjithshme të sigurisë

Ruajini me kujdes këto informacione për përdoruesin, për t'i pasur në dispozicion në çdo kohë.

Nëse ia kalojmë pajisjen dikujt tjetër, kalojini pronarit të radhës edhe këto informacione për përdoruesin.

Për ta përdorur pajisjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, lexoni me kujdes këto informacione për përdoruesin përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes. Ndiqni gjithmonë instruksionet që ato përmbajnë, udhëzimet e sigurisë dhe udhëzimet paralajmëruese. Ato janë të rëndësishme, në mënyrë që ta instaloni dhe ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

1.1 Përdorimi i parashikuar

- Kjo pajisje është parashikuar për përdorim në shtëpi dhe në ambiente të ngjashme, si për shembull:
  - Kuzhinat e personelit në dyqane, në zyra dhe ambiente të tjera pune
  - në bujqësi dhe nga vizitorë në hotele, motele dhe strehime të tjera
  - Struktura me fjetje dhe mëngjes
  - në shërbimin katering dhe përdorime të ngjashme në tregtinë me shumicë
- Përdorime të tjera:
  - Të gjitha llojet e tjera të përdorimit konsiderohen të palejuara.

1.2 Përdorimi i gabuar i parashikueshëm

Përdorimet e mëposhtme janë shprehimisht të ndaluara:

- Ruajtja dhe ftohja e:
  - Substancave kimike të paqëndrueshme, që marrin flakë ose irrituese
  - Lëndë me mundësi shpërthyese, si për shembull kanaçe aerosoli me gaz shtytës të djegshëm
  - Medikamenteve, plazmës së gjakut, preparateve laboratorike ose substancave dhe produkteve të ngjashme në bazë të Direktivës 2007/47/KE për pajisjet mjekësore
- Përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese

Përdorimi i gabuar i pajisjes çon në dëmtim ose prishje të ushqimeve të vendosura për ruajtje në frigorifer.

1.3 Grupi i përdoruesve

- Kjo pajisje nuk duhet të përdoret nga personat (duke përfshirë edhe fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo persona me mungesë përvoje dhe njohurish, përveç rastit kur ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes nga një person që përgjigjet për sigurinë e tyre. Fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje për t'u siguruar që të mos luajnë me pajisjen.
- Fëmijët e moshës 3 deri 8 vjeç lejohen të mbushin dhe të zbrazin frigoriferin/ngrirësin.

1.4 Udhëzime paralajmërime - Rreziqet për përdoruesin

- PARALAJMËRIM: Mos i pengoni zgavrat e ajrimit në trupin e pajisjes ose në folenë e montimit.
- PARALAJMËRIM: Për të shpejtuar procesin e shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje tjetër mekanike ose ndonjë mënyrë tjetër përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.
- PARALAJMËRIM: Mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës.

- PARALAJMËRIM: Mos vendosni në punë asnjë pajisje elektrike brenda ndarjes së ftohjes/ngrirjes, të cilat nuk përputhen me mënyrën e ndërtimit të rekomanduar nga prodhuesi.
- PARALAJMËRIM: Kur montoni pajisjen, sigurohuni që kablli i rrjetit të mos ngecë ose mos dëmtohet.
- PARALAJMËRIM: Mos vendosni priza të lëvizshme të shumëfishta ose adaptorë në pjesën e pasme të pajisjes.

Pas montimit me sukses, duhet të jetë ende e mundur ta shkëputni pajisjen nga rrjeti.

- Prizë e arritshme (mbi, nën ose pranë pajisjes)
- Aktivizimi i siguresës në instalimin e godinës, në përputhje me rregullat e instalimit.



PARALAJMËRIM: Lëndë me rrezik djegieje/ zjarri.

Ky simbol ndodhet në kompresor, por mund të jetë i vizatuar edhe në vende të tjera në pajisje. Identifikon rrezikun nga lëndët me rrezik zjarri. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

- Sa më shumë gaz ftohës të ketë në pajisje, aq më e madhe duhet të jetë dhoma ku qëndron pajisja. Në dhomat shumë të vogla mund të krijohet përzierje e ndezshme gaz-ajër, në rast rrjedhjeje të gazit. Dhoma e instalimit duhet të ketë një vëllim minimumi 1 m^3 për çdo 8 g gaz ftohës. Specifikimet për gazin ftohës të pajisjes jepen në etiketën e parametrave, në hapësirën e brendshme të pajisjes.
- Pastroni rregullisht sipërfaqet që mund të kenë kontakt me ushqimet dhe me sistemet e arritshme të shkarkimit të ujit.
- Paketoni në enë/kuti të mbyllur e të pastër mishin ose peshkun e pagatuar. Në këtë mënyrë parandaloni që mishi ose peshku të prekin ushqimet e tjera ose që të pikojnë sipër tyre.
- Nëse frigoriferi/ngrirësi do të qëndrojë bosh për kohë të gjatë, fikeni pajisjen, shkrijeni, pastrojeni dhe lëreni derën hapur për të shmangur formimin e mykut.
- Shmangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me sipërfaqet e ftohta ose ushqimet për ftohje. Për mbrojtjen, përdorni p.sh., doreza.
- Pijet alkoolike ose paketimet e tjera që përmbajnë alkool vendosini në ruajtje të mbyllura në mënyrë hermetike. Alkooli që mund të kenë rrjedhur mund të ndizet nga pjesët elektrike.
- Hapeni derën vetëm për kohë të shkurtra. Në këtë mënyrë shmangni rritjen e temperaturës në brendësi të pajisjes.
- Mos i futni duart midis derës dhe pajisjes gjatë hapjes dhe mbylljes së derës. Gishtat mund të kapen aty.
- PARALAJMËRIM: Kjo pajisje duhet të fiksohet në përputhje me udhëzimin e përdorimit, për të përjashtuar rreziqe nga mungesa e stabilitetit.
- Respektoni udhëzimet për montimin, shtrëngimin, dimensionet e nevojshme dhe lidhjet. (shihni 3 Instalimi dhe lidhja)


Pajisjet me lidhje fikse të ujit:

- PARALAJMËRIM: Lidheni vetëm në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.
- Respektoni vlerat e lidhjes për furnizimin me ujë. (shihni 3 Instalimi dhe lidhja)
- Lidheni pajisjen në furnizimin e ujit të pijshëm vetëm me një komplet të ri tubash. Mos i ripërdorni kompletet e tubave, por hidhini.
  Një komplet tubash gjendet brenda në pajisje.
- Shpëlani sistemin e ujit, nëse nuk është nxjerrë ujë për më shumë se 5 ditë.

1.5 Defektet, dëmtimet dhe riparimet

- Lidhja e rrjetit me spinë frigoriferi:
  Nëse dëmtohet kablli i lidhjes në rrjet të kësaj pajisjeje, duhet të zëvendësohet me një kabël lidhës të veçantë, që mund të merret nga prodhuesi ose shërbimi i tij i klientit. Ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.
- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje lejohen të kryhet vetëm nga shërbimi i klientit ose nga staf tjetër teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Kur ka dëmtime ose defekte në pajisje, hiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën. Kur tërhiqet spina e rrjetit, kapeni gjithmonë nga spina. Mos e tërhiqni nga kablli.

1.6 Udhëzime për hedhjen



Koshi i plehrave me vizë sipër tregon që pajisja nuk mund të hidhet në mbeturinat e paklasifikuara komunale dhe duhet të dërgohet në një pikë grumbullimi të ndarë. Përmban lëndë të vlefshme dhe është e riciklueshme.



Simboli mund të gjendet mbi kompresor. Ai ka të bëjë me vajin në kompresor dhe jep udhëzim për rrezikun e mëposhtëm: **Mund të jetë fatal në rast gëlltitjeje ose futjeje në rrugët e frymëmarrjes.** Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Në gjendje pune normale nuk ekziston asnjë rrezik.



Kjo etiketë ngjitëse ose një etiketë e ngjashme mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ajo tregon se te dera dhe/ose tek trupi ka panele izoluese me vakuum (VIP) ose panele me perlit. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e hiqni etiketën ngjitëse.

- Për këtë arsye, hedhja e pajisjeve të nxjerra jashtë përdorimit duhet kryer në mënyrë të rregullt dhe profesionale, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme lokale. Mos dëmtoni qarkun e gazit ftohës gjatë transportit të hedhjes së pajisjes së nxjerrë jashtë përdorimit, në mënyrë që gazi ftohës (shihni specifikimet në etiketën e parametrave) dhe vaji të mos derdhen në mënyrë të pakontrolluar.
- Ju lutemi, kini parasysh që fshirja e të dhënave personale, nëse janë të pranishme, është detyrë e klientit.
- Për Gjermaninë: Në pikat lokale të riciklimit / mbledhjes së materialeve të ripërdorshme, pajisja mund të hidhet pa pagesë në koshat e klasës 1. Në rastin e blerjes së një frigoriferi ftohës / ngrirës dhe një sipërfaqeje dyqani > 400 m^2, pajisja e vjetër mund të kthehet edhe në këtë dyqan.
- BE: Ju lutemi, informohuni pranë autoriteteve lokale rreth mundësive të mënjanimit të pajisjeve të vjetra.

1.7 Konformiteti

Qarku i gazit ftohës është testuar për rrjedhje. Në gjendje të montuar, pajisja është në përputhje me dispozitat përkatëse të sigurisë dhe me rregulloret përkatëse.

Për tregun e BE-së:	Pajisja është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.
Për tregun në GB:	Pajisja është në përputhje me Radio Equipment Regulations 2017 SI 2017 No. 1206.

Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: www.Liebherr.com

1.8 Klasat e klimës

Pajisja është projektuar sipas klasave të klimës për përdorimin në temperatura mjedisi të kufizuara. Klasa përkatëse e klimës për pajisjen tuaj është e stampuar në etiketën e parametrave.

Shënim

▶ Për të garantuar një përdorim pa probleme të pajisjes, respektoni temperaturat e dhëna të ambientit.

Klasa e klimës	për temperaturat e ambientit nga
SN	10 °C deri në 32 °C
N	16 °C deri në 32 °C
ST	16 °C deri në 38 °C
T	16 °C deri në 43 °C
SN-ST	10 °C deri në 38 °C
SN-T	10 °C deri në 43 °C

1.9 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH

- Në lidhjen në vijim mund të kontrolloni nëse pajisja juaj përmban substanca SVHC, në kuptim të rregullores REACH:
  https://go.liebherr.com/z3eewm

1.10 Baza e të dhënave EPREL

- Nga data 1 mars 2021, informacionet për etiketimin e konsumit të energjisë dhe për kërkesat e dizajnit ekologjik do të disponohen në bazën evropiane të të dhënave të produkteve (EPREL). Në lidhjen e mëposhtme https://eprel.ec.europa.eu/ shkoni te baza e të dhënave të produkteve. Këtu kërkohet që të vendosni emërtimin e modelit. Emërtimin e modelit e gjeni në etiketën e parametrave të produktit.

1.11 Licencat me burim të hapur

- Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu:
  home.liebherr.com/open-source-licences

1.12 Pjesët e këmbimit

- Disponueshmëria e pjesëve të këmbimit për pjesët funksionale dhe pjesët me kapacitet ruajtës të pajimit është 15 vjet.

1.13 Nivelet e paralajmërimit

RREZIK	Identifikon një situatë të rrezikshme të drejtpërdrejtë, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
PARALAJMËRIM	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
VINI RE	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë lëndime të lehta ose mesatare fizike, nëse nuk mënjanohen.
KUJDES	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë dëme materiale, nëse nuk mënjanohet.
Shënim	Identifikon udhëzimet dhe këshillat e dobishme.

2 Pajisja në një vështrim të shpejtë

2.1 Përmbajtja e dërgesës

Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te shërbimi për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Dërgesa përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Pajisje inkaso
- Pajisjet (në varësi nga modeli)
- Materiali i montimit (në varësi nga modeli)
- „Quick Start Guide“
- „Installation Guide“*
- Broshura e shërbimit

2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve




Fig. 1 Shembull ilustrues

(1) Elementët e komandimit
(2) NoFrost
(6) IceTower
(7) Etiketa e parametrave

(3) Sirtari me anim
(4) Sirtari
(5) IceMaker
(8) VarioSpace
(9) Këmbët me rregullim

2.3 SmartDevice

SmartDevice është zgjidhja e lidhjes në rrjet për frigoriferin tuaj ngrirës.

Nëse pajisja juaj mbështet SmartDevice ose është përgatitur për të, ju mund ta lidhni pajisjen shpejt dhe thjeshtë në rrjetin tuaj WLAN. Me aplikacionin SmartDevice mund ta komandoni pajisjen tuaj nga një pajisje fundore celulare. Në aplikacionin SmartDevice keni në dispozicion funksione shtesë dhe mundësi rregullimi.

Pajisja që mbështet SmartDevice:	Pajisja juaj mbështet SmartDevice. Për ta lidhur pajisjen tuaj me rrjetin WLAN, duhet që të shkarkoni aplikacionin SmartDevice.
Informacione të tjera për SmartDevice:	**smartdevice.liebherr.com**
Shkarkoni aplikacionin SmartDevice:	Pas instalimit dhe konfigurimit të aplikacionit SmartDevice mund ta lidhni pajisjen tuaj me ndihmën e aplikacionit SmartDevice dhe të funksionit të pajisjes WLAN (shihni WLAN) .

Shënim
Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

3 Instalimi dhe lidhja

3.1 Kushtet e instalimit

Kushtet e instalimit janë vendosur për të garantuar që mund ta përdorni pajisjen tuaj në mënyrë të sigurt, efikase dhe pa probleme.

- Respektoni udhëzimet e sigurisë.
- Bëni kujdes vendin e instalimit dhe pozicionin në dhomë.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga instalimi i pasaktë!
Kur një kordon elektrik ose spinë prek pjesën e pasme e pajisjes, ekziston mundësia që dridhjet e pajisjes të dëmtojnë kordonin elektrik ose spinën dhe në këtë mënyrë të shkaktohet lidhje e shkurtër.

▶ Bëni kujdes që kur të instaloni pajisjen të mos bllokoni asnjë kordon elektrik poshtë pajisjes.
▶ Instalojeni pajisjen në mënyrë të tillë që të mos prekë me asnjë spinë ose kordon elektrik.
▶ Mos lidhni pajisje të tjera në priza elektrike që ndodhen pas pjesës së pasme të pajisjes.
▶ **Mos** vendosni dhe mos përdorni priza me disa dalje ose priza bashkuese me shumë priza dhe pajisje të tjera elektronike (si për shembull transformatori i ndriçimit halogjen) në anën e pasme të pajisjeve.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga lagështia!
Kur pjesët përçuese të energjisë elektrike ose kordoni i lidhjes elektrike lagen, kjo mund të shkaktojë lidhje të shkurtër.

▶ Pajisja është projektuar për përdorim në ambiente të mbyllura. Mos e vini në punë pajisjen në ambient të jashtëm dhe në vende ku spërkatet nga uji.

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje nga gazi ftohës dhe vaji që del jashtë!
Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.

▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

3.1.1 Vendi i instalimit

- Instalojeni dhe përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
- Pajisja lejohet të vihet në punë vetëm në gjendje të montuar.
- Kur pajisja instalohet në një ambient me shumë lagështi, në anët e jashtme të pajisjes mund të formohet ujë nga kondensimi.
  Kujdesuni gjithmonë për ajrimin dhe ventilimin e mirë në vendin e instalimit.
- Sa më shumë gaz ftohës të ketë në pajisje, aq më e madhe duhet të jetë dhoma ku qëndron pajisja. Në dhomat shumë të vogla mund të krijohet përzierje e ndezshme gaz-ajër, në rast rrjedhjeje të gazit. Dhoma e instalimit duhet të ketë një vëllim minimumi 1 m^3 për çdo 8 g gaz ftohës. Specifikimet për gazin ftohës të pajisjes jepen në etiketën e parametrave, në hapësirën e brendshme të pajisjes.
- Dyshemeja në vendin e qëndrimit duhet të jetë e drejtë dhe e niveluar.

3.1.2 Pozicioni në dhomë

- Mos e montoni pajisjen as në një vend në rrezet direkte të diellit, as pranë sistemit të ngrohjes apo të ngjashme.
- Ju mund ta montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë.
- Kur e montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë, konsumi i energjisë mund të rritet paksa. Kjo varet nga kohëzgjatja e përdorimit dhe nga intensiteti i përdorimit të furrës.
- Montoni pajisjen vetëm në një mobilie që është e fortë.
- Nuk lejohet përdorimi në ambiente potencialisht shpërthyese.

3.2 Përmasat e pajisjes




Fig. 2

IFN..(i) 35..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	712

Lartësia e dollapit 720 - Pajisjet me një derë

IFN..(i) 39.. / IR..(i) 39.. / SIBa20i 3905 / SIFN..i 39..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	872

Lartësia e dollapit 880 - Pajisjet me një derë

IR(B)..(i) 41.. / IRBbsbi 4170 / SIFN..i 41..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1213

Lartësia e dollapit 1220 - Pajisjet me një derë

IR(B)..(i) 45.. / IRBbsbi 4570 / SIFN..i 45..	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1395

Lartësia e dollapit 1400 - Pajisjet me një derë

IR(B)(P)..(i) 51.. / IRD..i 51.. / IRBbsci 5170 / IRBbsci 5171 / IRBPbsci 5170 / IKB 51Vc50i / IKB 51Vc51i / IK 51Ve00 / IK 51Ve01 / IK 51Vd00 / SIFN..(i) 51.. / SIFNbsdi 51.. / IK(B).. 1780 / IK(B).. 1784 / SIGN 51Vd28	
A (mm)	559
B (mm)	546
C (mm)	1770

Lartësia e dollapit 1780 - Pajisjet me një derë

3.3 Dimensionet e dollapit




Fig. 3 ***(K):*** *maks. 2100 mm*

Në pajisjet me lidhje fikse të ujit, mbani parasysh informacionet e mëposhtme:

- Sistemi i furnizimit me ujë (shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë)
- Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë (shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë)

IFN..(i) 35..	
F (mm)	714 deri në 730
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IFN..(i) 39.. / IR..(i) 39.. / SIBa20i 3905 / SIFN..i 39..	
F (mm)	874 deri në 890
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IR(B)..(i) 41.. / IRBbsbi 4170 / SIFN..i 41..	
F (mm)	1216 deri në 1236

IR(B)..(i) 41.. / IRBbsbi 4170 / SIFN..i 41..	
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IR(B)..(i) 45.. / IRBbsbi 4570 / SIFN..i 45..	
F (mm)	1397 deri në 1413
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

IC(B)(N)..(i) 51.. / ICBNbsci 5173 / IKG 51Ve03 / IKGN 51Vc03 / ICNbsci 5173 / IKGN 51Ve03 / IKGBN 51Vd23i / IR(B)(P)..(i) 51.. / IRD..i 51.. / IRBbsci 5170 / IRBbsci 5171 / IRBPbsci 5170 / IKB 51Vc50i / IKB 51Vc51i / IK 51Vd00 / IK 51Ve00 / IK 51Ve01 / IK(B).. 1780 / IK(B).. 1784 / IKGNc 1783 / SICN..i 51.. / SIFN..(i) 51.. / SIFNbsdi 51.. / SIGN 51Vd28 / IC(B)Ndx 5173	
F (mm)	1772 deri në 1788
G (mm)	560 deri në 570
H (mm)	min. 550, këshillohet 560
J (mm)	min. 500
L (mm)	maks. 19

Konsumi i deklaruar i energjisë është përcaktuar me një mobilie kuzhine me thellësi 560 mm. Pajisja është plotësisht funksionale edhe në një dollap kuzhine me thellësi 550 mm, por ka një konsum energjie paksa më të lartë.

- ▶ Kontrolloni trashësinë e faqes së mobilies ngjitur: Ajo duhet të jetë minimumi 16 mm .
- ▶ Montoni pajisjen vetëm në një mobilie kuzhine që është e qëndrueshme dhe e fortë. Siguroni mobilien kundër përmbysjes.
- ▶ Niveloni mobilien e kuzhinës me një nivelues me lëng dhe vizore skuadër dhe rregulloni lartësinë duke futur diçka poshtë saj, nëse nevojitet.
- ▶ Sigurohuni që dyshemeja dhe faqet anësore të mobilies janë në kënd të drejtë me njëra-tjetrën.

3.3.1 Kërkesat e ajrimit

KUJDES
Vrimat e ajrimit të mbuluara!
Dëmtime. Pajisja mund të mbinxehet, gjë e cila shkurton jetëgjatësinë e pjesëve të ndryshme të pajisjes dhe mund të çojë në kufizime të funksionimit.

- ▶ Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin.
- ▶ Mbani gjithmonë të lira vrimat ose rrjetën e ajrimit në trupin e pajisjes dhe në mobilien e kuzhinës (pajisja inkaso).
- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.

Respektoni patjetër seksionin tërthor të ajrimit:

- Thellësia e hapësirës së ventilimit në faqen e pasme të mobilies duhet të jetë minimumi 38 mm.
- Për seksionet tërthore të ajrimit dhe ventilimit në bazamentin e mobilies dhe modifikimin e mobilies lart, nevojitet minimumi 200 cm^2.
- Parimi i përgjithshëm është: Sa më i madh seksioni tërthor i ajrimit, aq më shumë energji kursen pajisja në punën e saj.

Për funksionimin e pajisjes nevojitet një hapësirë e mjaftueshme për ajrimin dhe ventilimin. Rrjetat e ajrimit të parashikuara nga fabrika garantojnë një seksion tërthor ajrimi efektiv në pajisje prej 200 cm^2. Nëse i zëvendësoni rrjetat e ajrimit me një kapak mbulues, duhet që ky i fundit të ketë të paktën një seksion tërthor ajrimi të barabartë ose më të madh sesa rrjeta e ajrimit e prodhuesit.

3.4 Peshat e kanateve të mobilies

KUJDES
Rrezik dëmtimi për shkak të derës së rëndë të mobilies!
Nëse dera e mobilies është shumë e rëndë, nuk përjashtohet mundësia e dëmtimeve të menteshave dhe e problemeve në funksionim si rezultat i këtyre dëmtimeve.

- ▶ Përpara montimit të derës së mobilies sigurohuni që nuk kapërcehet pesha e lejuar e derës së mobilies.

Lartësia e dollapit (mm)	Pesha maksimale e derës së mobilies (kg)
720	16
880	16
1020	13
1220	19
1400	21
1580	22
1780	26

Frigoriferët ftohës dhe ngrirës me një derë

3.5 Sistemi i furnizimit me ujë

Nëse pajisja juaj është e pajisur me një lidhje fikse të ujit, brenda në pajisje do të gjeni edhe tubin përkatës.

Shënim
Ju mund të blini si aksesor edhe një tub me gjatësi tjetër.

Përmbledhje e dimensioneve të sistemit të furnizimit me ujë:	(shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë)
Kërkesat për presionin e ujit:	(shihni 3.5 Sistemi i furnizimit me ujë)
Realizimi i sistemit të furnizimit me ujë:	(shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë)

3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë




Fig. 4

(a) Gjatësia maksimale në dispozicion e tubit
(b) Gjatësia maksimale në dispozicion e tubit
(c) Distanca e elektrovalvulës nga toka
(M) Elektrovalvula

a	b	c
~ 1200 mm	~ 1200 mm	~ 55 mm

3.5.2 Presioni i ujit

Linja e sistemit të furnizimit me ujë dhe elektrovalvula e pajisjes janë të përshtatshme për një presion uji deri në 1 MPa (10 bar).

Për të garantuar një funksionim pa probleme të pajisjes (sasia e qarkullimit, madhësia e kubave të akullit, niveli i zhurmës), respektoni presionin e ujit më poshtë:

Presioni i ujit:	
bar	MPa
1,5 deri në 6,2	0,15 deri në 0,62

Nëse presioni është më i lartë se 6,2 bar:
▶ Instaloni një reduktor presioni.
▶ Realizoni sistemin e furnizimit me ujë. (shihni 3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë)

3.6 Transportimi i pajisjes

3.6.1 Transportimi i pajisjes për vënien e parë në punë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pajisja është e paketuar.
❑ Pajisja qëndron vertikalisht.

▶ Transportojeni pajisjen me dy persona.
▶ Shpaketoni pajisjen. (shihni 3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi)

3.6.2 Transportimi i pajisjes pas vënies së parë në punë

Ndiqni udhëzimet e mëposhtme, nëse doni ta transportoni sërish pajisjen pas vënies së parë në punë ose nëse doni ta zhvendosni.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pajisja është boshatisur.
❑ Pajisja qëndron vertikalisht.
❑ Pajisja me derë (dyer): Dera është e sigurt kundër hapjes së padëshiruar.
❑ Pajisja me kosh me tërheqje: Koshi me tërheqje është i siguruar kundër hapjes së padëshiruar.
❑ Pajisja është e çmontuar.

▶ Transportojeni pajisjen me dy persona.

3.7 Nxjerrja e pajisjes nga paketimi

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga lëvizja e pajisjes!
Kur e lëvizni pajisjen në dysheme pa mbrojtje, pajisja mund të dëmtojë dyshemenë.
▶ Mbulojeni dyshemenë mjaftueshëm përpara se të hiqni paketimin e pajisjes.


▶ Kontrolloni pajisjen dhe paketimin: Nëse dyshoni për dëmtime transporti, kontaktoni furnizuesin para lidhjes së pajisjes.

KUJDES
Dëme materiale nga objektet me majtë ose të mprehta!
Nëse përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues, mund të dëmtoni pajisjen.
▶ Mos përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues.

▶ Hiqni materialet paketuese.

3.8 Heqja e sigurueses të transportit

▶ Hiqni siguruesen e transportit në derën e pajisjes.



*

3.9 Shpjegimi i simboleve të përdorura

	Në këtë hap të veprimit ekziston rrezik lëndimi! Ndiqni këto udhëzime të sigurisë!
	Instruksionet janë të vlefshme për disa modele. Kryeni këtë hap vetëm kur ato kanë lidhje me pajisjen tuaj.
	Për montimin ndiqni përshkrimin e hollësishëm në pjesën e tekstit të instruksioneve.
	Seksioni është i vlefshëm ose për pajisjet me një derë, ose për pajisjet me dy dyer.
	Zgjidhni midis alternativave: Pajisjen me hapje nga e djathta ose pajisjen me hapje nga e majta.
	Hap montimi i nevojshëm te IceMaker dhe / ose InfinitySpring.
	Vidat vetëm duhen liruar ose duhen tërhequr pak.
	Shtrëngoni fort vidat.
	Kontrolloni nëse hapi vijues i punës është i nevojshëm për modelin tuaj.
	Kontrolloni montimin e duhur / qëndrimin e duhur të pjesëve të përdorura.

	Bëni matje duke i krahasuar me dimensionet e dhëna dhe bëni korrigjime kur nevojitet.
	Vegla e punës për montimin: Metër shirit
	Vegla e punës për montimin: Kaçavidë elektrike dhe instalimi Për arritjen më të lehtë të vidave, rekomandohet përdorimi i një maje më të gjatë.
	Vegla e punës për montimin: Nivelues me lëng
	Vegla e punës për montimin: Çelës pirun me SW 7 dhe SW 10
	Për këtë hap të punës nevojiten dy persona.
	Hapi i punës kryhet në vendin e shënuar të pajisjes.
	Vegla ndihmëse për montimin: Spango
	Vegla ndihmëse për montimin: Përmasa këndore
	Vegla ndihmëse për montimin: Kaçavidë
	Vegla ndihmëse për montimin: Gërshërët
	Vegla ndihmëse për montimin: Laps shënimi, që fshihet
	Ambalazhi: Hiqni komponentët
	Hidhni sipas rregullave pjesët që nuk nevojiten më.

3.10 Ndërrimi i krahut të hapjes së derës

Veglat e punës



Fig. 5

KUJDES
Pjesë që përçojnë energji elektrike!
Dëmtim i pjesëve elektrike.
▶ Hiqni spinën elektrike nga priza përpara se të kryhet ndërrimi i krahut të hapjes së derës.




Fig. 6

▶ Heqja e amortizatorit të mbylljes: Shkëputni amortizatorin e mbylljes nga koka sferike (1), lironi vidat e mbajtëses (2). Çmontoni kokat sferike me kaçavidë (3).

Shënim
Kur amortizatori i mbylljes ndodhet pikërisht sipër dyshemesë, ju mund ta hiqni kokën sferike vetëm kur dera është e çmontuar.




Fig. 7

▶ Hiqni kapakët mbulues.

Shënim
Kur të hiqni kapakët mbulues bëni kujdes që të mos gërvishtet sipërfaqja.




Fig. 8

▶ Lironi vidat në **të gjitha** menteshat, mos i hiqni fare.




*Fig. 9 **

▶ Heqja e derës: Shtyjeni derën nga përpara dhe më pas nga jashtë, nxirreni nga varja dhe vëreni mënjanë.




Fig. 10

▶ Lironi të gjitha menteshat dhe vërini mënjanë bashkë me vidat.




Fig. 11

▶ Lironi profilin lart dhe poshtë nga dera dhe ndërrojini krahët. Profilit i duhet ndërruar krahu në mënyrë që të mbërthehen menteshat.




Fig. 12

▶ Shkëmbeni vidat për mbërthimin e menteshave. Pas ndërrimit të krahut mos i mbërtheni vidat fort, sepse më vonë duhen varur menteshat.




Fig. 13

▶ Shkëmbeni profilin e mbërthimit në anën tjetër.




Fig. 14

▶ Ktheni të gjitha mentesha në anën e kundërt duke i rrotulluar me 180° dhe mbërthejini fort me vidat.




*Fig. 15 **

▶ Montimi sërish i derës: Varni derën me menteshat dhe shtrëngoni vidat.




Fig. 16

▶ Montimi sërish i amortizatorit të mbylljes: Vidhosni kokat sferike (1), shtrëngoni mbajtëset (2) dhe futni amortizatorin e mbylljes në kokën sferike.

▶ Kontrolloni të gjitha vidat dhe shtrëngojini përsëri nëse nevojitet.




Fig. 17

▶ Montoni sërish kapakun mbulues poshtë dhe në mes. Pjesën e mbetur të kapakëve mbulues montojini përsëri vetëm pas instalimit në mobilie.

3.11 Lidhja e pajisjes në furnizimin me ujë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Dimensionet për lidhjen në furnizimin me ujë njihen dhe janë respektuar. (shihni 3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë)
- ❑ Është respektuar presioni i ujit. (shihni 3.5.1 Dimensionet e sistemit të furnizimit me ujë)
- ❑ Furnizimi me ujë i pajisjes kryhet përmes linjës së ujit të freskët që ruan presionin e punës dhe është i lidhur në furnizimin me ujë të pijshëm.
- ❑ Të gjitha pajisjet dhe aksesorët që përdoren për furnizimin me ujë janë në përputhje me rregullat në fuqi të shtetit përkatës.
- ❑ Faqja e pasme e pajisjes është e arritshme, në mënyrë që të lidhni pajisjen në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.
- ❑ Është përdorur tubi i ofruar. Tubat e vjetër janë hedhur.
- ❑ Në rakordin e lidhjes së tubit ndodhet filtri rrjetë me guarnicionin.
- ❑ Midis linjës së tubit dhe linjës së ujit të shtëpisë ndodhet një saraçineskë uji, që të ndërpritni furnizimi me ujë, nëse nevojitet.
- ❑ Saraçineska e ujit ndodhet jashtë zonës së faqes së pasme të pajisjes dhe është lehtësisht e arritshme. Në këtë mënyrë, ju mund ta shtyni pajisjen brenda në dollapin e mobilies sa më thellë dhe në rast nevoje mund ta mbyllni shpejt saraçineskën e ujit.

PARALAJMËRIM

Rrezik i goditjes elektrike nga uji!

▶ Përpara lidhjes në tubin e ujit: Shkëputni pajisjen nga priza elektrike.

▶ Përpara lidhjes në linjën e hyrjes së ujit: Mbyllni furnizimin me ujë.

▶ Sigurohuni që ta lidhni pajisjen në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm vetëm me staf teknik të kualifikuar.

PARALAJMËRIM

Rrezik helmimi nga uji i papastër!

▶ Lidheni vetëm në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm.

3.11.1 Lidhja e tubit




Fig. 18

*** Në varësi nga modeli dhe pajisja**




Fig. 18

(1) Dadoja
(2) Skaji i kthyer i tubit
(3) Mbajtësja
(4) Skaji i drejtë i tubit
(5) Saraçineska e ujit
(6) Elektrovalvula: Elektrovalvula është poshtë në faqen e pasme të pajisjes. Ajo ka një filetë lidhjeje R3/4.

KUJDES
Rrezik dëmtimi për shkak të montimit të gabuar!
▶ Mos dëmtoni ose mos përthyeni tubin gjatë montimit.
▶ Mos dëmtoni ose mos përthyeni tubin gjatë instalimit në dollapin e mobilies.

Lidhja e tubit në pajisje:
▶ Poziciononi skajin e kthyer të tubit *Fig. 18 (2)* horizontalisht në mbajtëse *Fig. 18 (3)* dhe mbajeni fort.
▶ Mbërtheni me dorë dadon *Fig. 18 (1)* në filetë, derisa të arrihet një qëndrim i sigurt dhe i fiksuar.
▷ Tubi është lidhur në pajisje.

Lidhja e tubit në saraçineskën e ujit:
▶ Lidhni skajin e drejtë të tubit *Fig. 18 (4)* në saraçineskën e ujit *Fig. 18 (5)*.
▷ Tubi është lidhur në saraçineskën e ujit.

3.11.2 Kontrolli i sistemit të furnizimit me ujë

Përpara se ta instaloni pajisjen plotësisht brenda dollapit të mobilies, Liebherr rekomandon që të kryeni një kontroll të hermeticitetit të sistemit të ujit.
▶ Hapni ngadalë saraçineskën e ujit.
▶ Kontrolloni nëse tubat, furnizimi me ujë dhe pikat e lidhjes kanë rrjedhje.
▷ Hermeticiteti i sistemit të furnizimit me ujë është kontrolluar.
▷ Sistemi i ujit është hermetik: Ju mund ta instaloni pajisjen plotësisht brenda dollapit të mobilies.

Shënim
IceMaker: Përpara përdorimit të parë duhet që ta pastroni IceMaker. (shihni Quick Start Guide ose manualin e përdorimit)

3.12 Instalimi i disa pajisjeve

Pajisjet janë projektuar për lloje të ndryshme instalimi. Nëse dëshironi që të instaloni disa pajisje pranë ose sipër njëra-tjetrës, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Instaloni pranë ose sipër njëra-tjetrës vetëm pajisje që janë të projektuara për këtë qëllim.
❑ Ndiqni shënimet dhe tabelën e mëposhtme.

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga uji i kondensimit!
▶ Mos e instaloni pajisjen direkt ngjitur me një frigorifer tjetër ftohës/ngrirës.

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga uji i kondensimit!
▶ Mos e instaloni pajisjen direkt mbi një pajisje tjetër ftohëse/ngrirëse.

Modeli	Lloji i instalimit
Të gjitha modelet	Më vete
Modelet, emërtimi i të cilave fillon me **S...**.	Side-by-Side (SBS)
Modelet me lartësi maksimale dollapi deri në 880 mm dhe me kapak me ngrohje mund të instalohen „sipër njëra-tjetrës“. Pajisja e sipërme: deri në lartësi dollapi maksimale 140 mm	Mbi njëra-tjetrën

Modelet dhe lloji i tyre i instalimit




Fig. 19

Montoni secilën pajisje në një dollap mobilieje të veçantë.

3.13 Montimi në dollap

Montimi i pajisjes në dollap bëhet sipas këtyre hapave kryesorë:
- Përgatitni veglat e punës.
- Kontrolloni pjesët e montimit në paketim.
- Përgatitni dollapin.
- Përgatitni sistemin e furnizimit me ujë.
- Përgatitni lidhjen e rrjetit.
- Përgatitni pajisjen.
- Niveloni pajisjen.
- Fiksoni pajisjen.
- Vendosni shinën niveluese.
- Montoni faqen ballore të mobilies.
- Niveloni faqen ballore të mobilies.
- Kontrolloni montimin.
- Vendosni kapakun mbulues.

3.13.1 Përgatitja e veglave të punës




Fig. 20

3.13.2 Kontrollimi i pjesëve të montimit në paketim




Fig. 21




*Fig. 22 **




Fig. 23




*Fig. 24 **




*Fig. 25 **




Fig. 26




*Fig. 27 **

*** Në varësi nga modeli dhe pajisja**




Fig. 28




*Fig. 29 **




Fig. 30




*Fig. 31 **




*Fig. 32 **

3.13.3 Përgatitja e dollapit




Fig. 33

▶ Ndani ndihmësen e montimit në pjesën me vrima të vogla.




Fig. 34

KUJDES
Thellësi e gabuar montimi e pajisjes.
▶ Kur montoni pajisjen: Përdorni ndihmësen e montimit.

▶ Vidhosni ndihmësen e montimit djathtas dhe majtas në bazamentin e dollapit.
▷ Kllapat e montimit janë e vendosur në nivel me faqen anësore të mobilies.

3.13.4 Përgatitja e sistemit të furnizimit me ujë




Fig. 35

▶ Instalojeni sistemin e furnizimit me ujë sipas udhëzimeve në udhëzuesin e përdorimit.

3.13.5 Përgatitja e lidhjes së rrjetit




Fig. 36

▶ Merrni kordonin e lidhjes elektrike nga qesja e aksesorëve.
▶ Futni fishën e frigoriferit të kordonit të lidhjes elektrike plotësisht në prizën në pajisje, në pjesën e pasme të pajisjes.
▷ Foleja e kabllit të rrymës është fiksuar mirë në spinën e pajisjes.




Fig. 37

▶ Shtrini kabllin e lidhjes në rrjet drejt një prize lehtësisht të arritshme, me ndihmën e kordonit.
▷ Kablli i lidhjes në rrjet mund të futet në prizë pas montimit të pajisjes.

3.13.6 Përgatitja e pajisjes




Fig. 38

▶ Futni panelin balancues në pjesën e sipërme të pajisjes.
▷ Paneli mund të zhvendoset nga të dyja anët.




Fig. 39

Kur kanatet e kuzhinës kanë doreza mobiliesh:

▶ Montoni një çift të profilit këndor mbërthyes anësor në lartësinë e dorezave të ardhshme të derës së mobilies.




Fig. 40

Montoni çiftin tjetër të profilit të mbërthimit në dyert e mëdha.

▶ Montoni profilin fiksues poshtë traversës fiksuese.




Fig. 41

▶ Pas montimit palosni kapakët mbulues mbi profilin e mbërthimit.

PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga lidhja e shkurtër!

▶ Kur shtyni pajisjen brenda në dollap: Mos përthyeni, mos kapni ose mos dëmtoni kordonin e lidhjes elektrike.
▶ Mos e vini në punë pajisjen me kordon elektrik të dëmtuar.




Fig. 42

▶ Futni pajisjen në 2/3 e saj brenda në dollapin e mobilies.




Fig. 43




Fig. 44

▶ Kontrolloni nëse faqja anësore e mobilies ka trashësi 16 mm ose 19 mm.




Fig. 45




Fig. 46




*Fig. 47 **

▶ Faqja e mobilies 16 mm: Futeni pjesën distancuese në gjitha menteshat.

-ose-

▶ Faqja e mobilies 19 mm: mos e përdorni pjesën distancuese.




Fig. 48

▶ Hapni derën.
▶ Zbërtheni kapakun mbulues lart majtas.
▶ Hiqni kapakun mbulues.




Fig. 49

▶ Shtrëngoni paksa profilin e mbërthimit.
▷ Profili mund të zhvendoset.
▶ Mbyllni derën.




Fig. 50

▶ Futeni pajisjen plotësisht brenda në dollapin e mobilies.

3.13.7 Nivelimi i pajisjes




Fig. 51

▶ Poziciononi këmbët me rregullim në vrimat e ndihmëses së montimit.
▶ Hapni derën.




Fig. 52

▶ Lironi ndaluesen e ndihmëses së montimit duke e lëvizur.
▶ Nëse nevojitet, shkëputeni me pincë.




Fig. 53

▶ Kontrolloni nëse pajisja qëndron rrafsh në dollapin e mobilies.
▷ Profili i mbërthimit lart majtas qëndron i fiksuar në faqen anësore të dollapit të mobilies.




Fig. 54

Niveloni pjerrësinë e pajisjes nëpërmjet këmbëve me rregullim.
▶ Zbërtheni këmbën me rregullim:
▷ Pajisja anon mbrapa.
▶ Mbërtheni këmbën me rregullim:
▷ Pajisja anon përpara.




Fig. 55

▶ Shtypeni profilin e mbërthimit në faqen anësore të dollapit të mobilies.
▶ Fiksoni vidat.




Fig. 56

▶ Shkëputni ndaluesen nga profili.
▶ Hidhni ndaluesen.
▶ Mbyllni derën.
▶ Niveloni pajisjen nëpërmjet këmbëve me rregullim.
Fig. 51 ()




*Fig. 57 **

▷ Faqja anësore e mobilies me trashësi 16 mm: pjesët distancuese qëndrojnë në faqen anësore të dollapit në anën e menteshës. *()*




*Fig. 58 **

▷ Muret anësore të mobilies me trashësi 19 mm: buza e përparme e menteshës është niveluar në raport me anën e përparme të faqes anësore të mobilies. *()*

3.13.8 Fiksimi i pajisjes




*Fig. 59 **

▶ Hapni derën.
▶ Mbërtheni me vida pajisjen në anën e menteshave.

3.13.9 Vendosja e shinave niveluese

Në lartësi dollapi nga 1400 mm, ju duhet që të montoni shina nivelimi poshtë pajisjes. Shinat e nivelimit **zvogëlojnë nivelin e zhurmës**. Në lartësitë e dollapit nga 1400 mm, në qesen e aksesorëve ofrohen dy shina nivelimi dhe një dorezë montimi.




Fig. 60

▶ Futni dorezën e montimit *Fig. 60 (1)* në shinën e nivelimit *Fig. 60 (2)*.




Fig. 61




Fig. 62

▶ Futni shinën e nivelimit brenda në udhëzuesin në bazamentin e pajisjes dhe shtyjeni deri në fund.
▶ Hiqni dorezën e montimit dhe futeni në shinën e dytë të nivelimit.
▶ Futni shinën e dytë të nivelimit brenda në udhëzuesin në bazamentin e pajisjes dhe shtyjeni deri në fund.
▶ Hiqni dorezën e montimit.
▷ Pajisja është niveluar.

3.13.10 Montimi i faqes ballore të mobilies




Fig. 63

▶ Mbyllni derën.
▶ Kontrolloni distancën midis buzës së sipërme të derës së pajisjes dhe mbajtëses së traversës fiksuese.
▷ Distanca midis buzës së sipërme të derës së pajisjes dhe traversës fiksuese është 8 mm.




Fig. 64

▶ Ngrini lart ndihmëset e montimit.




Fig. 65

▷ Buza e poshtme ndaluese e ndihmëses së montimit është në lartësinë e buzës së sipërmes të derës për montim.




Fig. 66

▶ Lironi dadot.
▶ Hiqni traversën fiksuese.




Fig. 67

▶ Varni traversën fiksuese në anën e brendshme të derës së mobilies.

▷ Traversa fiksuese është niveluar në mes.




Fig. 68

▶ Mbërtheni traversën fiksuese me 6 vida.




Fig. 69

▶ Nxirrni jashtë ndihmëset e montimit.

▶ Shtyni duke rrotulluar ndihmëset e afërta të montimit në vrimën e futjes së traversës fiksuese.




Fig. 70

▶ Futni lart kapakun mbulues në anën e dorezës së derës në traversën fiksuese.*

▶ Mbërtheni kapakun mbulues në traversën e mbërthimit.




Fig. 71

▶ Vendosni derën e mobilies.*

▶ Vidhosni dadot lirshëm tek bulonat.

3.13.11 Nivelimi i faqes ballore të mobilies




*Fig. 72 **

Niveloni derën e mobilies në drejtimin X dhe Y nëpërmjet vidave:*

▶ Lironi dadot.

▶ Niveli i derës së mobilies në drejtimin X.

▶ Rrotulloni vidat lart ose poshtë.

▶ Niveli i derës së mobilies në drejtimin Y.




Fig. 73

▶ Shtrëngoni dadot.

▶ Kontrolloni lartësinë e rregullimit.

▷ Lartësia e rregullimit është midis 3 mmdhe 13 mm.

▷ Dera e mobilies është niveluar në drejtimin X dhe Y.*




*Fig. 74 **

▶ Kontrolloni distancën e derës nga dyert përreth të mobilies.

▷ Distanca midis dyerve të mobilies dhe derës së pajisjes është e njëjtë rreth e qark.*




Fig. 75

▶ Hapni kapakët mbulues.




Fig. 76

▶ Niveloni buzët e përparme të profilit të mbërthimit paralelisht me buzën e derës së mobilies.
▶ Fiksoni profilin.




Fig. 77

▶ Hapni nga lart kapakët mbulues.




Fig. 78

Niveloni derën e mobilies me vrimat gjatësore në drejtimin Z:*




Fig. 79

▶ Lironi vidat në traversën fiksuese.




Fig. 80

▶ Shpalosni kapakët mbulues në profilet e mbërthimit.




Fig. 81

▶ Lironi vidat në të gjitha profilet e mbërthimit.




Fig. 82

▶ Shtyni derën në drejtimin Z.
▶ Shtrëngoni vidat.




Fig. 83

▶ Hapni nga lart kapakët mbulues.
▶ Mbyllni derën.
▷ Dera e mobilies është niveluar në drejtimin Z.*

3.13.12 Kontrollimi i montimit

▶ Kontrolloni pikat e mëposhtme për t'u siguruar që pajisja është instaluar saktë. Përndryshe mund të ndodhë formim akulli, formim i ujit nga kondensimi dhe probleme në funksionim.




Fig. 84

▷ Dera mbyllet saktë.
▷ Dera e mobilies nuk mbështetet në dollapin e mobilies.
▷ Distanca midis dollapit të mobilies dhe trupit të mobilies është kontrolluar.
▷ Të gjitha vidat janë të kontrolluara.

3.13.13 Vendosja e kapakëve mbulues

▶ Hapni derën.




Fig. 85

▶ Vendoseni kapakun mbulues lart majtas.




Fig. 86

▶ Vendosni kapakun e sipërm mbulues.*




*Fig. 87 **

▶ Vendoseni kapakun mbulues në menteshën e poshtme.*




Fig. 88

▶ Shtyni panelin balancues në anën e dorezës.
▷ Paneli balancues qëndron në faqen anësore të mobilies.




Fig. 89

Montoni profilin magnetik:

▶ Në rast nevoje: Pritni shiritin izolues në gjatësinë e nevojshme me një gërshërë të mprehtë.




Fig. 90

▶ Vendosni shiritin izolues poshtë kapakut të majtë të sipërm mbulues dhe ngjisheni.

3.14 Kanatet e mobilieve

3.14.1 Dimensionet

Në varësi nga varianti i pajisjes, mund t'ju nevojitet një derë mobilieje ose dy të tilla. Dimensionet e derës(dyerve) përkatëse të mobilies varet nga madhësia totale e dollapit dhe nga trashësia e dollapit të mobilies.

Shënim
Mbani parasysh dimensionet përkatëse të pajisjes dhe të dollapit, si dhe skicat e instalimit.

Udhëzimet e përgjithshme:

- Ndiqni këshillat tona specifike për pajisjen, lidhur me madhësinë dhe peshën për montimin me derë fikse. (shihni 3.4 Peshat e kanateve të mobilies)
- Trashësia e dollapit të mobilies duhet të jetë minimumi 16 mm dhe maksimumi 19 mm.

Dyert e tjera të mobilies lart, poshtë ose anash:

- Madhësia e hapësirës vertikale midis dyerve të mobilies duhet të jetë 4 mm.
- Madhësia e hapësirës horizontale midis dyerve të mobilies duhet të jetë 4 mm. Verifikoni këtu karakteristikat kundër përplasjes. (shihni 3.14.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje)

Pesha dhe menteshat:

- Ngarkesa e menteshës është shumë e madhe në kanatet e rënda të mobilieve. Kështu që mentesha dëmtohet lehtë. Për këtë shihni specifikimet maksimale të peshës për pajisjen tuaj në kapitullin Peshat e kanateve të mobilies (shihni 3.4 Peshat e kanateve të mobilies) .
- Nëse kanati i mobilies tejkalon peshën maksimale të lejuar, montimi i një pajisjeje mund të zgjidhet me ndihmën e teknikës së derës me rrëshqitje, sepse pesha shpërndahet në disa menteshа të fshehura të mobilies.
- Nëse përdorni kanate të gjata mobilieje që zgjaten shumë përtej pajisjes, atëherë ne këshillojmë një menteshë dere shtesë (p.sh. Kamat), që ka patjetër të njëjtën pikë rrotullimi si mentesha e derës fikse e përdorur në pajisjen tuaj. Nga përdorimi i një menteshe tjetër (Kamat), pesha shpërndahet nëpër disa pika. Në kanatet e larta të mobilieve rekomandohet përdorimi i një aksesori balancues të frezuar, për të vepruar kundër një deformimi të mundshëm (konveks/konkav).

3.14.2 Montimi i kanatit(eve) të mobilies

Gjatë instalimit mbani parasysh:

- Kanati i mobilies duhet të montohet simetrik me derën e frigoriferit.
- Kanati ngjitur i mobilies duhet të jetë saktësisht në të njëjtin nivel.
- Kanati ngjitur i mobilies ka të njëjtin rreze këndi si kanati i pajisjes.
- Kanati i mobilies është i drejtë dhe pa tendosje.
- Kanati i mobilies ka një rregullim minimal thellësie prej rreth 2 mm me dollapin.

▶ Instaloni pajisjen në dollap.
▶ Mbërtheni kanatin e mobilies në derën e pajisjes.
▶ Rregulloni gjerësinë e fugës.
▶ Verifikoni kanatin e mobilies për përplasje.
(shihni 3.14.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje)

3.14.3 Rregullimi i gjerësisë së fugës pa përplasje

3.14.3 Gjerësia e fugës me faqen e mobilies ngjitur




Fig. 91 Gjerësia e fugës me faqen e mobilies ngjitur

(F) Trashësia e ballinës
(X) Gjerësia minimale e fugës
(R) Rrezja këndore e kanatit të mobilies

Trashësia e ballinës F [mm]	Rrezja këndore e kanatit të mobilies R [mm]	Gjerësia minimale e fugës X (vertikalisht) [mm]
16 deri në 20	0 deri në 3	3

Trashësia e ballinës F [mm]	Rrezja këndore e kanatit të mobilies R [mm]	Gjerësia minimale e fugës X (vertikalisht) [mm]
22	0	4
	1	4
	2	3
	3	3
24	0	8
	1	7
	2	6
	3	6
26	Nuk rekomandohet.	

3.14.3 Gjerësia e fugës me derën e mobilies ngjitur




Fig. 92 Gjerësia e fugës me derën e mobilies ngjitur

(F) Trashësia e ballinës
(X) Gjerësia minimale e fugës
(R) Rrezja këndore e kanatit të mobilies

Trashësia e ballinës F [mm]	Rrezja këndore e kanatit të mobilies R [mm]	Gjerësia minimale e fugës X (vertikalisht) [mm]
16 deri në 20	0 deri në 3	2
22	0	4
	1	3
	2	3
	3	2
24	0	6
	1	5
	2	5
	3	4
26	0	8
	1	7
	2	7
	3	6

3.15 Pas montimit

▶ Hiqni gjithë pjesët e sigurisë së transportit në pjesën e brendshme.

KUJDES
Dëme materiale nga objektet me majtë ose të mprehta!
Nëse përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues, mund të dëmtoni pajisjen.
▶ Mos përdorni objekte me majë ose të mprehta kur hiqni materialin paketues.

- ▶ Hiqni filmat mbrojtës në pjesën e brendshme: Hiqeni filmin mbrojtës duke e tërhequr rrafsh përgjatë komponentit, në mënyrë që të minimizohet forca e saj ngjitëse.
- ▶ Pastroni pajisjen. (shihni 10.3 Pastrimi i pajisjes)
- ▶ Shënoni tipin (modeli, numri), emërtimin e pajisjes, numrin e serisë/pajisjes, datën e blerjes dhe adresën e shitësit.

3.16 Lidhja e pajisjes në furnizimin me energji


PARALAJMËRIM
Rrezik i goditjes elektrike dhe rrezik lëndimi nga pajisja e dëmtuar ose kordoni i dëmtuar i lidhjes elektrike!
Rrezik për jetën dhe lëndime me prerje. Nëse pajisja ose kordoni i lidhjes elektrike dëmtohen gjatë transportit, atëherë mund të ekspozoheni ndaj një goditjeje elektrike fatale. Gjithashtu, ekziston rreziku që të priteni në pjesët e dëmtuara të trupit të pajisjes.
- ▶ Pas transportimit, kontrolloni pajisjen dhe kordonin e lidhjes elektrike për dëmtime.
- ▶ Në asnjë mënyrë mos e vendoni pajisjen në punë, nëse pajisja apo kordoni i lidhjes elektrike është i dëmtuar.
- ▶ Kontakti me shërbimin për klientin.

Ju e lidhni pajisjen në rrjetin elektrik me ndihmën e kordonit të lidhjes elektrike të dërguar më vete. Kordoni i lidhjes elektrike ka në njërin skaj një fishë për pajisjen ftohëse dhe në skajin tjetër ka një spinë elektrike.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
- Pajisja dhe kordoni i lidhjes elektrike nuk janë dëmtuar.
- Pajisja është montuar në përputhje me rregullat. (shihni 3.13 Montimi në dollap)
- Kërkesat për lidhjen elektrike janë respektuar.
- Dimensionet për lidhjen në përputhje me rregullat njihen dhe janë respektuar.
- Tensioni dhe frekuenca e rrjetit elektrik përputhen me specifikimet në etiketën e parametrave.
- Priza elektrike është e tokëzuar dhe e siguruar nga ana elektrike në përputhje me rregullat.
- Rryma e veprimit e siguresës është midis 10 A dhe 16 A.
- Priza elektrike është lehtësisht e arritshme dhe nuk ndodhet prapa pajisjes. (shihni 3.3 Dimensionet e dollapit)

KUJDES
Rrezik dëmtimi nga përdorimi i papërshtatshëm!
Dëmtim i pjesëve elektrike të pajisjes.
- ▶ Përdorni vetëm kordonin e lidhjes elektrike të ofruar me pajisjen.

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga lidhja e pasaktë!
Djegie.
Dëmtime në pajisje.
- ▶ Mos përdorni kabllo zgjatuese.
- ▶ Mos përdorni bashkues me shumë priza.



KUJDES
Rrezik dëmtimi nga lidhja e pasaktë!
Dëmtime në pajisje.
- ▶ Mos e lidhni pajisjen në inverter të pavarur nga rrjeti, si për shembull në impiantet me energji diellore dhe gjeneratorët me benzinë.

- ▶ Lidhni spinën e kordonit të lidhjes elektrike në linjën e furnizimit me energji elektrike. Sigurohuni që spina të futet mirë në prizë.
- ▷ Në ekran shfaqet logoja Liebherr.
- ▷ Ekrani kalon në simbolin Standby.
- ▷ Kur brenda 60 sekondave nuk kryhet asnjë veprim: Simboli Standby zbehet ose zhduket.
- ▷ Pajisja është e lidhur. Për vënien në punë herën e parë shihni kapitullin në vijim ose manualin e përdorimit.

3.17 Hedhja e paketimit

PARALAJMËRIM
Rrezik mbytjeje nga materiali i paketimit dhe fletët mbështjellëse!
- ▶ Mos lejoni fëmijët të luajnë me materialet e paketimit.


Paketimi është i prodhuar nga materiale të ripërdorshme:
- Karton i valëzuar/karton
- Pjesë nga polistiroli i shkumëzuar
- Fletë mbështjellëse dhe qeska prej polietileni
- Shirita prej polipropileni
- Kornizë druri e mbërthyer me gozhda, me shtresa prej polietileni*
- ▶ Dërgoni materialin e paketimit në një pikë të autorizuar grumbullimi.

4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe



Ju e përdorni pajisjen me anë të ekranit Touch & Swipe. Me ekranin Touch & Swipe (në vijim referuar si ekrani) ju zgjidhni funksionet e pajisjes duke prekur mbi ekran ose duke rrëshqitur me gisht në ekran. Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menyja e një niveli më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.

4.1 Navigimi dhe shpjegimi i simboleve

Në figura përdoren simbole të ndryshme për navigimin në ekran. Këto simbole përshkruhen në tabelën në vijim.

Simboli	Përshkrimi
	**Prekja e shkurtër e ekranit:** Aktivizoni/çaktivizoni funksionin. Konfirmoni përzgjedhjen. Hapni nënmenynë.
	**Prekja e gjatë e ekranit me kohën e specifikuar (p.sh. 3 sekonda):** Aktivizoni/çaktivizoni funksionin ose vlerën.
	**Rrëshqitja e gishtit djathtas ose majtas:** Navigoni nëpër meny.


* Në varësi nga modeli dhe pajisja

Simboli	Përshkrimi
	**Prekja shkurt e simbolit të kthimit prapa:** Ktheheni pas me një nivel të menysë.
	**Mbajtja prekur e simbolit të kthimit prapa për 3 sekonda:** Ktheheni pas tek treguesi i statusit.
	**Shigjeta me orën:** Nevojiten më shumë se 10 sekonda derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	**Shigjeta me specifikimin e kohës:** Do të kalojë koha e treguar derisa në ekran të shfaqet treguesi pasardhës.
	**Hapja e simbolit "Menyja Cilësimet":** Navigoni për në menynë e cilësimeve dhe hapni menynë e cilësimeve. Nëse nevojitet: Në menynë e cilësimeve navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 4.2.1 Hapja e menysë Cilësimet)
	**Hapja e simbolit "Menyja e zgjeruar":** Navigoni për në menynë e zgjeruar dhe hapni menynë e zgjeruar. Nëse nevojitet: Në menynë e zgjeruar navigoni për në funksionin që dëshironi. (shihni 4.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar)
Asnjë veprim brenda 10 sekondave	Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menyja e një niveli më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.
Mbyllni dhe hapni derën sërish.	Nëse e mbyllni derën dhe e hapni përsëri menjëherë, treguesi kthehet direkt tek treguesi i statusit.

Shënim: Figurat e ekranit paraqiten me termat në gjuhën angleze.

4.2 Menytë

Funksionet e pajisjes janë të ndara në meny të ndryshme:

Menyja	Përshkrimi
Menyja kryesore	Kur ndizni pajisjen, atëherë ndodheni automatikisht në menynë kryesore. Nga këtu, ju navigoni për në funksionet më të rëndësishme të pajisjes, në menynë e cilësimeve dhe në menynë e zgjeruar.
 Menyja Cilësimet	Menyja Cilësimet përmban funksione të tjera të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj.
Menyja e zgjeruar	Menyja e zgjeruar përmban funksionet e veçanta të pajisjes, për rregullimin e pajisjes suaj. Hyrja në menynë e zgjeruar është e mbrojtur përmes kodit me numra **1 5 1**.

4.2.1 Hapja e menysë Cilësimet




Fig. 93 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Hapet menyja Cilësimet.
▶ Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

4.2.2 Hapja e menysë së zgjeruar



Fig. 94




*Fig. 95 Shembull ilustrues, hyrja me kodin me numra **151***

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Hapet menyja e zgjeruar.
▶ Nëse nevojitet: Navigoni për në funksionin që dëshironi.

4.3 Modaliteti i qetësisë

Nëse nuk e prekni ekranin për 1 minutë, atëherë ekrani kalon në modalitetin e qetësisë. Në modalitetin e qetësisë, niveli i dritës së treguesit është i errësuar.

4.3.1 Përfundimi i modalitetit të qetësisë

▶ Prekni shkurt ekranin me gisht.
▷ Modaliteti i qetësisë përfundon.

5 Vënia në punë

5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Pajisja është montuar dhe lidhur në përputhje me instruksionet e montimit.
- ❑ Të gjithë shiritat ngjitës, fletët ngjitëse dhe mbrojtëse, si dhe siguresat e transportit brenda dhe jashtë pajisjes janë hequr.
- ❑ Të gjitha fletëpalosjet e reklamave janë hequr nga sirtarët.
- ❑ Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe është e njohur. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Ndezja e pajisjes përmes ekranit Touch & Swipe:

▶ Kur ekrani është në modalitetin e qetësisë: Prekni shkurt ekranin.
▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 96 Shembull ilustrues

▷ Shfaqet treguesi i statusit.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur nga fabrika.
▷ Pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ (treguesi i statusit shfaqet me DEMO): Nëse pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ, atëherë ju mund ta çaktivizoni modalitetin demonstrativ brenda 5 minutave. (shihni Modaliteti i demonstrimit)

Informacione të tjera:

- Vini në funksionim IceMaker. (shihni 5.2 Vënia në funksionim e IceMaker)
- Vini në funksionim SmartDevice. (shihni 2.3 SmartDevice) dhe (shihni WLAN)

Shënim
Prodhuesi këshillon:
▶ Futni **ushqimet për ngrirje** në -18 °C ose më shumë.
▶ Ndiqni udhëzimet për ruajtjen. (shihni 6.1 Udhëzime për ruajtjen)

Shënim
Aksesorët mund t'i blini në dyqanin Liebherr-Hausgeräte në adresën e internetit go.liebherr.com/47wtc4.

5.2 Vënia në funksionim e IceMaker

Nëse pajisja juaj është e pajisur me IceMaker, duhet që **përpara përdorimit të parë** ta pastroni IceMaker.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Lidhja e sistemit të furnizimit me ujë është realizuar. Shihni Installation Guide ose manualin e montimit.
- ❑ Pajisja është montuar plotësisht brenda dhe është lidhur plotësisht.

▶ Pastroni IceMaker. (shihni 10.3.4 Pastrimi i IceMaker)

6 Ruajtja

6.1 Udhëzime për ruajtjen

PARALAJMËRIM
Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike!
Përdorimi i pajisjeve elektrike në zonën e ushqimeve mund të shkaktojë rënie zjarri.
▶ Mos përdorni pajisje elektrike në zonën e ushqimeve të pajisjes, nëse kjo nuk rekomandohet nga prodhuesi.

Shënim
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit.

Ndiqni specifikimet e mëposhtme për ruajtjen:

- Paketoni mirë ushqimet.
- Vendosni ushqimet me distancë nga njëra-tjetra, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.
- Vendosni ushqimet në ruajtje në përputhje me specifikimet në paketim.
- Mbani gjithmonë parasysh datën e dhënë për afatin e përdorimit, e cila ndodhet në paketim.

Shënim
Mosndjekja e këtyre këshillave mund të rezultojë në prishjen e ushqimeve.

6.2 Dhoma e ngrirjes

Në -18 °C këtu krijohet një klimë ruajtjeje e akullt e thatë. Një klimë e akullt e ruajtjes është e përshtatshme për ruajtjen për disa muaj të ushqimeve të ngrira dhe të artikujve në ngrirje, për prodhimin e kubave të akullit ose për ngrirjen e ushqimeve të freskëta.

6.2.1 Ngrirja e ushqimeve

Sasia për ngrirje

Ju mund të ngrini maksimumi aq ushqime të freskëta brenda 24 orëve sa tregohet në etiketën e parametrave (shihni 11.5 Etiketa e parametrave) në pjesën "Kapaciteti i ngrirjes ... kg/24h".

Me qëllim që ushqimi të ftohet shpejt deri në brendësi, respektoni sasitë e mëposhtme për çdo paketim:

- Fruta dhe perime deri në 1 kg
- Mish deri në 2,5 kg

Ngrirja e ushqimeve me SuperFrost

Në varësi të sasisë për ngrirje, përpara ngrirjes ju mund të aktivizoni funksionin SuperFrost, në mënyrë që të arrihen temperatura të ngrirjes së thellë. (shihni SuperFrost)
▶ Aktivizoni SuperFrost, kur sasia për ngrirje është më e madhe se rreth 2 kg.

Momenti në të cilin aktivizoni funksionin SuperFrost varet nga sasia për ngrirje:

Sasia për ngrirje	Momenti për aktivizimin e funksionit SuperFrost
Sasi e vogël për ngrirje	Aktivizoni funksionin SuperFrost rreth 6 orë përpara ngrirjes. Sapo pajisja ta çaktivizojë automatikisht funksionin SuperFrost, mund të riorganizoni ushqimet.
Sasi maksimale për ngrirje	Aktivizoni funksionin SuperFrost rreth 24 orë përpara ngrirjes. Sapo pajisja ta çaktivizojë automatikisht funksionin SuperFrost, mund të riorganizoni ushqimet.

Sistemimi i ushqimeve

VINI RE
Rrezik lëndimi nga thyerja e qelqit!
Shishet dhe kanaçet me pije mund të plasin nga ngrirja. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për pijet që përmbajnë gaz karbonik.
▶ Ngrijini shishet dhe kanaçet me pije vetëm nëse keni aktivizuar funksionin BottleTimer në aplikacionin SmartDevice.

Lartësia e pajisjes < 1220 mm	
Sasia për ngrirje	Sistemimi i ushqimeve
Sasi e vogël për ngrirje	Shpërndani ushqimet e paketuara në të gjithë sirtarët. Nëse është e mundur, sistemoni ushqimet prapa në sirtar afër faqes së pasme.
Sasi maksimale për ngrirje	Shpërndani ushqimet e paketuara në të gjithë sirtarët. Nëse është e mundur, sistemoni ushqimet prapa në sirtar afër faqes së pasme.

Lartësia e pajisjes ≥ 1220 mm	
Sasia për ngrirje	Sistemimi i ushqimeve
Sasi e vogël për ngrirje	Shpërndani ushqimet e paketuara në të gjithë sirtarët, por megjithatë mos sistemoni asnjë ushqim në sirtarin më të sipërm.
Sasi maksimale për ngrirje	Shpërndani ushqimet e paketuara në të gjithë sirtarët. Nëse është e mundur, sistemoni ushqimet prapa në sirtar afër faqes së pasme.

6.2.2 Shkrirja e ushqimeve

PARALAJMËRIM
Rrezik i helmimit nga ushqimi!
▶ Mos i ngrini më përsëri ushqimet e shkrira.
▶ Gatuani ushqimet e shkrira sa më shpejt të jetë e mundur.

Ju mund t'i shkrini ushqimet në mënyra të ndryshme:
- në një frigorifer freskues
- në mikrovalë
- në furrë/sobë me ajër të nxehtë
- në temperaturë ambienti

▶ Nxirrni nga frigoriferi vetëm aq ushqim sa ju nevojitet.

6.2.3 Tabakaja e ngrirjes

Me tabakanë e ngrirjes mund të ngrini fruta pylli, erëza/barishte e perime dhe artikuj të tjerë të vegjël në ngrirje, pa qenë e nevojshme që ato të ngjitin me njëri-tjetrin. Ushqimi në ngrirje ruan formën e tij në maksimumin e mundshëm dhe ndarja e mëvonshme në porcione është më e lehtë.

Gjithashtu, në tabakanë e ngrirjes mund të mbani pllakat ftohëse, duke kursyer hapësirë.
▶ Shpërndani ushqimet jo të paketuara mbi tabakanë e ngrirjes me distancë nga njëra-tjetra.

6.3 Kohët e ruajtjes

Kohët e treguara të ruajtjes janë vlera orientuese.

Për ushqimet me specifikim të afatit të përdorimit vlen gjithmonë data e përcaktuar në paketim.

Vlerat orientuese për ruajtjen e ushqimeve të ndryshme		
Akullore	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Sallame, proshuta	në -18 °C	2 deri në 3 muaj
Bukë, produkte brumi për pjekje	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Mish i egër, mish derri	në -18 °C	6 deri në 9 muaj
Peshk, me yndyrë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Peshk, pa yndyrë	në -18 °C	6 deri në 8 muaj
Djathë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Shpendë, mish gjedhi	në -18 °C	6 deri në 12 muaj
Perime, fruta	në -18 °C	6 deri në 12 muaj

7 Kursimi i energjisë

- Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin. Mos i mbuloni vrimat ose grilat e ajrimit.
- Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.
- Mos e montoni pajisjen as në një vend në rrezet direkte të diellit, as pranë sistemit të ngrohjes apo të ngjashme.
- Kur e montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë, konsumi i energjisë mund të rritet paksa. Kjo varet nga kohëzgjatja e përdorimit dhe nga intensiteti i përdorimit të furrës.
- Konsumi i energjisë varet nga kushtet e instalimit, për shembull nga temperatura e ambientit . Kur temperatura e ambientit është më e ngrohtë, atëherë konsumi i energjisë mund të rritet.
- Hapeni pajisjen mundësisht sa më pak kohë.
- Sa më e ulët të vendoset temperatura, aq më i lartë do të jetë konsumi i energjisë.
- Të gjitha ushqimet vendosini në ruajtje të paketuara mirë dhe të mbuluara. Kështu shmanget formimi akullit/borës.
- Futja e ushqimeve të ngrohta: në fillim lërini të ftohen në temperaturën e dhomës.

8 Përdorimi

8.1 Elementët e komandimit dhe tregues

8.1.1 Treguesi i statusit




Fig. 97 Treguesi i statusit tregon temperaturën aktuale.

(1) Treguesi i temperaturës

Treguesi i statusit tregon temperaturën aktuale dhe është treguesi fillestar i rregullimeve. Që aty vijohet me navigimin në funksionet dhe cilësimet e tjera të pajisjes.

8.1.2 Simbolet treguese

Simbolet treguese janë informacion rreth gjendjes aktuale të pajisjes.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	Standby Pajisja ose zona e temperaturës është e fikur.
	**Numër që pulson** Pajisja është duke punuar. Temperatura pulson derisa të arrihet vlera e vendosur.
	
	**Simbol që pulson** Pajisja është duke punuar. Rregullimi po pranohet.
	

8.2 Funksionet e pajisjes

8.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes

Funksionet e pajisjes janë konfiguruar në mënyrë të tillë nga fabrika që pajisja juaj të jetë plotësisht funksionale.

Përpara se të ndryshoni, të aktivizoni ose të çaktivizoni funksionet e pajisjes, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Ju keni lexuar dhe keni kuptuar përshkrimet për mënyrën e funksionimit të ekranit. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)
- ❑ Ju jeni familjarizuar me elementët e komandimit dhe elementët tregues të pajisjes suaj.

Fikja dhe ndezja e pajisjes

Me këtë funksion ju fikni dhe ndizni të gjithë pajisjen.

Fikja e pajisjes

Kur fikni pajisjen, atëherë të gjitha rregullimet e kryera më parë do të ruhen.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Janë ndjekur të gjitha udhëzimet e veprimeve (shihni 12 Nxjerrja jashtë pune) .



Fig. 98




Fig. 99

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Pajisja fiket.
▷ Në ekran shfaqet simboli Standby.
▷ Ekrani bëhet i zi.

Ndezja e pajisjes

Kur ekrani ndodhet në modalitetin e qetësisë:

▶ Prekni shkurt ekranin.




Fig. 100 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
Kur pajisja ndizet në modalitetin e demonstrimit:
▶ Çaktivizoni modalitetin e demonstrimit. (shihni Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit)
▷ Pajisja do të ndizet.
▷ Rregullimet e kryera më parë do të rivendosen.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur.

-18 °C Temperatura

Me këtë funksion ju vendosni temperaturën.

Temperatura varet nga faktorët e mëposhtëm:

- shpeshtësia e hapjes së derës
- kohëzgjatja e hapjes së derës
- temperatura e dhomës në vendin e instalimit
- lloji, temperatura dhe sasia e ushqimit

Dhoma e ngrirjes	Temperatura e vendosur nga fabrika	Cilësimi i rekomanduar
-18 °C	-18 °C	-18 °C

Vendosja e temperaturës




Fig. 101 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Temperatura vendoset.

SuperFrost

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SuperFrost. Kur aktivizoni funksionin SuperFrost, atëherë pajisja e përforcon kapacitetin e ngrirjes. Si rezultat arrini temperatura ngrirjeje më të thella.

Përdorimi:

- Ushqimet e freskëta ngrijnë shpejt deri në brendësi. Kjo siguron që të ruhen vlerat ushqyese, pamja dhe shija e ushqimeve.
- Rritni rezervat e ftohjes në ushqimet e ruajtura në ngrirje, përpara se të shkrini pajisjen.

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Kur dera lihet hapur për një kohë të gjatë, sepse p.sh. doni të vendosni brenda ushqime, pajisja kontrollon automatikisht nëse temperatura reale në pajisje përputhet me temperaturën e vendosur në pajisje. Kur ndryshimi e tejkalon një vlerë të caktuar, pajisja ftoh automatikisht më shumë. Kështu temperatura e shfaqur në ekran mund të jetë më e lartë se temperatura reale në pajisje. Kjo është normale dhe pajisja juaj punon pa probleme.*

Aktivizimi i SuperFrost

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Sasia e produkteve për ngrirje dhe momenti për aktivizimin e funksionit SuperFrost janë marrë parasysh. (shihni Ngrirja e ushqimeve me SuperFrost)



Fig. 102




Fig. 103

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Aktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ SuperFrost aktivizohet.
▷ Treguesi i temperaturës bëhet blu.

Çaktivizimi i SuperFrost

Në varësi nga sasia e ushqimeve të vendosura, SuperFrost çaktivizohet automatikisht pas 56 deri në 72 orë. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni funksionin SuperFrost edhe manualisht në çdo kohë:



Fig. 104




Fig. 105

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Çaktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ SuperFrost do të çaktivizohet.
▷ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë.

PartyMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni PartyMode. PartyMode aktivizon funksione të ndryshme që janë të nevojshme për një festë.

PartyMode aktivizon funksionet e mëposhtme:

- SuperFrost (shihni SuperFrost)
- IceMaker me MaxIce (shihni IceMaker / MaxIce)

Të gjitha funksionet e renditura ju mund t'i rregulloni gjithashtu në mënyrë individuale dhe të pavarur. Nëse e aktivizoni modalitetin PartyMode, atëherë të gjitha ndryshimet do të anulohen.

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Aktivizimi i PartyMode

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 5.2 Vënia në funksionim e IceMaker)



Fig. 106




Fig. 107

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

▷ PartyMode funksionet përkatëse janë aktivizuar.
▷ Treguesi i temperaturës bëhet blu.
▷ Temperatura aktuale pulson derisa të arrihet temperatura e synuar.

Çaktivizimi i PartyMode

Modaliteti PartyMode çaktivizohet automatikisht pas 24 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin PartyMode edhe manualisht në çdo kohë:



Fig. 108




Fig. 109

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ PartyMode është çaktivizuar.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë: Temperatura aktuale pulson derisa të arrihet temperatura e synuar.

SabbathMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SabbathMode. Kur e aktivizoni këtë funksion, disa funksione elektronike do të çaktivizohen. Në këtë mënyrë, pajisja juaj përmbush kërkesat fetare për festat hebraike, si për shembull në Shabat dhe plotëson certifikimin STAR-K Kosher.

Gjendja e pajisjes me SabbathMode aktiv
Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.
Të gjitha funksionet në ekran përveç **funksionit Çaktivizimi i SabbathMode** janë të bllokuara.
Të gjitha funksionet mbeten aktive.
Ekrani qëndron i ndriçuar kur mbyllni derën.
Ndriçimi i brendshëm është i çaktivizuar.
Kujtesat nuk ekzekutohen. Intervali kohor i vendosur ndalohet.
Kujtesat dhe paralajmërimet nuk shfaqen.
Nuk ka asnjë alarm të derës.
Nuk ka asnjë alarm të temperaturës.
IceMaker është jashtë funksioni.
Cikli i shkrirjes punon vetëm sipas kohës së paracaktuar, pa marrë parasysh përdorimin e pajisjes.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike, pajisja rikthehet në SabbathMode.

Gjendja e pajisjes

Shënim
Kjo pajisje mban certifikimin e institutit "Institute for Science and Halacha". (www.machonhalacha.co.il)

Një listë të pajisjeve të certifikuara nga STAR-K e gjeni në www.star-k.org/appliances.

Aktivizimi i SabbathMode

PARALAJMËRIM
Rrezik helmimi nga ushqimi i prishur!
Nëse keni aktivizuar SabbathMode dhe ndodh një ndërprerje e energjisë elektrike, në treguesin e statusit nuk shfaqet asnjë mesazh për ndërprerjen e energjisë elektrike. Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja vazhdon sërish punën në SabbathMode. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike ushqimet mund të prishen dhe konsumimi i tyre mund të shkaktojë helmim nga ushqimi.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike:
▶ Mos konsumi ushqimet që kanë qenë të ngrira dhe janë shkrirë.



Fig. 110




Fig. 111

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ SabbathMode është aktivizuar.
▷ Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.

Çaktivizimi i SabbathMode

Modaliteti SabbathMode çaktivizohet automatikisht pas 80 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin SabbathMode edhe manualisht në çdo kohë:




Fig. 112

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ SabbathMode është çaktivizuar.

EnergySaver

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë. Kur aktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë, konsumi i energjisë ulet dhe temperatura në pajisje rritet. Ushqimet qëndrojnë të freskëta, por kohëzgjatja e ruajtjes së tyre shkurtohet.

Zona e temperaturës	Cilësimi i rekomanduar (shihni Vendosja e temperaturës)	Temperatura me EnergySaver aktiv
-18 °C	-18 °C	-16 °C

Temperaturat

Aktivizimi i EnergySaver



Fig. 113




Fig. 114

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë aktivizohet.

Çaktivizimi i EnergySaver



Fig. 115




Fig. 116

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i kursimit të energjisë çaktivizohet.

IceMaker / MaxIce

Me funksionin IceMaker ju aktivizoni ose çaktivizoni prodhimin e kubave të akullit. Me funksionin MaxIce ju rritni sasinë e kubave të akullit të IceMaker. MaxIce do të çaktivizohet automatikisht pas 48 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni funksionin MaxIce edhe manualisht në çdo kohë: (shihni Çaktivizimi i MaxIce)

Informacione të tjera për sasinë e kubave të akullit:	(shihni 11.1 Të dhënat teknike)
Informacione të tjera për furnizimin me ujë të IceMaker:	(shihni Furnizimi me ujë i IceMaker)
Informacione të tjera për pastrimin e linjave të IceMaker:	(shihni TubeClean)

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Aktivizimi i IceMaker

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Është realizuar furnizimi me ujë në lidhjen fikse të ujit. Shihni manualin e montimit.
❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 9.4 IceMaker)




Fig. 117




Fig. 118

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Aktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ IceMaker aktivizohet. Mund të nevojiten deri në 24 orë derisa IceMaker të prodhojë kubat e parë të akullit.

Aktivizimi i IceMaker me MaxIce

Nëse nuk e keni aktivizuar akoma më parë funksionin IceMaker, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Është realizuar furnizimi me ujë në lidhjen fikse të ujit. Shihni manualin e montimit.
❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 9.4 IceMaker)




Fig. 119




Fig. 120

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Aktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ IceMaker me MaxIce aktivizohet.

Ndërrimi midis IceMaker dhe MaxIce

Nëse keni aktivizuar IceMaker dhe dëshironi që ta ndërroni atë në MaxIce:



Fig. 121




Fig. 122

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ IceMaker me MaxIce aktivizohet.

Nëse keni aktivizuar MaxIce dhe dëshironi që ta ndërroni atë në IceMaker:



Fig. 123




Fig. 124

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ IceMaker aktivizohet.
▷ MaxIce çaktivizohet.

Çaktivizimi i IceMaker dhe MaxIce



Fig. 125




Fig. 126 Shembull ilustrues me funksionin aktiv IceMaker

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Çaktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

▷ IceMaker dhe MaxIce çaktivizohen.
▷ Prodhimi aktual i kubave të akullit do të përfundojë.
▷ IceMaker fiket automatikisht.

Çaktivizimi i MaxIce

▶ Aktivizoni IceMaker. (shihni Aktivizimi i IceMaker)
▷ MaxIce do të çaktivizohet.
▷ IceMaker aktivizohet.
▷ Çaktivizimi i IceMaker dhe MaxIce: (shihni Çaktivizimi i IceMaker dhe MaxIce)

Furnizimi me ujë i IceMaker

Me këtë funksion ju vendosni furnizimin me ujë. Furnizimi me ujë rregullon sasinë e furnizimit të ujit. Ju mund ta ndryshoni furnizimin me ujë, kur ai nuk përputhet me presionin e ujit dhe madhësinë e kubave të akullit të prodhuar.

Në momentin e dërgimit nga fabrika, furnizimi me ujë është i caktuar në vlerën 4. Ju mund të zgjidhni një vlerë nga 1 (sasia më e vogël e furnizimit) deri në 8 (sasia më e madhe e furnizimit).

Vendosja e furnizimit me ujë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ IceMaker është vënë në punë. (shihni 5.2 Vënia në funksionim e IceMaker)
❑ IceMaker është aktivizuar. (shihni IceMaker / MaxIce)



Fig. 127




Fig. 128 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga vlera 5 në vlerën 6.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Niveli i furnizimit me ujë do të vendoset.

TubeClean

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni TubeClean. Nëse e aktivizoni modalitetin TubeClean, atëherë tubat e IceMaker do të pastrohen.

Aktivizimi i TubeClean

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pastrimi i IceMaker është parapërgatitur. (shihni 10.3.4 Pastrimi i IceMaker)
❑ Keni në dispozicion një enë boshe me kapacitet mbushjeje 1,5 l dhe me lartësi maksimale 10 cm .

▶ Futni enën në sirtarin që ndodhet poshtë IceMaker.



Fig. 129




Fig. 130

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ TubeClean aktivizohet.
▷ Procesi i pastrimit ka nisur: Simboli pulson, derisa procesi i pastrimit të përfundojë automatikisht pas 60 minutash.
▷ Kur procesi i pastrimit ka përfunduar: Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.

Çaktivizimi i TubeClean

Funksioni TubeClean përfundon automatikisht pas 60 minutash. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni funksionin TubeClean në çdo kohë gjatë procesit të pastrimit:




Fig. 131

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ TubeClean çaktivizohet: Procesi i pastrimit ndërpritet.
▷ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.

Bllokimi i panelit

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni bllokimin e panelit. Bllokimi i panelit parandalon përdorimin pa dashje të pajisjes, p.sh. nga fëmijët.

Përdorimi:

- Shmangni ndryshimin pa qëllim të funksioneve.
- Shmangni fikjen pa qëllim të pajisjes.
- Shmangni rregullimin pa qëllim të temperaturës.

Aktivizimi i bllokimit të panelit

Nëse aktivizoni bllokimin e panelit, atëherë ju mund të navigoni më tutje nëpër meny, por nuk mund të zgjidhni apo të ndryshoni funksionet e tjera.



Fig. 132




Fig. 133

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Bllokimi i panelit do të aktivizohet.

Çaktivizimi i bllokimit të panelit



Fig. 134




Fig. 135

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Bllokimi i panelit do të çaktivizohet.

Kujtesa

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni kujtesat e ndryshme. Në gjendjen e dërgimit, ky funksion është i aktivizuar.

Aktivizimi i kujtesës



Fig. 136




Fig. 137

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Kujtesa aktivizohet.

Çaktivizimi i kujtesës



Fig. 138




Fig. 139

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Kujtesa çaktivizohet.

Gjuha

Me këtë funksion ju vendosni gjuhën e afishimit.

Ju mund të vendosni gjuhët e mëposhtme:

- Gjermanisht
- Anglisht
- Frëngjisht
- Spanjisht
- Italisht
- Holandisht

- Çekisht
- Polonisht
- Portugalisht
- Bullgarisht
- Rusisht
- Kinezisht

Vendosja e gjuhës



Fig. 140




Fig. 141 Shembull ilustrues sipas gjuhës dhe temperaturës

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Gjuha do të vendoset.
▷ Ekrani kthehet pas tek treguesi i statusit.

°C/°F Njësia e temperaturës

Me këtë funksion ju vendosni njësinë e temperaturës. Ju mund të vendosni gradë Celsius ose gradë Fahrenheit si njësi të temperaturës.

Vendosja e njësisë së temperaturës



Fig. 142




Fig. 144 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga gradë Celsius në gradë Fahrenheit.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Njësia e temperaturës do të vendoset.

Niveli i dritës së ekranit

Me këtë funksion ju rregulloni në mënyrë graduale nivelin e dritës së ekranit.

Ju mund të vendosni nivelet e mëposhtme të dritës:

- 40 %
- 60 %
- 80 %
- 100% (Cilësimi i paracaktuar)

Vendosja e nivelit të dritës



Fig. 145




Fig. 146 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga 80% në 60%.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Niveli i dritës do të vendoset.

WLAN

Me këtë funksion ju lidhni pajisjen tuaj me rrjetin WLAN. Atë mund ta komandoni më pas përmes aplikacionit SmartDevice nga një pajisje fundore celulare. Me këtë funksion ju mund të ndani përsëri ose të rivendosni lidhjen në rrjetin WLAN.

Informacione të tjera për SmartDevice:
(shihni 2.3 SmartDevice)

Shënim
Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Aplikacioni SmartDevice është instaluar (shihni apps.home.liebherr.com).
❑ Regjistrimi në aplikacionin SmartDevice ka përfunduar.



Fig. 147




Fig. 148

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

▷ Lidhja është vendosur.

Shkëputja e lidhjes me WLAN



Fig. 149




Fig. 150

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Lidhja është shkëputur.

Rivendosja e lidhjes me WLAN



Fig. 151




Fig. 152

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Lidhja me WLAN dhe rregullimet e tjera të WLAN rikthehen në cilësimet nga fabrika.

Shfaqja e informacioneve për lidhjen me WLAN



Fig. 153




Fig. 154

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

Informacioni i pajisjes

Me këtë funksion ju shikoni emrin e modelit, indeksin, numrin e serisë dhe numrin e shërbimit të pajisjes suaj. Informacionet e pajisjes ju nevojiten kur kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Me këtë funksion hapni gjithashtu menynë e zgjeruar. (shihni 4 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Shikimi i informacioneve të pajisjes



Fig. 155




Fig. 156

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Ekrani tregon informacionet e pajisjes.

Software

Me këtë funksion ju shikoni versionin e softuerit të pajisjes suaj.

Shikimi i versionit të softuerit



Fig. 157




Fig. 158

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Ekrani tregon versionin e softuerit.

Nisja e ciklit të shkrirjes

Me këtë funksion ju nisni manualisht ciklin e shkrirjes automatike, kur cikli i shkrirjes nuk fillon automatikisht në rast të një defekti.

Nisja e ciklit të shkrirjes



Fig. 159




Fig. 160

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Cikli i shkrirjes ka nisur: Simboli pulson derisa cikli i shkrirjes të përfundojë automatikisht.
▷ Kur cikli i shkrirjes ka përfunduar: Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.

Anulimi i ciklit të shkrirjes

Cikli i shkrirjes përfundon automatikisht. Megjithatë, ju mund ta anuloni gjithashtu ciklin e shkrirjes në çdo kohë gjatë procesit të shkrirjes:




Fig. 161

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Cikli i shkrirjes ndërpritet.
▷ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.

Alarmi i derës

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni alarmin e derës. Alarmi i derës bie kur dera mbahet hapur shumë gjatë. Në gjendjen e dërgimit, alarmi i derës është i aktivizuar. Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës.

Ju mund të vendosni vlerat e mëposhtme:

- 1 minutë
- 2 minuta
- 3 minuta
- Fikur

Vendosja e alarmit të derës



Fig. 162




Fig. 163 Shembull ilustrues: Ndërrimi i alarmit të derës nga 1 minutë në 3 minuta.

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Alarmi i derës vendoset.

Çaktivizimi i alarmit të derës



Fig. 165




Fig. 166

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Alarmi i derës çaktivizohet.

Modaliteti i demonstrimit

Modaliteti i demonstrimit është një funksion i veçantë për shitësit, që të mund të prezantojnë funksionet e pajisjes. Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit, atëherë të gjitha funksionet teknike të ftohjes çaktivizohen.

Nëse kur ndizni pajisjen shfaqet një "Demo" tek treguesi i statusit, kjo tregon se modaliteti i demonstrimit është aktivizuar më parë.

Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit dhe pastaj e çaktivizoni përsëri, pajisja rikthehet në cilësimet e fabrikës. (shihni Rikthimi në cilësimet nga fabrika)

Aktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 167




Fig. 168

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i demonstrimit aktivizohet.
▷ Pajisja është fikur.
▶ Ndizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
▷ Tek treguesi i statusit shfaqet "DEMO".

Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 169




Fig. 170

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Modaliteti i demonstrimit çaktivizohet.
▷ Pajisja është fikur.
▶ Ndizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
▷ Pajisja rikthehet në cilësimet nga fabrika.

Rikthimi në cilësimet nga fabrika

Me këtë funksion ju i ktheni në cilësimet nga fabrika të gjitha rregullimet. Të gjitha rregullimet që keni kryer deri në atë moment, do të rikthehen në cilësimin e tyre fillestar.

Ekzekutimi i rikthimit në gjendjen fillestare



Fig. 171




Fig. 172

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
▷ Pajisja rikthehet në gjendjen fillestare.
▷ Pajisja fiket.
▶ Rindizni pajisjen. (shihni 5.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))


8.3 Mesazhet

Ka dy kategori të mesazheve:

Kategoria	Kuptimi
Paralajmërim	Paralajmërimet shfaqen në rastin e alarmit të derës ose në rast problemesh në funksionim. Paralajmërimet e thjeshta mund t'i mënjanoni edhe vetë. Për problemet e rënda në funksionim duhet të kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
Kujtesë	Kujtesat kujtojnë për proceset e përgjithshme. Ju mund t'i ekzekutoni këto procese dhe kështu të mënjanoni mesazhin.

8.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve

Sjellja e pajisjes në rastin e paralajmërimeve:
- Paralajmërimi shfaqet në ekran në ngjyrë të kuqe.
- Tingulli i alarmit bie me një volum në rritje.
- Në disa paralajmërime pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Mesazhi	Shkaku	Mënjanimi i mesazhit
 **Alarmi i derës**	Mesazhi shfaqet kur dera mbahet hapur shumë gjatë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Alarmi i derës)
 **Alarmi për ndërprerjen e energjisë elektrike**	Mesazhi shfaqet kur temperatura e ngrirjes rritet për shkak të shkëputjes së energjisë elektrike.	
 **Alarmi i temperaturës**	Mesazhi shfaqet kur temperatura e ngrirjes nuk përputhet me temperaturën e vendosur.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Alarmi i temperaturës)
 **Gabim**	Mesazhi shfaqet kur ndodh një gabim në pajisje. Një pjesë e pajisjes shfaq një defekt.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim)
 **Gabim i WLAN**	Mesazhi shfaqet kur pajisja nuk ka mundur të lidhet me rrjetin WLAN. (shihni Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë) Mesazhi shfaqet vetëm gjatë konfigurimit të parë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim i WLAN)

8.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve

Alarmi i derës




Fig. 173 Shembull ilustrues

▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

▶ Mbyllni derën.

▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit.
▷ Pajisja ftoh më shumë dhe temperatura e shfaqur në ekran mund të jetë më e lartë se temperatura reale në pajisje.*
▷ Zhurmat e pajisjes mund të jenë më të larta.*

Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës. (shihni Vendosja e alarmit të derës)

Alarmi për ndërprerjen e energjisë elektrike

Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja ftoh sërish në temperaturën e synuar të vendosur më parë, pa qenë nevoja që ta konfirmoni mesazhin. Por që mesazhi të zhduket nga ekrani, duhet ta konfirmoni atë.




Fig. 174 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani tregon informacionet për paralajmërimin.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Tregohet temperatura më e ngrohtë e ngrirjes.
▷ Nëse temperatura e ngrirjes ka qenë nën -9 °C: Ushqimet mund të konsumohen më tej.
Nëse temperatura e ngrirjes është rritur mbi -9 °C:
▶ Kontrolloni ushqimet.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit: Tregohet temperatura aktuale dhe temperatura e synuar.

Alarmi i temperaturës

Shkaku për diferencën e temperaturës mund të jetë:
- Keni futur në frigorifer ushqim të freskët të ngrohtë.
- Gjatë sistemimit dhe marrjes së ushqimeve, brenda ka qarkulluar shumë ajër i ngrohtë nga dhoma.
- Është ndërprerë energjia elektrike për kohë të gjatë.
- Pajisja është me defekt.

▶ Eliminoni shkakun.
▷ Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur më parë.




Fig. 175 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani tregon informacionet për paralajmërimin.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Tregohet temperatura më e ngrohtë e ngrirjes.
▷ Nëse temperatura e ngrirjes ka qenë nën -9 °C: Ushqimet mund të konsumohen më tej.
Nëse temperatura e ngrirjes është rritur mbi -9 °C:
▶ Kontrolloni ushqimet.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit: Tregohet temperatura aktuale dhe temperatura e synuar.

Gabim




Fig. 176 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Do të shfaqet kodi i gabimit.
▶ Mbani shënim kodin e gabimit.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani kapërcen tek treguesi i statusit.
▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

Gabim i WLAN

▶ Kontrolloni lidhjen me rrjetin WLAN.
▶ Lidhni pajisjen nga e para me rrjetin WLAN. (shihni WLAN)

8.3.3 Përmbledhje e kujtesave

Sjellja e pajisjes në rastin e kujtesave:

- Kujtesa shfaqet në ekran në ngjyrë të verdhë.
- Bie tingulli i alarmit.
- Në disa kujtesa pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Mesazhi	Shkaku	Mënjanimi i mesazhit
 **Kontrolli i sistemit të furnizimit me ujë**	Mesazhi shfaqet kur IceMaker është i aktivizuar, por IceMaker nuk furnizohet me ujë përmes lidhjes fikse të furnizimit me ujë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Kontrolli i sistemit të furnizimit me ujë)
 **Shtyrja brenda e sirtarit të IceMaker**	Mesazhi shfaqet kur IceMaker është i aktivizuar, por sirtari i IceMaker është i hapur.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Shtyrja brenda e sirtarit të IceMaker)

8.3.4 Mënjanimi i kujtesave

Kontrolli i sistemit të furnizimit me ujë




Fig. 177 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin
▷ Ekrani tregon informacionet për kujtesën.
▶ Prekni shkurt ekranin
▶ Kontrolloni sistemin e furnizimit me ujë.

-ose-

▶ Çaktivizoni IceMaker. (shihni Çaktivizimi i IceMaker dhe MaxIce)

Kur sistemi i furnizimit me ujë është kontrolluar dhe IceMaker është i aktivizuar:

▶ Pastroni IceMaker. (shihni 10.3.4 Pastrimi i IceMaker)
▷ IceMaker prodhon kuba akulli.

Shtyrja brenda e sirtarit të IceMaker




Fig. 178 Shembull ilustrues

▶ Prekni shkurt ekranin.
▷ Ekrani tregon informacionet për kujtesën.
▶ Prekni shkurt ekranin.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.

-ose-

▶ Çaktivizoni IceMaker. (shihni IceMaker / MaxIce)

▷ Nëse sirtari i IceMaker është shtyrë brenda dhe IceMaker është i aktivizuar: IceMaker prodhon kuba akulli.

9 Pajisjet

9.1 Sirtarët

Ju mund t'i hiqni sirtarët për t'i pastruar ata.
Ju mund t'i hiqni sirtarët, që të përdorni VarioSpace.

Heqja dhe vendosja e sirtarëve ndryshon sipas sistemit të tërheqjes. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Shënim
Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
- ▶ Lëreni të vendosur në pajisje sirtarin më të poshtëm.
- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit brenda në faqen e pasme.

9.1.1 Sirtari mbi bazamentin e pajisjes ose mbi pllakën e xhamit

Sirtari lëviz direkt mbi bazamentin e pajisjes ose mbi një pllakë xhami. Këtu nuk ka asnjë shinë.

Nëse ju e hiqni sirtarin, ju mund t'i përdorni pllakat e xhamit poshtë tij si rafte mbajtës.

Heqja e sirtarit




Fig. 179

▶ Hiqni sirtarin siç tregohet në figurë.

Vendosja e sirtarit




Fig. 180

▶ Vendosni në vend sirtarin siç tregohet në figurë.

9.1.2 Sirtari mbi shina teleskop

Sirtari lëviz me shinat që zgjaten jashtë (shinat teleskop). Ekzistojnë shina teleskop me tërheqje të plotë jashtë dhe shina teleskop me tërheqje të pjesshme jashtë. Sirtarët me tërheqje të plotë jashtë mund të nxirren plotësisht jashtë nga pajisja. Sirtarët me tërheqje të pjesshme jashtë nuk mund të nxirren plotësisht jashtë nga pajisja. Lloji i sistemit që gjendet në pajisjen tuaj varet nga lloji i pajisjes.

Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit

Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit është me dalje të pjesshme jashtë.

Heqja e sirtarit




Fig. 181

- ▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund. *Fig. 181 (1)*
- ▶ Ngrini lart sirtarin majtas. *Fig. 181 (2)*
- ▶ Shtyni brenda shinën e majtë. *Fig. 181 (3)*




Fig. 182

- ▶ Ngrini lart sirtarin djathtas. *Fig. 182 (4)*
- ▶ Shtyni brenda shinën e djathtë. *Fig. 182 (5)*
- ▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 182 (6)*




Fig. 183

Kur pas heqjes së sirtarit, shinat nuk janë futur ende plotësisht brenda:

- ▶ Shtyni shinat plotësisht brenda.

Vendosja e sirtarit




Fig. 184

- ▶ Shtyni shinat brenda.
- ▶ Vendosni sirtarin pjerrtas mbi shina.




Fig. 185

- ▶ Ulni poshtë sirtarin.
- ▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

9.1.3 Sirtari i sipërm me anim

Nëse sirtari i sipërm tërhiqet jashtë, ai anohet nga përpara. Kështu do të siguroni një shikim më të mirë brenda sirtarit. Ky funksion varet nga lartësia e pajisjes.

Nëse ju e hiqni sirtarin e sipërm me anim, ju mund ta përdorni pllakën e xhamit poshtë tij si raft mbajtës.

Heqja e sirtarit




Fig. 186

▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
▶ Ngrijeni lart sirtarin përpara dhe në të njëjtën kohë shtyjeni për lart nga poshtë, në pjesën prapa.
▶ Hiqeni sirtarin nga përpara.

Vendosja e sirtarit




Fig. 187

▶ Vendosni sirtarin siç tregohet në figurë.
▷ Sirtari mbështetet mbi pllakën e xhamit.
▶ Ngrijeni sirtarin paksa lart nga poshtë në pjesën prapa dhe shtyjeni përmes vendit të kalimit.
▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

9.1.4 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë

Sirtari lëviz direkt mbi brinjën e kutisë. Këtu nuk ka asnjë shinë.

Heqja e sirtarit




Fig. 188

▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
▶ Ngrini lart sirtarin në pjesën përpara. *Fig. 188 (1)*
▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. *Fig. 188 (2)*

Vendosja e sirtarit




Fig. 189

▶ Vendosni sirtarin pjerrtas prapa ndaluesve mbi brinjën e kutisë. (shihni Fig. 189)
▶ Ulni poshtë sirtarin.
▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

9.2 Rafti me tërheqje me IceTower




Fig. 190 Rafti me tërheqje me IceTower

(1) IceMaker
(2) Tasi me varje për kubat e akullit
(3) Kutia për shembull për picë, pije alkoolike
(4) Rafti me tërheqje

Mbi raftin me tërheqje ndodhet dy kuti të larta (IceTower). Në kutinë *Fig. 190 (2)* mblidhen dhe mbahen kubat e akullit nga IceMaker. Kutia *Fig. 190 (3)* është e përshtatshme për ruajtjen e ushqimeve të larta, si picat ose pijet alkoolike.

Rafti me tërheqje me IceTower është i montuar mbi një pllakë xhami me shina me tërheqje. Ju mund ta zbërtheni raftin me tërheqje për ta pastruar.

9.2.1 Zbërthimi i raftit me tërheqje me IceTower

Heqja e kutisë




Fig. 191

▶ Tërhiqni jashtë raftin me tërheqje.
▶ Ngrijeni kutinë *Fig. 191 (5)* lart përpara.
▶ Hiqni kutinë.




Fig. 192

▶ Hiqni tasin me varje *Fig. 192 (6)*.
▶ Nëse ai ka kuba akulli: Zbrazni tasin me varje.
▷ Kutia dhe tasi me varje hiqen dhe ju mund t'i pastroni ato. (shihni 10.3.3 Pastrimi i pjesëve)

Heqja e raftit me tërheqje

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Kutitë janë hequr. (shihni Heqja e kutisë)




Fig. 193

▶ Shtyni brenda raftin me tërheqje. *Fig. 193 (7)*
▶ Ngrini lart raftin me tërheqje përpara majtas. *Fig. 193 (8)*
▶ Ngrini lart raftin me tërheqje përpara djathtas. *Fig. 193 (9)*

▷ Rafti me tërheqje është liruar përpara nga mbërthimi.
▶ Hiqeni nga përpara raftin me tërheqje. *Fig. 193 (10)*
▷ Rafti me tërheqje hiqet dhe ju mund ta pastroni atë. (shihni 10.3.3 Pastrimi i pjesëve)

Heqja e pllakës së xhamit nën raftin me tërheqje

(shihni 9.3 Pllakat e xhamit)

9.2.2 Vendosja e raftit me tërheqje me IceTower

Vendosja e pllakës së xhamit nën raftin me tërheqje

(shihni 9.3 Pllakat e xhamit)

Vendosja e raftit me tërheqje




Fig. 194

▶ Shtyni shinat brenda.




Fig. 195

▶ Vendosni raftin me tërheqje pjerrtas prapa gjuhëzave kapëse të përparme.
▶ Shtyjeni pjerrtas brenda. Bëni kujdes që në të dyja anët ndaluesi të jetë prapa gjuhëzës kapëse. *Fig. 195 (11)*
▶ Uleni poshtë përpara raftin me tërheqje. *Fig. 195 (12)*




Fig. 196

▶ Shtypni për poshtë raftin me tërheqje në pjesën përpara.
▷ Dëgjohet zhurma e mbërthimit të raftit me tërheqje.

Vendosja e kutive

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Rafti me tërheqje është vendosur. (shihni Vendosja e raftit me tërheqje)




Fig. 197

▶ Tërhiqni jashtë raftin me tërheqje.
▶ Mbajeni me një dorë raftin me tërheqje.

Shënim
Kutitë janë me formë të tillë që nuk mund të shkëmbehen kurrë me njëra-tjetrën.

▶ Vendosni kutinë pjerrtas mbi raftin me tërheqje. *Fig. 197 (13)*
▶ Shtyjeni kutinë brenda pjerrtas për nga prapa. *Fig. 197 (14)*
▶ Uleni poshtë kutinë përpara. *Fig. 197 (15)*




Fig. 198

▶ Vendosni tasin me varje *Fig. 198 (6)* për kubat e akullit.
▶ Shtyni brenda raftin me tërheqje me kutinë (IceTower). *Fig. 198 (16)*
▷ Rafti me tërheqje me IceTower është vendosur plotësisht.

9.3 Pllakat e xhamit

KUJDES
Ndalohet heqja e pllakës së xhamit mbi IceTower! Dëmtime te IceMaker. Në pllakën e xhamit mbi IceTower është fiksuar IceMaker.
▶ Mos e hiqni pllakën e xhamit mbi IceTower.

Ju mund ta hiqni pllakën e xhamit poshtë sirtarëve që ta pastroni atë.

Ju mund ta hiqni pllakën e xhamit poshtë sirtarëve, në mënyrë që të përdorni VarioSpace.

9.3.1 Heqja / vendosja e pllakës së xhamit nën sirtarin me anim

Pllaka e xhamit ndodhet nën sirtarin e sipërm me anim.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Sirtari është hequr. (shihni 9.1.3 Sirtari i sipërm me anim)

Heqja e pllakës së xhamit




Fig. 199 Pllaka e xhamit e sirtarit me anim

▶ Shtyni nga poshtë pllakën e xhamit në të dyja anët në drejtimin për lart. (shihni Fig. 199)
▶ Hiqeni pllakën e xhamit nga përpara.

Vendosja e pllakës së xhamit




Fig. 200 Pllaka e xhamit e sirtarit me anim

▶ Vendosni pllakën e xhamit pjerrtas prapa ndaluesve. (shihni Fig. 200)
▶ Ulni poshtë pllakën e xhamit.
▶ Shtyjeni pllakën e xhamit për nga prapa.
▷ Pllaka e xhamit mbërthehet në vend.

9.3.2 Heqja / vendosja e pllakës së xhamit

Pllaka e xhamit, në varësi të pajisjes, mund të ndodhet poshtë sirtarit.

Pllaka e xhamit, në varësi të pajisjes, mund të ndodhet poshtë IceTower.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Pllaka e xhamit poshtë sirtarit: Sirtari është hequr. (shihni 9.1 Sirtarët)
❑ Rafti me tërheqje poshtë IceTower: IceTower është hequr. (shihni 9.2 Rafti me tërheqje me IceTower)

Heqja e pllakës së xhamit




*Fig. 201 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit**




*Fig. 202 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit**

▶ Ngrini lart pllakën e xhamit përpara.
▶ Hiqeni pllakën e xhamit nga përpara.

Vendosja e pllakës së xhamit




*Fig. 203 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit**




*Fig. 204 Shembull ilustrues i pllakës së xhamit**

▶ Vendosni pllakën e xhamit pjerrtas prapa ndaluesve.
▶ Ulni poshtë pllakën e xhamit.
▶ Shtyjeni pllakën e xhamit për nga prapa.

9.4 IceMaker

IceMaker shërben vetëm për të prodhuar kuba akulli në sasi të zakonshme për familje.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- IceMaker është pastruar. (shihni 10 Mirëmbajtja)
- Sirtari IceMaker është pastruar.
- Sirtari IceMaker është futur plotësisht brenda.

9.4.1 Prodhimi i kubave të akullit

Kapaciteti prodhues varet nga temperatura e ngrirjes. Sa më e ulët të jetë temperatura, aq më shumë kuba akulli mund të prodhohen në një periudhë kohe të caktuar.

Pasi IceMaker ndizet për herë të parë, mund të nevojiten deri në 24 orë që të prodhohen kubat e parë të akullit.

▶ Aktivizoni funksionin IceMaker.
▶ Për të prodhuar shumë kuba akulli: Aktivizoni funksionin MaxIce.
▶ Për të prodhuar shumë kuba akulli: Zhvendosni ose hiqni ndarësen në sirtarin IceMaker.

▶ Shpërndani njëtrajtësisht kubat e akullit në sirtar, për të rritur sasinë e mbushjes.
▶ Mbyllja e sirtarit: IceMaker fillon sërish automatikisht me prodhimin e akullit.

Shënim
Kur në sirtarin e IceMaker arrihet një nivel i caktuar mbushjeje, nuk prodhohen më kuba akulli të tjerë. IceMaker nuk e mbush sirtarin deri në buzë.

9.5 VarioSpace




Fig. 205

Ju mund t'i hiqni sirtarët dhe pllakat e xhamit nga pajisja. Në këtë mënyrë ju siguroni hapësirë për ushqimet e mëdha, si p.sh. shpendët, mishi, copat e mëdha të kafshëve të egra të gjahut dhe produktet e larta për pjekje. Si rezultat, këto mund të ngrihen të plota dhe të përgatiten më pas si të tilla.
▶ Mbani parasysh kufijtë e ngarkesës së sirtarëve dhe pllakave të xhamit (shihni 11.1 Të dhënat teknike) .

9.6 Pllaka ftohëse

Pllakat ftohëse parandalojnë rritjen e shpejtë të temperaturës në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Pllakat e ftohjes janë në sirtar.

Ju mund t'i vendosni pllakat ftohëse në tabakanë e ngrirjes.

9.6.1 Përdorimi i pllakës ftohëse




Fig. 206

Kur pllakat ftohëse janë të ngrira:
▶ Shtrojini mbi produktet e ngrira, në pjesën përpara lart të ndarjes së ngrirjes.

9.7 Ndarësi fleksibël i sirtarit të akullit

Sirtari i kubave të akullit të IceMaker ka një ndarës fleksibël të sirtarit të akullit. Në rast nevoje, këtu mund të ruani edhe sasi të mëdha kubash akulli ose ushqime shtesë. Ju mund ta shtyni ose ta hiqni ndarësin e sirtarit të akullit.

9.7.1 Zhvendosja e ndarësit fleksibël të sirtarit të akullit




Fig. 207 Shembull ilustrues i ndarësit të sirtarit të akullit

▶ Zhvendosni ndarësin e sirtarit të akullit në pozicionin që dëshironi.

9.7.2 Heqja e ndarësit fleksibël të sirtarit të akullit

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ Sirtari i kubave të akullit është hequr. (shihni 9.1 Sirtarët)




Fig. 208

▶ Ngrini lart pjesën e pasme të ndarësit të sirtarit të akullit. *Fig. 208 (1)*
▶ Hiqeni ndarësin e sirtarit të akullit nga lart. *Fig. 208 (2)*

9.7.3 Vendosja e ndarësit fleksibël të sirtarit të akullit

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
❑ Sirtari i kubave të akullit është hequr. (shihni 9.1 Sirtarët)




Fig. 209

▶ Futni brenda pjesën e përparme të ndarësit të sirtarit të akullit. *Fig. 209 (1)*
▶ Ulni poshtë pjesën e pasme të ndarësit të sirtarit të akullit deri në bazamentin e sirtarit. *Fig. 209 (2)*

10 Mirëmbajtja

10.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje

10.1.1 Shënime për zbërthimin

Ju mund t'i zbërtheni disa sisteme me tërheqje për t'i pastruar. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Sistemet më tërheqje në vijim janë të çmontueshëm ose jo të çmontueshëm:

Sistemi me tërheqje	i çmontueshëm / jo i çmontueshëm
Sirtari mbi bazamentin e pajisjes ose mbi pllakën e xhamit	jo i çmontueshëm
Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit	i çmontueshëm (shihni Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit)
Sirtari i sipërm me anim	i çmontueshëm (shihni 10.1.3 Sirtari i sipërm me anim)
Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë	i çmontueshëm (shihni 10.1.4 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë)
IceTower	i çmontueshëm (shihni 10.1.5 IceTower)

10.1.2 Sirtari mbi shina teleskop

Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit

Zbërthimi i sistemit me tërheqje

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Sirtari është hequr.
- ❑ Pllaka e xhamit është hequr. (shihni 9.3 Pllakat e xhamit)




Fig. 210 Pllaka e xhamit me shinat

- ▶ Shtyni për lart grepat e kapjes në pjesën përpara. *(1)*
- ▶ Shkëputni shinën me tërheqje në pjesën anësore *(2)* dhe në pjesën prapa *(3)*.




Fig. 211 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë

- ▶ Hiqni nga anash pjesën kapëse nga brinja e kutisë.

Montimi i sistemit me tërheqje




Fig. 212 Pllaka e xhamit me shinat

- ▶ Kapni shinën në kapëse në pjesën prapa. *(1)*
- ▶ Kapni shinën në kapëse në pjesën përpara. *(2)*




Fig. 213 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë

- ▶ Ngjishni pjesën kapëse në brinjën e kutisë.

10.1.3 Sirtari i sipërm me anim

Zbërthimi i sistemit me tërheqje

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Sirtari është hequr. (shihni 9.1.3 Sirtari i sipërm me anim)
- ❑ Pllaka e xhamit është hequr. (shihni 9.3 Pllakat e xhamit)




Fig. 214 Pllaka e xhamit me pjesët anësore

- ▶ Hiqni nga anash pjesën anësore nga pllaka e xhamit.

Montimi i sistemit me tërheqje




Fig. 215 Pllaka e xhamit me pjesët anësore

▶ Vendosni pjesën anësore në pjesën prapa.
▶ Ngjishni pjesën anësore në pllakën e xhamit në pjesën përpara.

10.1.4 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë

Zbërthimi i sistemit me tërheqje

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ Sirtari është hequr. (shihni 9.1.4 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë)




Fig. 216 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë

▶ Kapni pjesën kapëse poshtë nga prapa.
▶ Tërhiqni anash pjesën kapëse në pjesën e pasme. *Fig. 216 (1)*
▶ Tërhiqni anash pjesën kapëse në pjesën e përparme. *Fig. 216 (2)*

Montimi i sistemit me tërheqje




Fig. 217 Krahasimi i pjesëve kapëse

Në pajisje gjenden dy pjesë kapëse të ndryshme. Pjesa kapëse mbi sirtarin më të poshtëm *Fig. 217 (2)* ka një cep në formë trekëndëshi. Të gjitha pjesët e tjera kapëse *Fig. 217 (1)* kanë një cep të drejtë.

▶ Vendosni pjesën kapëse *Fig. 217 (2)* me cepin në formë trekëndëshi mbi sirtarin më të poshtëm.
▶ Vendosni pjesën kapëse *Fig. 217 (1)* me cepin e drejtë në të gjitha vendet e tjera.




Fig. 218 Pjesa kapëse në brinjën e djathtë të kutisë

▶ Vendoseni pjesën kapëse përpara në brinjën e kutisë. *Fig. 218 (1)*
▶ Shtyni pjesën kapëse në pjesën e pasme. *Fig. 218 (2)*

10.1.5 IceTower

Zbërthimi i sistemit me tërheqje

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

❑ IceTower është hequr. (shihni 9.2 Rafti me tërheqje me IceTower)
❑ Pllaka e xhamit është hequr. (shihni 9.3 Pllakat e xhamit)

▶ Vendosni raftin me tërheqje mbi tavolinë.
▷ Kështu mund t'i hiqni më lehtë shinat nga pllaka e xhamit.




Fig. 219 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse

▶ Shtypni për poshtë pjesën mbajtëse në pjesën prapa (shihni Fig. 219) dhe në të njëjtën kohë shtyni shinën për nga pas.




Fig. 220 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse

▷ Kapësët e shinave lirohen nga pjesa mbajtëse.
▶ Hiqni shinën nga pjesa mbajtëse.




Fig. 221 Pllaka e xhamit me pjesët mbajtëse

▶ Hiqni nga anash pjesën mbajtëse nga pllaka e xhamit.

Montimi i sistemit me tërheqje




Fig. 222 Pllaka e xhamit me pjesët mbajtëse

▶ Vendosni pjesën mbajtëse mbi pllakën e xhamit.
▶ Shtyni pjesën mbajtëse deri në fund në pllakën e xhamit.




Fig. 223 Njësia e zbutjes së mbylljes

Në shinën e majtë është e fiksuar njësia e zbutjes së mbylljes. (shihni Fig. 223) Në shinën e djathtë nuk ka të fiksuar asnjë njësi të zbutjes së mbylljes.




Fig. 224 Pllaka e xhamit me shinat dhe pjesët mbajtëse

Montimi i shinës **me** njësi të zbutjes së mbylljes:
▶ Vendosni kapësët e shinës mbi vrimat e pjesës mbajtëse **të majtë**. *Fig. 224 (1)*
▶ Tërhiqni shinën për nga përpara. *Fig. 224 (2)*
▷ Dëgjohet zhurma e kapjes së shinës në pjesën prapa.

Montimi i shinës **pa** njësi të zbutjes së mbylljes:
▶ Vendosni kapësët e shinës mbi vrimat e pjesës mbajtëse **të djathtë**. *Fig. 224 (1)*
▶ Tërhiqni shinën për nga përpara. *Fig. 224 (2)*
▷ Dëgjohet zhurma e kapjes së shinës në pjesën prapa.

10.2 Shkrirja e pajisjes

10.2.1 Shkrirja me NoFrost

Shkrirja kryhet automatikisht nëpërmjet sistemit NoFrost. Lagështia precipiton vetë mbi serpentinë, shkrihet dhe avullon në mënyrë periodike.

Pajisja nuk duhet shkrirë.

10.3 Pastrimi i pajisjes

10.3.1 Parapërgatitja

PARALAJMËRIM
Rrezik nga goditja elektrike!
▶ Hiqni spinën e frigoriferit ose ndërpritni furnizimin me energji elektrike.

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje!
▶ Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.

▶ Zbrazni pajisjen.
▶ Hiqni spinën elektrike.

10.3.2 Pastrimi i hapësirës së brendshme

KUJDES
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.
▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

▶ Sipërfaqet plastike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Sipërfaqet metalike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.

10.3.3 Pastrimi i pjesëve

KUJDES
Pastrimi i gabuar!
Dëmtime në pajisje.
▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

Pastrimi me një pecetë të butë e të pastër, ujë të vakët dhe pak detergjent:

- Rafti me tërheqje IceTower
- Sirtari
  Mbani parasysh: Mos e hiqni magnetin që ndodhet te sirtari! Magneti siguron funksionimin e IceMaker.
- Ndarësi fleksibël i ndarjes së akullit në sirtarin e kubave të akullit IceMaker
- Tabakaja e ngrirjes

Pastrimi me pecetë të lagësht:

- Shinat teleskop
  Mbani parasysh: Grasoja në shinat e rrëshqitjes shërben për lubrifikimin dhe nuk duhet fshirë!

Pastrimi në larëse enësh deri në 60 °C:

- Lopata e kubave të akullit

▶ Zbërthimi i pjesëve: shihni kapitullin përkatës.
▶ Pastroni pjesët.

10.3.4 Pastrimi i IceMaker

IceMaker mund të pastrohet në mënyra të ndryshme.

Pastrimi duhet kryer në rastet më poshtë:

- ❑ Vënia në punë herën e parë
- ❑ Me linjë furnizimi me ujë:
  Mospërdorimi për më shumë se 5 ditë.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- ❑ Sirtari i IceMaker është i zbrazur.
- ❑ Sirtari i IceMaker është futur brenda.
- ❑ IceMaker është aktivizuar.

Në vënien në punë herën e parë ose pas mospërdorimit për kohë të gjatë

Pastroni IceMaker me funksionin TubeClean.

▶ Vendosni një enë boshe 1,5 l (lartësia maksimale 10 cm) në sirtarin poshtë IceMaker.
▶ Aktivizoni funksionin TubeClean.
▷ Procesi i shpëlarjes është duke u përgatitur (maks. 60 min): Simboli pulson.
▷ Tubat e ujit janë duke u shpëlarë: Simboli pulson.
▷ Procesi i shpëlarjes ka përfunduar: Funksioni çaktivizohet automatikisht.
▶ Hiqni IceMaker dhe hiqni edhe enën e futur.
▶ Pastroni sirtarin e IceMaker me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.
▷ Prodhimi i kubave të akullit fillon automatikisht.

Pa filtër uji

▶ Hidhni kubat e akullit që janë prodhuar 24 orë pas prodhimit të parë të kubave të akullit.

Nëse nevojitet pastrim

Pastroni IceMaker manualisht.

▶ Hiqni sirtarin e IceMaker dhe pastrojeni me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
▶ Shtyni brenda sirtarin e IceMaker.
▷ Prodhimi i kubave të akullit fillon automatikisht.

10.3.5 Pas pastrimit

▶ Thani pajisjen dhe pjesët përshtatëse duke i fërkuar.
▶ Lidhni pajisjen dhe ndizeni.
▶ Aktivizoni funksionin SuperFrost (shihni 8.2 Funksionet e pajisjes) .
  Kur temperatura të jetë mjaftueshëm e ftohtë:
▶ Futni ushqimet.
▶ Përsëritni pastrimin rregullisht.

11 Ndihma për klientin

11.1 Të dhënat teknike

Diapazoni i temperaturave	
Ngrirja	-28 °C deri në -15 °C

Sasia maksimale e ngrirjes / 24 orë	
Dhoma e ngrirjes	Shihni etiketën e parametrave te „Kapaciteti i ngrirjes .../ 24 h“

Pesha maksimale e ngarkimit të pajisjeve			
Pajisjet	Gjerësia e pajisjes 550 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes)	Gjerësia e pajisjes 600 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes)	Gjerësia e pajisjes 700 mm (shihni instruksionet e montimit, Përmasat e pajisjes)
Sirtari mbi pllakën e xhamit (shihni 9.1.1 Sirtari mbi bazamentin e pajisjes ose mbi pllakën e xhamit)	12 kg	15 kg	--
Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë (shihni 9.1.4 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë)	14 kg	19 kg	19 kg
Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit (shihni 9.1.2 Sirtari mbi shina teleskop)	12 kg	15 kg	22 kg
Sirtari më i poshtëm	--	11 kg	19 kg
Sirtari i sipërm me anim (shihni 9.1.3 Sirtari i sipërm me anim)	--	19 kg	19 kg

Prodhimi i kubave të akullit me IceMaker	
Prodhimi i kubave të akullit / 24 orë	Në temperaturë -18 °C: 0,8 kg kuba akulli
Prodhimi maksimal i kubave të akullit / 24 orë	Kur funksioni MaxIce është aktiv: 1,2 kg kuba akulli

Ndriçimi	
Klasa e efiçencës së energjisë[1]	Burimi i dritës
Ky produkt përmban një ose më shumë burime drite të klasës së efiçencës së energjisë "G".	LED

[1] *Pajisja mund të ketë burime drite me klasa të ndryshme të efiçencës së energjisë. Këtu jepet klasa e efiçencës më të ulët të energjisë.*

Për pajisjet me lidhje Wi-Fi:

Të dhënat e frekuencave	
Brezi i frekuencave	2,4 GHz
Fuqia maksimale e rrezatuar	< 100 mW
Qëllimi i përdorimi i pajisjes me radiovalë	Lidhja në rrjetin lokal Wi-Fi për komunikimin e të dhënave

11.2 Zhurmat gjatë punës

Pajisja shkakton nivele të ndryshme zhurme gjatë funksionimit të saj.

- Në **performancë të ulët ftohjeje** pajisja punon duke kursyer energji, por punon më gjatë. Niveli i zhurmës është më **i ulët**.
- Në **kapacitet të lartë freskimi** ushqimet ftohen më shpejt. Niveli i zhurmës është më **i lartë**.

  Shembuj:
  - funksionet e aktivizuara (shihni 8.2 Funksionet e pajisjes)
  - ventilatori që punon
  - ushqimi i vendosur i freskët
  - temperatura e lartë e ambientit
  - dera e mbajtur hapur gjatë

Zhurma	Shkaku i mundshëm	Lloji i zhurmës
Zhurmë qarkullimi dhe gurgullime	Agjenti ftohës qarkullon në qarkun e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Fërshëllimë dhe shfryrje	Agjenti ftohës injektohet në qarkun e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Gumëzhimë	Pajisja është duke ftohur. Niveli i zhurmës varet performanca e ftohjes.	Zhurmë pune normale
Zhurma gëlltitjeje	Dera me amortizator mbylljeje hapet dhe mbyllet.	Zhurmë pune normale
Zukatje dhe fështërimë	Ventilatori është duke punuar.	Zhurmë funksionimi normale
Klikim	Komponentët ndizen dhe fiken.	Zhurmë veprimi normale
Kërcitje ose zukamë	Valvulat ose ventilet janë aktive.	Zhurmë veprimi normale

Zhurma	Shkaku i mundshëm	Lloji i zhurmës	Mënjanimi
Dridhje	Instalimi i papërshtatshëm	Zhurmë gabimi	Kontrolloni instalimin. Niveloni pajisjen.
Kërcitje	Pajisjet, Objektet në brendësi të pajisjes	Zhurmë gabimi	Fiksoni pjesët e pajisjeve. Lini distancë midis objekteve brenda.

11.3 Defektet teknike

Pajisja juaj është projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e funksionimit dhe jetëgjatësia e madhe. Por megjithatë kur gjatë përdorimit shfaqet një problem, verifikoni nëse problemi është shkaktuar si rezultat i një gabimi në përdorim. Në këtë rast, duhet të merrni në konsideratë kostot e riparimit, edhe gjatë periudhës së garancisë.

Problemet që jepen në vijim mund t'i eliminoni vetë.

11.3.1 Funksioni i pajisjes

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	▶ Ndizni pajisjen.
	→ Spina nuk është futur saktë në prizën elektrike.	▶ Kontrolloni spinën.
	→ Siguresa në prizën elektrike nuk është në rregull.	▶ Kontrolloni siguresën.
	→ Shkëputje e energjisë elektrike	▶ Mbani të mbyllur pajisjen. ▶ Mbrojtja e ushqimeve: Shtroni pllakat ftohëse lart mbi ushqime ose përdorni një pajisje tjetër ngrirëse, nëse shkëputja e energjisë elektrike zgjat shumë. ▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e shkrira.
	→ Fisha e frigoriferit nuk është futur mirë në pajisje.	▶ Kontrolloni fishën e frigoriferit.
Temperatura nuk është mjaftueshëm e ftohtë.	→ Dera e pajisjes nuk është e mbyllur siç duhet.	▶ Mbyllni derën e pajisjes.
	→ Qarkullimi i ajrit dhe ajrimi nuk është i mjaftueshëm.	▶ Mbani të lirë dhe pastroni rrjetën e ajrimit.
	→ Temperatura e ambientit është shumë e lartë.	▶ Zgjidhja e problemit: (shihni 1.8 Klasat e klimës)

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
	→ Pajisja është hapur shumë shpesh ose për kohë të gjatë.	▶ Pritni për të parë nëse temperatura e kërkuar do të rivendoset vetvetiu. Nëse jo, kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
	→ Janë futur sasi shumë të mëdha ushqimi të freskët pa funksionin SuperFrost.	▶ Zgjidhja e problemit: (shihni SuperFrost)
	→ Temperatura është vendosur gabim.	▶ Vendosni temperaturë më të ftohtë dhe kontrollojeni pas 24 orësh.
	→ Pajisja ndodhet shumë pranë një burimi nxehtësie (sobë, kalorifer etj.).	▶ Ndryshoni vendin e pajisjes ose të burimit të nxehtësisë.
	→ Pajisja nuk është instaluar saktë brenda në dollap.	▶ Kontrolloni nëse pajisja është instaluar në rregull dhe që dera mbyllet si duhet.
Temperatura e shfaqur në ekran është më e lartë se temperatura reale në pajisje.*	→ Dera e pajisjes ka ndenjur gjatë hapur dhe alarmi i derës është aktivizuar automatikisht. Kështu pajisja ftoh më shumë.	▶ Mbyllni derën e pajisjes.
Guarnicioni i derës është me defekt ose duhet ndërruar për arsye të tjera.	→ Guarnicioni i derës është i ndërrueshëm. Ai mund të ndërrohet pa vegla pune shtesë.	▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)
Pajisja ka zënë akull ose formohet ujë nga kondensimi.	→ Guarnicioni i derës mund të ketë dalë nga kanali.	▶ Kontrolloni futjen e duhur të guarnicionit të derës në kanal.

11.3.2 Pajisjet

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
IceMaker nuk mund të ndizet.	→ Pajisja dhe për rrjedhojë IceMaker nuk janë të lidhur.	▶ Lidhni pajisjen (shihni instruksionet e montimit).
IceMaker nuk prodhon kuba akulli.	→ IceMaker nuk është i ndezur.	▶ Aktivizoni IceMaker.
	→ Sirtari i "IceMaker" nuk është mbyllur siç duhet.	▶ Mbyllni sirtarin në mënyrën e duhur.
	→ Linja e furnizimit me ujë nuk është hapur.	▶ Hapni furnizimin me ujë.
Ndriçimi i brendshëm nuk ndizet.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	▶ Ndizni pajisjen.
	→ Dera është mbajtur hapur më gjatë se 15 minuta.	▶ Ndriçimi i brendshëm fiket automatikisht pas 15 minutash kur dera e pajisjes është e hapur.
	→ Ndriçimi LED ka defekt ose kapaku i tij është dëmtuar.	▶ Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 11.4 Shërbimi për klientin)

11.4 Shërbimi për klientin

Fillimisht provoni nëse mund ta eliminoni vetë defektin (shihni 11 Ndihma për klientin) . Nëse nuk ia dilni dot, kontaktoni me shërbimin për klientin.

Adresën e gjeni në broshurën bashkëlidhur „Shërbimi i Liebherr“ ose në faqen e internetit home.liebherr.com/service.

PARALAJMËRIM
Riparim jo profesional!
Lëndime.
- ▶ Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje dhe në kordonin e lidhjes elektrike, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike (shihni 10 Mirëmbajtja) , duhen kryer vetëm nga kujdesi për klientin.
- ▶ Ndërroni kordonin e dëmtuar të lidhjes elektrike vetëm te prodhuesi ose nga shërbimi i tij për klientin ose te një person me kualifikim të ngjashëm.
- ▶ Në pajisjet me spinë frigoriferi, ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.

11.4.1 Kontakti me shërbimin për klientin

Sigurohuni që keni gati informacionet e mëposhtme të pajisjes:
- ❑ Emërtimi i pajisjes (modeli dhe indeksi)
- ❑ Nr. i shërbimit (Shërbimi)
- ❑ Numri i serisë (S-Nr.)

- ▶ Hapni informacionet e pajisjes nëpërmjet ekranit. (shihni Informacioni i pajisjes)

-ose-
- ▶ Merrni informacionet e pajisjes nga etiketa e parametrave. (shihni 11.5 Etiketa e parametrave)

- ▶ Mbani shënim informacionet e pajisjes.
- ▶ Njoftoni shërbimin për klientin: Komunikojini defektin dhe informacionet e pajisjes.
- ▷ Kjo bën të mundur një shërbim të shpejtë dhe të fokusuar.
- ▶ Ndiqni instruksionet e tjera të shërbimit për klientin.

11.5 Etiketa e parametrave

Etiketa e parametrave ndodhet prapa sirtarëve në anën e brendshme të pajisjes.




Fig. 225

(1) Emërtimi i pajisjes
(2) Nr. i shërbimit
(3) Numri i serisë

- ▶ Lexoni informacionet e etiketës së parametrave.

12 Nxjerrja jashtë pune

- ▶ Zbrazni pajisjen.
- ▶ Çaktivizoni IceMaker. (shihni Çaktivizimi i IceMaker dhe MaxIce)
- ▶ Fikni pajisjen. (shihni Fikja dhe ndezja e pajisjes)
- ▶ Hiqni spinën elektrike nga priza elektrike.
- ▶ Nëse nevojitet, hiqni fishën e frigoriferit: Nxirrni fishën e frigoriferit nga priza në pajisje dhe njëkohësisht lëvizeni majtas dhe djathtas.
- ▶ Pastroni pajisjen. (shihni 10.3 Pastrimi i pajisjes)
- ▶ Lëreni derën hapur që të mos krijohen erëra të këqija.

13 Hedhja

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:
- ❑ Kuptimi i simboleve në pajisje është i njohur.
- ❑ Udhëzimet për mënjanimin janë të njohura. (shihni 1.6 Udhëzime për hedhjen)

13.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin

- ▶ Nxirreni pajisjen jashtë pune. (shihni 12 Nxjerrja jashtë pune)

13.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike

PARALAJMËRIM
Rrezik diegieje nga gazi ftohës dhe vaji që del jashtë!
Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.
- ▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.

- ▶ Ndiqni udhëzimet për transportin e pajisjes. (shihni 3.6 Transportimi i pajisjes)
- ▶ Transportoni pajisjen pa e dëmtuar atë.
- ▶ Hidheni pajisjen sipas udhëzimeve.

Scan QR Code and find digital operating and installation instructions.



home.liebherr.com

20260817 7088681-00

Liebherr-Hausgeräte GmbH
Memminger Straße 77-79
88416 Ochsenhausen
Deutschland